



Projekti Rajonal CARDS për Policinë në Evropën Jug-lindore

Përmbledhje e legjislacionit të Evropës Juglindore mbi Konfiskimin e Produkteve të Veprave Penale

**Përgatitur nga
Robert Golobinek
Strasburg, 2007**

Përmbajtja

1	Hyrje.....	4
2	Profilët e vendeve.....	6
2.1	SHQIPËRIA – PROFIL I VENDIT	6
2.1.1	Legjislacioni aktual.....	6
2.1.2	Konfiskimi i Shtrirë	6
2.1.3	Përgatitja e legjislacionit	8
2.1.4	Institucionet	9
2.1.5	Përfundime.....	9
2.1.6	Vështrim i përgjithshëm	11
2.2	BOSNJA DHE HERCEGOVINA	15
2.2.1	Legjislacioni aktual.....	15
2.2.2	Shtrirja e konfiskimit.....	17
2.2.3	Përgatitja e legjislacionit	17
2.2.4	Institucionet	18
2.2.5	Përfundime.....	19
2.3	KROACIA – PROFIL I VENDIT	22
2.3.1	Legjislacioni aktual.....	22
2.3.2	Shtrirja e konfiskimit.....	24
2.3.3	Përgatitja e legjislacionit	25
2.3.4	Institucionet	25
2.3.5	Përfundime.....	26
2.3.6	Vështrim i përgjithshëm	27
2.4	“ISH- REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË” – PROFILI I VENDIT	30
2.4.1	Legjislacioni aktual.....	30
2.4.2	Konfiskimi i shtrirë.....	32
2.4.3	Përgatitja e legjislacionit	33
2.4.4	Institucionet	33
2.4.5	Përfundime.....	34
2.4.6	Vështrim i përgjithshëm	36
2.5	KOSOVA – PROFIL I ZONËS SË PROJEKTIT	38
2.5.1	Legjislacioni aktual.....	38
2.5.2	Konfiskimi i shtrirë.....	41
2.5.3	Përgatitja e legjislacionit	41
2.5.4	Institucionet	41
2.5.5	Përfundime.....	42
2.6	MALI I ZI – PROFIL I VENDIT	46
2.6.1	Legjislacioni aktual.....	46
2.6.2	Konfiskimi i shtrirë.....	46
2.6.3	Përgatitja e legjislacionit	47
2.6.4	Institucionet	47
2.6.5	Përfundime.....	48
2.6.6	Vështrim i përgjithshëm	48
2.7	SERBIA – PROFIL I VENDIT	50
2.7.1	Legjislacioni aktual.....	50
2.7.2	Konfiskimi i shtrirë.....	52
2.7.3	Përgatitja e legjislacionit	52
2.7.4	Institucionet	53
2.7.5	Përfundime.....	53
2.7.6	Përkrahje e përgjithshëm	54
3	Standarte ndërkombëtare.....	56

3.1	INSTRUMENTE LIGJORE NDËRKOMBËTARE.....	56
3.2	VËSHTRIM KRAHASUES	58
3.2.1	Hollanda	58
3.2.2	Danimarka.....	59
3.2.3	Gjermania.....	60
3.2.4	Irlanda	60

Për informacion të mëtejshëm kontaktoni:

Divizionin e Krimit Ekonomik
Drejtoria e përgjithshme e të Drejtave të Njeriut
dhe Çështjeve Ligjore
Këshilli i Evropës

Tel +33-3-9021-4506
Fax +33-3-8841-3955
Email alexander.seger@coe.int

Opinionet e shprehura në këtë raport teknik nuk
reflektojnë domosdoshmërisht pozicionin zyrtar
të Këshillit të Evropës dhe të Komisionit
Evropian

1 Hyrje

Konfiskimi i produkteve të krimit është një mjet efikas në luftën kundër krimeve të rënda dhe atij të organizuar. Megjithatë, aplikimi në praktikë i standardeve ndërkombëtare, e për më tepër, i dispozitave ligjore ekzistuese vazhdon të paraqesë sfidë për shumë prej vendeve në Evropë.

Një nga rezultatet e Programit Rajonal Cards për Policinë, CARPO, në Evropën Jug-Lindore ishte hetimi financiar me qëllim konfiskimin e produkteve të krimit, porë nga këndvështrimi institucional, ligjor dhe operacional.

Qëllimi i kësaj përmbledhje është të bëjë një prezantim të legjislacionit ekzistues në vendet e përfshira në projektin CARPO (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, "ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë", Serbia (përfshirë Kosovën dhe Malin e Zi) në fushën e identifikimit, zbulimit (hetimit financiar), ngrirjes dhe sekuestrimit (masa të përkohshme) si dhe konfiskimit të produkteve të krimit, me theks të veçantë në konfiskimin e zgjeruar, duke i parë nga këndvështrimi i standarteve ndërkombëtare.

Të gjitha vendet kanë miratuar ligje të cilat u lejojnë të bëjnë identifikimin, zbulimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit, me disa pengesa specifike që do të përshkruhen më poshtë. Mangësia kryesore qëndron tek mungesa e shërbimeve (dhe dispozitave) për të administruar produktet e krimit, si dhe tek mungesa e dispozitave që lidhen me konfiskimin e zgjeruar. Moszbatimi në praktikë i legjislacionit ekzistues shkakton mangësi në mbledhjen e të dhënave dhe, për rrjedhojë, mungesën e bazave të të dhënave të përshtatshme mbi hetimin financiar, konfiskimin e përkohshëm dhe atë përfundimtar. Ky shërben si shkak për mungesën e statistikave, të cilat do të bënin të mundur kryerjen e analizave strategjike.

Legjislacioni mbi konfiskimin e shtrirë zbatohet vetëm në Shqipëri; dispozitat ligjore ekzistojnë edhe në Bosnje-Hercegovinë e Kroaci, por ato (ende) nuk përdoren në praktikë. Përmbysja e barrës së provës mbi prejardhjen e pronës lidhet gjithmonë me një individ i cili shpallet fajtor për një krim, në rastet kur pasuria e tij është më e madhe se të ardhurat e ligjshme (të deklaruara).

Në vendet në tranzicion të cilat kanë demokraci, shtet ligjor dhe sisteme ekonomike në ndërtim e sipër, (papunësi, sisteme financiare dhe bankare të pakonsoliduara, të dhëna të vjetëruara mbi pronat, regjistrat e tokave, etj), mundësia e konfiskimit të shtrirë, në se ky kryhet në mënyrë të balancuar dhe në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut merr rëndësi të veçantë për të luftuar pasurimin e paligjshëm nëpërmjet veprimtarive kriminale. Ka shumë instrumenta ligjorë ndërkombëtarë të cilat nxisin konfiskimin e zgjeruar, ndërkohë ai që është i rregulluar me ligj dhe zbatohet në mënyrë efikase vetëm në disa vende evropiane.

Me konfiskim të shtrirë¹ për qëllimet e kësaj përmbledhje do të kuptojmë masën e cila lejon konfiskimin (dhe sekuestrimin) e pronës së një personi të dënuar, në rastet kur mendohet se kjo pronë është krijuar nëpërmjet kryerjes së veprave penale (dhe/ose është në mospërputhje me të ardhurat e tij të justifikuar në mënyrë të ligjshme) dhe kur personi nuk është në gjendje të vërtetojë prejardhjen e ligjshme të pronës së tij.

Vendet e ish-Jugosllavisë ndajnë të njëjtën histori për sa i përket legjislacionit. Pas shpërbërjes, shumica e tyre hartuan legjislacionin e tyre penal, duke respektuar zhvillimet në të drejtën ndërkombëtare, specifikat e brendshme si dhe kalimin drejt ekonomisë së tregut.

¹Sipas Konventw's sw 2005-s pwr Pastrimin, Zbulimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve tw Krimit si dhe pwr Financimin e Terrorizmit (Neni 3/4) : "Masat e nevojshme tw cilat kwrkojnw qw nw rastet e krimit apo krimeve tw rwnda, tw pwrcaaktuara nw legjislacionin e brendshwm, autori vwrteon prejardhjen e ligjshme tw produkteve apo pronave tw tjera, tw cilat mund tw bwhen objekt i konfiskimit deri nw atw masw qw kwrkesw wshtw nw pwrputhje me parimet e legjislacionit tw brendshwm."

Disa vende kanë prezantuar hetimin e drejtuar nga prokurori, duke hequr dorë nga hetimi gjyqësor formal, i drejtuar formalisht nga gjyqtari hetues; vendet e tjera janë fazën e hartimit të ndryshimeve ligjore për të arritur këtë.

Do të përmenden njëkohësisht edhe institucionet përkatëse, sepse në tryezat e rrumbullakëta dhe/ose trajnimet e organizuara në kuadrin e projektit CARPO kanë marrë pjesë zyrtarë nga institucione të ndryshme. Në disa raste ka ende nevojë për rritje të ndërgjegjësimit; ndërsa në të tjerat ndjehet nevoja e trajnimit të avancuar për të përmbushur nevojat specifike të institucioneve, të cilat aktualisht kanë praktikë (të kufizuar) të punës, me qëllim që të bëhet specializimi i tyre. Është përmendur në mënyrë të herëpashershme nevoja për më shumë mbështetje dhe motivim për hetuesit. Mungesa e motivimit (financiar) për hetuesit në vende të caktuara mund të pengojë gjetjen e produkteve të krimit, pasi mund të çojë në vendosjen nën "presion" apo intimidimin e hetuesve nga kriminelët duke rritur mundësinë e korrupsionit.

Qëllimi i kësaj përmbledhje është të ofrojë një informacion të përgjithshëm mbi legjislacionin ekzistues, planet për ndryshimin e tij, si dhe mbi institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit në vendet e Evropës Jug-Lindore. Njëkohësisht, kjo përmbledhje mund të shërbejë si bazë për një analizë më të detajuar në të ardhmen.

Burimet e informacionit për këtë studim kufizohen në tekstet e legjislacionit ekzistues (disa prej të cilave të përkthyer keq në anglisht) si dhe projekt-propozimet për amendamente. Burime të tjera informacioni dhe të dhënsh janë ato të marra nëpërmjet tryezave të rrumbullakëta të organizuara me drejtuesit e policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit, si dhe rezultatet e dala nga trajnimete organizuara në vendet përkatëse dhe në konferencat rajonale gjatë periudhës 2004-2007. Ky punim mbështetet gjithashtu në informacionin e dhënë në seksionet e veçanta sipas vendeve mbi "Hetimin financiar dhe konfiskimin e Produkteve të Krimit" (botimi i parë në Shtator 2006 dhe i dyti në Qershor 2007).

2 Profilet e vendeve

2.1 Shqipëria – Profili i vendit

2.1.1 Legjislacioni aktual

Konfiskimi rregullohet nga Neni 36 i Kodit Penal (më poshtë i përmendur me inicialet KP), i cili parashikon konfiskimin e mjeteve dhe produkteve të veprës penale, ose të çfarëdolloj pasurie tjetër, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të krimit.

Konfiskimi njëkohësisht parashikohet edhe në rastet kur kemi të bëjmë me shndërrim të pjesshëm apo të plotë në prona të tjera, apo kur ato janë përzier me pasuri të fituar në mënyrë të ligjshme, në të njëjtën masë dhe mënyrë si dhe produktet e veprës penale. (Nenet 36/3 dhe 4 të KP).

Konfiskimi i përkohshëm (sekestrimi) ndahet në disa kategori, në përputhje me qëllimet e marrjes së kësaj mase.

Sekuestrimi i provave

Gjykata dhe prokurori mund të urdhërojnë sekuestrimin e provave dhe sendeve që lidhen me veprën penale, në rastet kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve. (Neni 208 i Kodit të Procedurës Penale – KPK). Sekuestrimi kryhet nga organi që nxjerr urdhrin e sekuestrimit ose nga oficerët e policisë gjyqësore të cilët janë autorizuar për ta bërë këtë. Në rastet e sekuestrimit të korrespondencës, fondeve, dokumentave bankarë apo depozitave të tjera bankare, organi përgjegjës për lëshimin e urdhrit të sekuestrimit është gjykata. Në rastet e ngutshme, me përjashtim të korrespondencës, urdhri mund të lëshohet edhe nga prokurori. Në raste të ngutshme, kur gjurmët apo objektet mund të përvetësohen/ndryshojnë apo zhduken dhe prokurori nuk ka mundësi të ndërhyjë shpejt, sekuestrimi i provave dhe objekteve që lidhen me veprën penale mund të bëhet nga oficeri i policisë gjyqësore. (Neni 300/2 KPP).

Sekuestroja konservative urdhërohet kur ka arsye të bazuara për të besuar se nuk ka garanci për pagimin e dënimit me gjobë, shpenzimeve të procedimit apo të detyrimeve të tjera ndaj shtetit. (Neni 270 i KPP).

Konfiskimi i përkohshëm (ngrirja, sekuestrimi dhe ndalimi i disponimit) të produkteve të krimit

Sekuestro konservative vendoset kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi të sjellë rëndimin apo zgjatjen në kohë të pasojës së një veprë penale, apo lehtëson kryerjen e një veprë tjetër penale. (Neni 274 i KPP). Sekuestro konservative vendoset me urdhër të gjykatës, me kërkesë të prokurorit dhe ka si objekt të gjitha llojet e pronave, objekteve apo produkteve të tjera të krimit të cilat lejohet të konfiskohen sipas Nenit 36 të KP.

Konfiskimi në rrethana të veçanta (parashikuar në Nenin 287 të KPP) është i mundshëm kur personi nuk mund të merret si i pandehur apo nuk mund të dënohet.

“Hetimi financiar” nuk përkufizohet në mënyrë specifike nga KPP, ndërkohë që nuk ka as dispozitë të veçantë për aksesin ndaj të dhënave bankare.

2.1.2 Konfiskimi i Shtirë

Ligji për Parandalimin dhe luftën ndaj Krimit të Organizuar (Ligji mbi KO) përcakton rregulla të ndryshme për sekuestrimin dhe konfiskimin. Ligji fut konceptin e konfiskimit të zgjeruar. Qëllimi i ligjit është të bëjë të mundur hetimin e origjinës së pasurisë së personit të dyshuar (në bazë të dyshimeve të arsyeshme) për disa lloj krimesh (të renditura) ose për lidhje me organizata kriminale (shih Nenin 3 dhe 9); ai gjithashtu lejon konfiskimin e përkohshëm apo përfundimtar të pasurisë së cilës nuk i provohet origjina e ligjshme. Procedura e përdorur për hetimin financiar, sekuestrimin dhe konfiskimin është civile ose administrative, ndërkohë që lidhja me procedurën (e

mundshme) penale është e rregulluar me ligj. (Neni 4/3 dhe 27). Nuk është e nevojshme që të ketë një dënim për veprën penale.

Prokurori duhet të sigurojë të dhëna të mjaftueshme (ose të ketë shkaqe të bazuara për të dyshuar) për të provuar përfshirjen e të dyshuarit në aktivitetet kriminale të renditura në listë, të cilat kanë sjellë si rezultat produkte të krimit dhe/ose mospërputhje të vlerës së pasurive me të ardhurat e deklaruar, ose influencën e aktiviteteve kriminale mbi pasurinë (Neni 8 dhe 9). Të dyshuarit mund t'i kërkohet gjatë fazës së hetimit që të provojë prejardhjen e ligjshme të pasurive të tij dhe të hedhë poshtë dyshimet e bazuara. (Neni 9 dhe 13).

Zbatimi i këtij ligji kufizohet tek ata persona për të cilët ka dyshime të arsyeshme për pjesëmarrje apo përfshirje në organizata kriminale apo terroriste, ose për vepra penale që lidhen me trafikun e drogës, mallrave, qenieve njerëzore dhe kontrabandës, *inter alia* (Neni 109, 109/b, 110/a, 114/b, 128/b, 278/a, 282/a, 283/a and 284/a CC)².

Ky ligj është gjithashtu i zbatueshëm për bashkëshortët, fëmijët, të afërmit, persona të tretë apo persona juridikë, në rastet kur ekzistojnë të dhëna që tregojnë se pasuritë apo veprimtaritë e tyre zotërohen nga personat e dyshuar.

Është interesant fakti se ligji mund të zbatohet për konfiskimin e pasurive të personave të dyshuar, të krijuara hyrjes në fuqi të tij. (Neni 3).

Neni 8 rregullon mundësinë e shtrirjes së hetimit edhe mbi pasuri apo veprimtari ekonomike të cilat gjenden në kushte kërcënimi ose ndikimi nga organizata kriminale ose në rastet kur vlera e pasurisë nuk përputhet me të ardhurat dhe mundësitë ekonomike të të dyshuarit. Në këtë rast prokurori mund t'i kërkojë gjykatës që të detyrojë personin që ka titullin e pronarit të justifikojë ligjshmërinë e prejardhjes së tyre.

Neni 13 përcakton kriteret për sekuestrimin e pasurive, gjë që urdhërohet nga gjykata me kërkesë të prokurorit. Gjykata urdhëron sekuestrimin e pasurive të cilat mund të jenë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në pronësi të personit nën hetim:

- a) vlera nuk përputhet me të ardhurat e deklaruar ose me aktivitetin e tij ekonomik;
- b) bazuar në të dhëna të mjaftueshme ekzistojnë arsye të bazuara për të besuar se objektet janë produkt i veprimtarive të paligjshme apo përbëjnë investim të tyre.

Gjykata mund të detyrojë personin nën hetim ose pronarin e aseteve të justifikojë ligjshmërinë e origjinës së tyre.

Zbatimi në praktikë i ligjit dhe lidhja e tij me procedurën penale vazhdon të krijojë disa probleme. Procedura për hetimin financiar, sekuestrimin dhe konfiskimin është e ndarë nga procedura penale. Ligji përcakton se do të zbatohen rregullat procedurale administrative dhe civile. (Neni 4/3). Neni 27 rregullon marrëdhënien me procedimin penal dhe produktet përkatëse të veprës penale. Në këto raste, sekuestrimi dhe konfiskimi mund të urdhërohet mbi bazën e këtij ligji, por zbatimi i urdhrit kur produktet sekuestrohen bëhet sipas procedurës penale, pasi ajo të ketë përfunduar. Masat e parashikuara në këtë ligj shuhen me mbylljen e procedimit penal. Në praktikë prokurori nis procedurën e rregulluar me këtë ligj, pasi rezultatet e procedimit penal ofrojnë të dhëna dhe prova të mjaftueshme, edhe në rastet kur procesi gjyqësor nuk ka filluar ende. Procedura, pra, është paralele, por e ndarë nga forma penale.

Konfiskimi urdhërohet bazuar në kërkesën e justifikuar të prokurorit. Gjykata urdhëron konfiskimin e pasurive të sekuestruara, për të cilat nuk është provuar prejardhja e ligjshme (Neni 24) deri në tre muaj pas bërjes së kërkesës.

² a) pjesëmarrje në organizata kriminale apo grupe të strukturuar kriminale dhe kryerjen e krimeve për llogari të tyre b) pjesëmarrje në organizata terroriste apo banda të armatosura dhe kryerjen e krimeve për llogari të tyre c) kryerjen e krimeve për qëllime terroriste; d) zhvatje; e) trafikimi i qenieve njerëzore; f) trafikimi i grave për qëllime të shfrytëzimit seksual g) trafikimi i të miturve, kontrabanda e armëve dhe municioneve; h) trafikimi i substancave narkotike; i) organizmin dhe drejtimi i organizatës kriminale.

Gjykata hedh poshtë kërkesën për konfiskim në rastet kur (Neni 26):

- të dhënat e ofruara nuk mjaftojnë për të provuar përfshirjen e të dyshuarit në aktivitet kriminal (Neni 3);
- rezulton se pasuria e sekuestruar ka prejardhje të ligjshme;
- rezulton se pasuria e sekuestruar nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me personin e dyshuar.

Konfiskimi i përkohshëm (sekuestrimi paraprak) rregullohet nëpërmjet Nenit 7.

Në rastet kur ekziston rreziku për përvetësimin, tjetërsimin apo humbjen e produkteve apo pasurive të cilat përbëjnë objekt konfiskimi sipas regjimit të konfiskimit të shtrirë, prokurori mund t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë sekuestrimin paraprak të tyre, edhe para datës së fillimit të seancave gjyqësore. Masa e sekuestros është e vlefshme për një periudhë gjashtëmuajore, me mundësi zgjatje deri në një vit.

Masa të përkohshme në rastet e ndikimit nga organizata kriminale

Në rastet kur dyshohet se zotërimi i pasurive apo veprimtarive ekonomike gjendet në kushte kërcënimi apo ndikimi nga organizata kriminale, apo në kushte të tilla që mund të lehtësojnë veprimtarinë e personave të dyshuar sipas ligjit mbi KO, (ndikimi i organizatave kriminale- Neni 8; dhe krimet e renditura –Neni 9) gjykata, me kërkesë të prokurorit mund të urdhërojë pezullimin e përkohshëm të administrimit dhe disponimit të veprimtarive dhe pasurive të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë janë nën kërcënimin ose ndikimin e organizatave kriminale.(Neni 9).

Në rastet kur ekziston një rrezik konkret dhe real se pasuritë mund të humbin; tjetërsohen apo përvetësohen, prokurori mund t'i kërkojë gjykatës që të urdhërojë sekuestrimin e tyre. (Neni 10).

2.1.3 Përgatitja e legjislacionit

Projekt-aktet nënligjore mbi Agjensinë e Adminsitrimin (2007), përgatitur nga kjo agjensi ende nuk janë miratuar. Amendimet e Ligjit mbi Pastrimin e Parave janë në fazën e hartimit. Për këtë qëllim, në vitin 2007, Ministria e Financave ngriti një grup punë pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Pastrimin e Parave.

2.1.4 Institucionet

Policia gjyqësore

Policia gjyqësore, edhe *ex officio*, merret me zbulimin e veprave penale, me qëllim parandalimin e pasojave të mëtejshme, zbulimin e autorëve, kryen hetime dhe mbledh prova të cilat mundësojnë zbatimin e KP. (Neni 30 KPP). Policia gjyqësore kryen të gjitha veprimet hetimore të cilat i ngarkohen apo delegohen nga prokuroria. Sektori i luftës kundër Mashtrimit Financiar, Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit pranë policisë kriminale është njësi më e rëndësishme në hetimin financiar.

Prokuroria

Prokurori bën procedimin penal, kontrollon hetimet paraprake, paraqet akuzat përpara trupit gjykues dhe ndërmerr masa për të siguruar zbatimin e vendimeve. (Neni 24 KPP)³. Pasi bëhet kallëzimi i veprës penale, hetimi financiar drejtohet nga prokurori, i cili mund t'ia delegojë veprimet oficerëve të policisë gjyqësore. (Neni 304 KPP).

Prokuroria e Krimeve të Rënda është një njësi e specializuar, e cila merret edhe me zbulimin e produkteve të krimit. Për momentin ka dy prokurorë që janë të angazhuar në hetimin financiar.

Task Force pranë Prokurisë së rrethit Tiranë përbëhet nga njësi të policisë gjyqësore, policisë tatimore, doganave dhe anti-kontrabandës.

Njësia e Përbashkët Hetimore kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit pranë Zyrës së Prokurorit (Drejtor Altin Dumani) u krijua në bazë të një urdhri të përbashkët të Ministrit të Financave, Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Brendshëm dhe Shërbimit Informativ Shtetëror.

Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara

Ligji për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar parashikon ngritjen e Agjensisë, duke përcaktuar njëkohësisht mandatin dhe detyrat e saj. Manaxhimi administrativ kufizohet tek produktet që rrjedhin nga krimi dhe që janë objekt i këtij ligji. Agjensia nuk është ende funksionale, pasi nuk janë miratuar aktet nën-ligjore (Neni 36/2 dhe 3).

Detyra e administratorit është që të ruajë dhe të administrojë pasurinë e sekuestruar, mundësisht duke rritur vlerën e tyre. (Neni 20). Agjensia gjithashtu ka rol pasi del vendimi (urdhri) i konfiskimit.

Shpenzimet e administrimit dhe ato administrative mbulohen nga fondet e sekuestruara. Nëse fondet e sekuestruara janë të pamjaftueshme ose pasuria e sekuestruar kthehet tek pronari, këto kosto mbulohen nga buxheti i shtetit nëpërmjet Agjensisë. (Neni 23/1).

2.1.5 Përfundime

Hetimi financiar nuk përkufizohet në mënyrë specifike në KPP dhe nuk ekziston ndonjë dispozitë e veçantë e cila rregullon aksesin ndaj të dhënave bankare.

Shqipëria është i vetmi vend në rajon i cili ka vendosur regjimin e konfiskimit të shtrirë. Ajo nuk ka histori të përbashkët me vendet e ish – Jugosllavisë për sa i përket legjislacionit, por ngjason më tepër me sistemin italian. Ligji mbi Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar siguron bazën ligjore për hetimin e prejardhjes së pasurive në rastet kur ka dyshime për prejardhje jo-të

³ Shih gjithashtu Ligjin Nr. 8737 (12.02.2001) mbi funksionimin dhe organizimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë.

ligjshme të tyre (e kufizuar kjo në një numër veprash penale të specifikuara në listë⁴) ose për ndikim nga ana e një grupi kriminal. Procedura e përdorur është civile ose administrative, jo penale. Nuk është e nevojshme që të jetë marrë vendimi i dënimit.

Zbatimi në praktikë i ligjit ende has në disa vështirësi, të cilat kryesisht lidhen me Nenin 8 (ndikimi i grupit kriminal) dhe funksionimin e Agjensisë së Adminsitrimt (kufizuar vetëm në Ligjin kundër KO).

Në Zyrën e Prokurorisë së Krimeve të Rënda ka dy prokurorë që merren me kryerjen e hetimeve financiare (së bashku me policinë gjyqësore). Gjatë viteve të kaluara ka pasur 21 raste të cilat kanë përfunduar me konfiskim (të shtrirë) të produkteve të krimit. Nuk ekzistojnë të dhëna të përgjithshme mbi hetimin financiar, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit.

Zbatimi i kufizuar i ligjit në praktikë (si dhe mungesa e jurisprudencës) nuk të jep mundësinë për të bërë një vlerësim të detajuar të përputhshmërisë me standartet ndërkombëtare, veçanërisht me ato të të drejtave të njeriut.

Megjithëse nuk është e nevojshme që të ketë vendim për një vepër penale, dhe mund të mos ketë lidhje me procedimin penal (por në praktikë zakonisht ka), duhet që prokurori të argumentojë dyshimin mbi prejardhjen e paligjshme (ose kontrollin nga ana e një organizate kriminale) të pasurisë. Ky dyshim hidhet poshtë në rastet kur i dyshuari apo zotëruesi i titullit sjellin prova që dëshmojnë origjinën e ligjshme të pasurisë. Zbatimit i ligjit kufizohet vetëm në një listë krimesh të rënda ose në rastet kur ka lidhje me grupet e organizuara kriminale. (parimi i proporcionalitetit). Sipas mendimit tim, në përgjithësi përmbushen standardet ndërkombëtare që lidhen me konfiskimin e shtrirë.

⁴ Problem bëhet zbatimi i ligjit në veprat penale që lidhen me trafikun e drogës, pasi vetëm trafikimi i drogës jashtë kufijve përbën objekt të zbatimit të Ligjit mbi KO.

2.1.6 Vështrim i përgjithshëm

CP		Shqipëria
Konfiskimi	36 KP	Neni 36 (i ri): Konfiskimi i instrumentave dhe produkteve të veprës penale 1. Urdhri i konfiskimit jepet nga gjykata dhe nënkupton marrjen dhe transferimin në favour të shtetit: d) sendeve, prodhimi, përdorimi, mbajtja apo tjetërsimi i të cilave përbën veprën penale, edhe në rastet kur nuk është dhënë vendim dënimi . 2. Në se produktet e veprës penale janë transferuar apo shndërruar pjesërisht apo tërësisht në pasuri të tjera, këto të fundit i nënshtrohen konfiskimit. 3. Në se produktet e krimit janë përzier me pasuri të tjera të fituara në mënyrë të ligjshme, këto të fundit konfiskohen në një masë të barabartë me vlerën e produkteve të veprës penale. 4. Të ardhurat apo përfitimet e tjera nga produktet e krimit, pasuritë të cilat janë rezultat i transformimit apo shndërrimit të produkteve të krimit ose pasuritë që janë përzier me këto produkte, i nënshtrohen konfiskimit në të njëjtën masë dhe mënyrë si produktet e krimit.
Produkte të drejtpërdrejta /të tërthorta	36/1b	b) produkte të veprës penale, të cilat përfshijnë çdo lloj pasurie si dhe instrumentat dhe dokumentet ligjorë që përbëjnë tituj apo interesa të tjera në pasurinë që rrjedh, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, nga kryerja e veprës penale; c) shpërblime të dhëna apo të premtuara për kryerjen e nje vepre penale;
Vlera e konfiskimit	36/1c	ç) çdo lloj tjetër pasurie, vlera e të cilës korrespondon me atë të produkteve të krimit;
Persona të tretë	Po	
Persona Juridike	45	Sanksione penale për personat juridikë Në se një person juridik ushtron aktivitet kriminal, gjykata mund të vendosë për ndalimin e plotë apo të pjesshëm të aktivitetit dhe konfiskimin e fitimeve, mjeteve dhe pronave të tjera që kanë ardhur si rezultat i këtij aktiviteti.
Konfiskim i shtrirë	8, 13 KO	
KPP		
Hetimi financiar	274	Detyrat e policisë – Neni 30 KPP
MPH	221 etj.	
Akresi ndaj të dhënave bankare	191?	Nuk ka dispozitë të veçantë: Neni 191 “marrjen e dokumentave”?
Konfiskimi i përkohshëm	274	Neni 274 – Objekti i sekuestros preventive 1. Kur ekziston rreziku se disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale, gjykata kompetente, me kërkesë të prokurorit, urdhëron sekuestrimin e tij nëpërmjet një vendimi të arsyetuar. 2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për objekte të cilat lejohet të konfiskohen. 3. Në rastet kur ndryshojnë rrethanat e ekzekutimit, gjykata, me kërkesë të prokurorit ose personave të interesuar mund të urdhërojë heqjen e

		sekuestros..
Ngjirja e llogarive bankare	210	Neni 210, Sekuestrimi pranë bankave Gjykata urdhëron sekuestrimin e dokumenteve bankarë, instrumentave të negociushëm, shumave të depozituara në llogari bankare apo forma të tjera, madje edhe në kasete sigurie, në se ka arsye për të besuar se ato lidhen me veprën penale, edhe kur ato nuk i përkasin të pandehurit apo nuk janë të regjistruara me emrin e tij. Në raste të ngutshme ky vendim mund të merret nga prokurori.
Procedure Apelimit	212, 275 276	
Manaxhimi	214, 215/3, 220	Neni 214 Ruajtja e sendeve të sekuestruara Sendet e sekuestruara ruhen në sekretari... Neni 215: Vulosja e sendeve të sekuestruara Neni 220: Shpenzimet për sendet e sekuestruara
Konfiskimi	275	Neni 275 Humbja e fuqisë së sekuestros 1. Gjykata ose prokurori, me vendimin e pushimit të çështjes urdhëron kthimin e sendeve të sekuestruara personit të cilit i përkasin, me përjashtim të rasteve kur ato duhen konfiskuar, pasi kanë shërbyer apo ishin përcaktuar për t'u përdorur në një vepër penale, ose janë prodhim apo përfitim i një veprë penale. 2. Kur është dhënë vendimi i dënimit, efektet e sekuestros vazhdojnë në rast se është vendosur konfiskimi i sendeve të sekuestruara. 3. Sendet e sekuestruara nuk kthehen në rastet kur gjykata vendos të ruajë sekuestron për garantimin e kredive..
Legjislacioni i veçantë		Ligji mbi Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar
Faqet		www.gpz.gov.al www.parlament.al
		Institucionet (e specializuara)
Policia gjyqësore		Spektori kundër Mashtrimit dhe Krimit Ekonomiko- Financiar dhe Korrupsionit
Prokuroria		Prokuroria e Krimeve të Rënda Task Force pranë Prokurorisë së Rrethit Tiranë

Ligji mbi KO	2 KO	Neni 2 Objekti Parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar nëpërmjet zbulimit, identifikimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të paligjshme të personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar, si dhe përcaktimi i mënyrës së përdorimit të tyre.
Hetimi financiar	4, 6 KO	Neni 4 Objekti i Hetimeve 1.Hetimet kryhen për mjetet financiare, pasuritë, veprimtaritë ekonomike, mënyrën e jetesës, burimet e të ardhurave të personave të përmendur në nenin 3 të këtij ligji... 3. Hetimet dhe gjykimet sipas këtij ligji mbështeten në rregullat procedurale civile dhe administrative në fuqi, përveç atyre që përmenden shprehimisht në këtë ligj. Neni 6 Detyrimi për dorëzimin e informacionit dhe dokumenteve
Konfiskimi i përkohshëm	7,9, 10 KO	Neni 7 Sekuestrimi paraprak 1. Në rastet kur ka një rrezik real dhe konkret për humbjen, përvetësimin apo tjetërsimin e fondeve, pasurive dhe të drejtave të tjera, për të cilat parashikohet masa e konfiskimit sipas dispozitave të këtij ligji,

		prokurori mund t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë sekuestrimin paraprak, edhe para caktimit të datës së fillimit të gjyqit. Neni 9 Pezullimi i përkohshëm i Administrimit dhe disponimit të pasurive 1. Kur ka të dhëna të mjaftueshme për të gjykuar se disponimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive ekonomike të përcaktuara në nenin 8 ndihmon/lehtëson aktivitetin e personave të dyshuar sipas parashikimeve të këtij ligji, ose personave ndaj të cilëve ka nisur procedim penal për një nga krimet e parashikuara në Nenet 109, 109/b, 110/a, 114/b, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284/a, 284/c, 284/ç, 287, 333, 333/a të kapitullit VII të Kodit Penal, gjykata vendos, me kërkesë të prokurorit, pezullimin e përkohshëm të administrimit dhe zotërimit⁵ të aktiviteteve dhe pasurive që janë përdorur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për kryerjen e këtyre aktiviteteve ekonomike. 3. Në vendimet e dhëna sipas pikës 1, gjykata emëron një ose më shumë administratorë nga lista e ekspertëve të Agjensisë. Neni 10 Sekuestrimi 1. Kur ekziston një rrezik real dhe konkret se veprimtaritë dhe pasuritë e përcaktuara në Nenin 9 mund të humbasin, përvetësohen apo tjetërsohen, prokurori mund t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë sekuestrimin në përputhje me parashikimet e dispozitave të këtij ligji. .
Procedura e apelit për të provuar prejardhjen e ligjshme	8, 13, 28	
Administrimi	20 etj. OC	Agjencia e Administrimit të Pronave të Konfiskuara dhe Sekuestruara Agjencia përgjigjet vetëm për rastet e KO! Nuk ka filluar ende funksionimi (mungesa e akteve nën-ligjore)
Konfiskimi	24 - 26 KO	Neni 24 Kërkesa për Konfiskimin e Aseteve të Sekuestruara Masa e konfiskimit urdhërohet bazuar në kërkesën e prokurorit, i cili paraqet në gjykatë arsyet mbi të cilat bazohet kjo kërkesë. Neni 25 Vendimi i Gjykatës për konfiskim 1. Brenda tre muajsh... gjykata vendos konfiskimin e asetëve të sekuestruara, për të cilat nuk është provuar origjina e ligjshme. ... Neni 26 Rrëzimi i kërkesës për konfiskim Gjykata vendos rrëzimin e kërkesës për konfiskimin e pasurive dhe revokon masën e sekuestrimit, edhe me inisiativën e vet, në rastet kur: a) të dhënat janë të pamjaftueshme për të provuar pjesëmarrjen e personit të dyshuar në aktivitete kriminale, të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji; b) provohet se pasuritë e sekuestruara kanë origjinë të ligjshme; c) provohet se pasuritë e sekuestruara nuk janë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në pronësi të plotë apo të pjesshme të personit të dyshuar

Konfiskimi i shtrirë	8, 13 KO	Neni 8 Shtrirja e hetimit tek subjektet e kërcënuara nga organizatat kriminale Kur ka të dhëna të mjaftueshme për të gjykuar se zotërimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive ekonomike të veçanta gjenden në kushte ndikimi apo kërcënimi nga organizatat kriminale, ose në kushte të tilla që të lehtësojnë veprimtarinë e personave të cilët dyshohen për vepra penale të parashikuara në këtë ligj, prokurori i kërkon gjykatës të detyrojë personin që ka titullin e pronësisë, ose i cili ka në zotërim fonde apo asete të çfarëdolloji, vlera e të cilave nuk përputhet me të ardhurat apo mundësitë ekonomike të personit, që të justifikojë ligjshmërinë e burimit të tyre. Neni 13 Kriteret për sekuestrimin e pasurive 1. Me kërkesë të prokurorit, dhe me paraqitjen e arsyeve përkatëse, gjykata urdhëron sekuestrimin e pasurive, për të cilat ka të dhëna se janë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në pronësi të personit ndaj të cilit po zhvillohen hetime për veprat penale të parashikuara në këtë ligj në rastet kur: a) vlera e tyre është në përmasa të tilla që nuk përputhet me të ardhurat e deklaruar apo me veprimtarinë ekonomike të zhvilluar prej tij; b) mbi bazën e të dhënave të mjaftueshme, ka arsye të bazuara për të supozuar se këto objekte janë produkt i aktiviteteve të paligjshme ose përbëjnë investime të tyre. 2. Prokurori mund t'i kërkojë gjykatës të detyrojë personin e hetuar, ose ata që kanë tituj pronësie mbi çfarëdolloj fondi apo aseti, vlera e të cilave nuk përputhet me të ardhurat apo mundësitë ekonomike, të provojnë ligjshmërinë e prejardhjes së tyre.
----------------------	-------------	---

2.2 Bosnja dhe Hercegovina

2.2.1 Legjislacioni aktual⁶

Bosnja dhe Hercegovina qeveriset nga institucione lokale (njësie dhe federale) si dhe nga Zyra e Përfaqësuesit të Lartë, e cila ka edhe pushtetin legjislativ.

Çdo njësi (Federata e Bosnjes dhe Hercegovines, Republika Srbska dhe provinca Brčko) ka legjislacionin e vet penal, i cili parimisht duhet të jetë në përputhje me atë shtetëror (federal). Ky studim merr si referencë legjislacionin federal të Bosnje-Hercegovinës. Kodi i procedurës penale të Republika Srbska ka dispozita të veçanta mbi krimin e organizuar. (Nenet 504a deri 504n), sipas shembullit të KPP të Serbisë. Për momentin e vetmja agjensi shtetërore e zbatimit të ligjit është Agjensia Shtetërore e Hetimit dhe Mbrojtjes (SIPA), e cila është krijuar në vitin 2004. Për më tepër, përpjekjet e BE-së për të centralizuar forcat policore të njësive të ndryshme nuk patën sukses, duke sjellë si pasojë probleme në bashkëpunimin mes tyre.

Reforma në legjislacionin penal (në përmbajtje dhe procedurë) e vitit 2003 solli si rezultat shumë ndryshime: heqja e hetimit gjyqësor, drejtimin e hetimit nga prokuroria, deklarimin fajtor, marrëveshjet për deklarimin fajtor dhe pranimin e fajtit,⁷ etj. Mungesa e kualifikimit të duhur, veçanërisht për gjyqtarët dhe prokurorët, ka sjellë disa vështirësi në zbatimin në praktikë të legjislacionit të ri. Këto vështirësi lidhen kryesisht me kuptimin e rolit të ri dhe marrëdhënive mes prokurorisë dhe policisë. Bosnja dhe Hercegovina e ka nënshkruar Konventën për Pastrimin e Parave, Zbulimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit më 30 Mars 2004.

Konfiskimi

Neni 74 i KP bën përkufizimin e konfiskimit të objekteve të cilat janë përdorur, ose ishin caktuar për t'u përdorur për kryerjen e një vepre penale. Kjo është një masë sigurimi, e cila merret nga gjykata. Objektet mund të konfiskohen edhe në rastet kur janë në pronësi të autorit të veprës, në se këtë e kërkon interesi i sigurisë publike dhe morali. Palët e treta kanë mundësinë që të bëjnë kërkesë për kompensimin e dëmeve.

Neni 110 i KP shërben si bazë për konfiskimin e produkteve të krimit. Produktet konfiskohen me vendim të gjykatës, e cila vendos në se vepra penale është kryer.

Neni 111 i KP përcakton mënyrën e konfiskimit të produkteve të krimit. Produktet e krimit mund të jenë para, objekte me vlerë, (sende) dhe çfarëdolloj përfitimi ekonomik (sende, të drejta, prona të luajtshme dhe të paluajtshme) dhe përfitime të tjera të cilat kanë ardhur si rezultat i këtyre produkteve.

Konfiskimi i pasurive të të tretëve është gjithashtu i mundshëm në rastet kur produktet janë transferuar tek këta të fundit pa kompensim, ose me kompensim i cili nuk korrespondon me vlerën e tyre reale, ose kur personi ishte/duhet të ishte në dijeni se kjo pasuri ishte fituar nëpërmjet veprimtarive kriminale.

Gjykata mund t'i kërkojë personit të dënuar që të paguajë një shumë parash e cila pëputhet me vlerën e produkteve të krimit. (konfiskimi i bazuar në vlerë).

Në rastet kur produktet janë përzier me pasuri të ligjshme, kjo e fundit i nënshtrohet konfiskimit, duke mos tejkaluar shumën e produkteve të përziera.

⁶ Kodi Penal i Bosnje-Hercegovinës (FZ i Bosnje-Hercegovinës Nr. 3/03).

Kodi i Procedurës Penale i Bosnje- Hercegovinës (FZ e Bosnje-Hercegovinës Nr. 36/03).

Ligji mbi Zyrtarët e Policisë BiH (FZ i Bosnje-Hercegovinës Nr. 27/04).

Ligji Mbi Agjensinë Shtetërore të Hetimit dhe Mbrojtjes (FZ e Bosnje-Hercegovinës Nr. 27/04).

Ligji mbi Pastrimin e Parave (FZ e Bosnje-Hercegovinës Nr. 29/04).

⁷ Neni 231 CPC.

Neni 112 i KP përcakton raportin mes masës së konfiskimit të produkteve dhe pretendimeve për pronë të personave të dëmtuar nga vepra penale. Gjykata vendos konfiskimin e përfitimeve materiale, të cilat tejkalojnë pretendimet e pranura për prona të bëra nga pala e dëmtuar.

Procedura për konfiskimin e pasurive

Konfiskimi i produkteve të veprës penale bëhet me vendim të gjykatës, e cili e deklaron personin e akuzuar fajtor, por edhe si vendim për aplikimin e një mase ndëshkimore, ose nëpërmjet një vendimi ku shprehet se personi i akuzuar e ka kryer veprën penale në gjendje paaftësie mendore. Gjykata përcakton objektet apo vlerën monetare që do të konfiskohet. (Neni 396 KPP).

Gjykata mund të përcaktojë vlerën e produkteve të fituara nëpërmjet vlerësimit të lirë të të dhënave, në rastet kur ky përcaktim lidhet me vështirësi të raporteve apo vonesa të theksuara në procedurë. (Neni 394 KPP).

Hetimi financiar

Hetimi financiar nuk përcaktohet në mënyrë specifike në legjislacion. Bazuar në Nenin 392 të KPP, përfitimet e pasurive përcaktohen në mënyrë *ex officio* nëpërmjet procedurës penale. Prokurori është i detyruar të mbledhë prova gjatë procedurës dhe të vlerësojë rrethanat që janë të rëndësishme për të përcaktuar nëse produktet kanë ardhur si rezultat i aktivitetit kriminal.

Neni 72 siguron bazën ligjore për aksesin ndaj të dhënave bankare. Gjyqtari i procedurave paraprake mundet, me kërkesë të prokurorit, të urdhërojë një bankë apo persona të tjerë juridikë të cilët kryejnë aktivitete financiare të dorëzojnë të dhëna mbi llogaritë bankare të të dyshuarve dhe personave të lidhur me ta. Në raste të ngutshme, e njëjta gjë mund të urdhërohet nga prokurori, i cili ka detyrimin që të njoftojë menjëherë për këtë gjyqtarin, në mënyrë që ky i fundit të lëshojë urdhrin përkatës brenda 72 orësh. Urdhri për monitorimin nuk është i rregulluar në mënyrë specifike.

Masat e përkohshme (sekuestrimi, ndalimi i disponimit)

Sekuestrimi i instrumentave dhe provave bëhet me urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake, me kërkesë të prokurorit ose zyrtarit të autorizuar, i cili ka marrë më parë miratimin e prokurorit (Neni 65 KPP). Objektet mund të sekuestrohen pa pasur urdhër nga gjykata, në rastet kur ka rrezik për vonesa, por brenda 72 orësh, prokurori është i detyruar të bëjë kërkesë tek gjyqtari për miratim të mëtejshëm. (Neni 66 i KPP).

Në bazë të Nenit 72 të KPP, gjykata mund të urdhërojë ngrirjen e transaksioneve financiare nga ana e personave juridikë apo fizikë, për rastet kur dyshohet se ato janë të lidhura me një aktivitet kriminal, do të përdoren për kryerjen e një veprë penale, ose shërbejnë për të fshehur një vepër penale apo produktet e saj. Bazuar në kërkesën e prokurorit, gjykata mund të vendosë që mjetet financiare apo paratë e sekuestruara të depozitohen në një llogari të veçantë, ku ruhen deri në fund të procedimit.

Masa e përkohshme e sekuestrimit **të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme** rregullohet me Neni 73 të KPP, i cili siguron bazën ligjore edhe për masa të tjera me qëllim parandalimin e përdorimit, transferimit apo përvetësimit të këtyre pronave. Gjykata vendos një masë të përkohshme me kërkesë të prokurorit, e cila mund të merret në çfarëdolloj faze të procedimit penal. Në rastet kur ka rrezik për vonesa, sekuestrimi dhe masa të tjera mund të merren edhe nga zyrtarë të tjerë të autorizuar (policia). Për këtë njoftohet menjëherë prokurori, i cili duhet që brenda 72 orësh të bëjë pranë gjykatës kërkesën për miratim të urdhrit.

Neni 395 parashikon masa të përkohshme sigurimi. Gjykata, edhe *ex officio*, është e detyruar të bëjë përkufizimin e këtyre masave dhe të zbatojë dispozitat e aplikueshme në procedurën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Në praktikë, masat më të zakonshme janë ndalimi i shitjes,

sekuestrimi dhe depozitimi i vlerave monetare, si dhe ngrirja e llogarive bankare të personave të dyshuar apo akuzuar.

Administrimi

Produktet e sekuestruara të krimit depozitohen në gjykata, ndërkohë që ruajtja e tyre sigurohet edhe në forma të tjera. (Neni 70). Çështja e administrimit të objekteve të sekuestruara (produkteve) nuk është zgjidhur në mënyrën e duhur, për sa kohë dispozita e përshkruar më lart nuk i jep përgjigje të gjitha problemeve që lidhen me administrimin e pasurive të sekuestruara. Nuk është ngritur asnjë institucion i specializuar për administrimin.

2.2.2 Shtrirja e konfiskimit

Neni 110/3⁸ përbën risi, pasi parashikon që gjykata të vendosë për konfiskimin e produkteve të krimit me anë të një procedure të veçantë, në se ekzistojnë shkaqe të bazuara për të besuar se pasuritë janë krijuar nëpërmjet një vepre penale, ose kur zotëruesi nuk mund të provojë prejardhjen e ligjshme të tyre.

Barra për të provuar prejardhjen e ligjshme të pasurive i kalon pronarit apo zotëruesit të tyre. KPP i Bosnje-Hercegovinës nuk përmban dispozita të cilat do të mund të zbatoheshin për procedurën e veçantë të konfiskimit (të shtrirë) të produkteve. Për këtë arsye, kjo dispozitë nuk përdoret në praktikë, megjithëse disa gjyqtarë kanë deklaruar se e kanë përmbushur qëllimin e tij nëpërmjet aplikimit të vlerësimit të lirë të vlerës së pasurive. (Neni 394 KPP).

Në përgjithësi, dispozita krijon mundësinë e përdorimit gjerësisht të konfiskimit të shtrirë, pasi ai nuk kufizohet tek një listë krimesh të rënda (parimi i proporcionalitetit). Standardi i provës (shkaku i bazuar për të besuar), është i ulët për dyshimet lidhur me prejardhjen e paligjshme të produkteve, por në të njëjtin kohë kufizohet tek një vepër penale e vetme, gjë që mund të tregojë se do të ishte e nevojshme një lidhje më e ngushtë me veprën penale (dhe jo me disa vepra), përveç atyre të proceduara dhe gjykuara. Dyshimi për origjinë të paligjshme të pasurisë mbështetet në mungesën e përputhshmërisë së pasurive, ndërsa të ardhurat e deklaruar nuk përmenden.

Nuk është saktësuar standardi i provës për të dyshuarin apo pronarin, nëpërmjet të cilit këta të fundit duhet të provojnë ligjshmërinë e prejardhjes së pasurive. Për sa kohë nuk ka të dhëna për zbatimin në praktikë të dispozitës, është e vështirë të parashikohet pozicioni dhe praktika e ardhshme e gjykatës. Sipas interpretimit gjuhësor të dispozitës, aplikimi i saj në praktikë mund të rezultojë problematik nga pikëpamja e respektimit të drejtave të njeriut.

Janë bërë disa përpjekje për të siguruar bazën ligjore për një 'procedurë të veçantë', gjë e cila kërkohej nga KP, por këto përpjekje nuk gjetën mbështetjen e qeverisë. Propozimi i lartpërmendur u përgatit nga ekspertë irlandezë dhe amerikanë, dhe parashikonte futjen e procedurës së thjeshtë administrative, e cila sipas mendimit tim, do të ishte vështirë të zbatohet në sistemin ligjor kontinental që ka vendi. (edhe në se do të përfshiheshin në procedurën penale disa instrumenta Anglo-Sakson)

2.2.3 Përgatitja e legjislacionit

Meqenëse dispozita e Nenit 110/3 e KP nuk zbatohet në praktikë, dhe është vënë në dukje nevoja për të rregulluar me ligj procedurën e veçantë, ka pasur një propozim që Bosnje-Hercegovina të hartojë një ligj të veçantë për konfiskimin e shtrirë, por ky propozim është hedhur poshtë nga

⁸ 110/3 KPP: Gjykata mund të konfiskojë edhe pasuritë e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni nëpërmjet një procedimi të veçantë, në se ka shkak për të besuar se pasuritë janë produkt i një vepre penale, ose kur zotëruesi nuk provon prejardhjen e ligjshme të tyre.

qeveria. Propozimi mbështetet kryesisht në modelin irlandez. Ministri i Drejtësisë i Bosnjes dhe Hercegovinës (Z. Jusuf Halilagić) po punon mbi disa propozime të reja për ligjin.

2.2.4 Institucionet⁹

Policia

Zyrtari i autorizuar (i zbatimit të ligjit) përkufizohet nëpërmjet Nenit 20 KPP: Është personi me autoritetin e duhur brenda organeve të policisë në Bosnje-Hercegovinë, duke përfshirë edhe Agjensinë Shtetërore të Hetimit dhe Mbrojtjes (SIPA), Shërbimin Kufitar Shtetëror (SBS), policinë gjyqësore dhe financiare (megjithëse nuk ka shërbime me emërtime të tilla) administratën doganore, atë tatimore¹⁰ si dhe policinë ushtarake. Me përjashtim të organeve të policisë, agjensitë e tjera kanë rol, përgjegjësi dhe kompetenca të kufizuara për sa i përket procedimit dhe hetimit financiar.

SIPA¹¹ është e vetmja agjensi shtetërore e zbatimit të ligjit e cila ka kompetenca për të vepruar në të gjithë territorin e Bosnje- Hercegovinës. Detyra e saj është të zbulojë produktet e krimit gjatë hetimeve penale. Një nga njësitë e saj organizative, Departamenti i Informacionit Financiar (FIU), funksionon edhe mbi bazën e Ligjit të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Prokurori

Prokurori drejton hetimin dhe gjatë hetimit ka si detyrë të mbledhë prova dhe të shqyrtojë rrethanat që lidhen me vlerësimin e përfitimeve të pasurive. Prokurori mund të urdhërojë policinë që të kryejë veprimet hetimore. Roli i përgjithshëm i prokurorit përcaktohet nga Neni 35 i KPP. Zyrtarët e autorizuar duhet që të punojnë gjatë procedurës penale nën drejtimin e prokurorit, por edhe në mënyrë të pavarur brenda kompetencave të tyre. (Neni 218 KPP).

Me përjashtim të SIPA, institucionet e tjera të zbatimit të ligjit dhe shërbimi i prokurorisë nuk kanë njësi të specializuar për hetimin financiar. Nuk ka baza të dhënash apo statistika mbi hetimet financiare, masat e përkohshme dhe konfiskimet.

Gjykata

Gjyqtari i procedimit paraprak vendos për masat e përkohshme të sigurisë dhe lejon aksesin në të dhënat bankare. Neni 73 i KPP kërkon që propozimi për marrjen e këtyre masave të bëhet nga prokurori (ose zyrtari i autorizuar në rastet e ngrirjes së llogarive bankare), Neni 395 i KPP parashikon që gjykata *ex officio* të vendosë për masa të përkohshme sigurie, në rastet kur konfiskimi i pasurisë së fituar është i pamundur.

Gjykata mund të japë urdhërojë konfiskimin (duke përcaktuar objektet dhe shumën monetare) nëpërmjet një vendimi i cili e deklaron personin e akuzuar fajtor, një vendimi për aplikimin e një

⁹ Faqe interneti: www.vijceministara.gov.ba, www.fbihvlada.gov.ba, www.vladars.net, www.bdcentral.net (Government of District Brčko), www.parlament.ba, www.parlamentfbih.gov.ba, www.narodnaskupstinars.net, www.mpr.gov.ba (Ministry of Justice Bosnia and Herzegovina), www.vladars.net/lt/min/mpr.html (Ministria e Drejtësisë e RS), www.fbihvlada.gov.ba/indexx.html (Ministria e Drejtësisë e Federatës së Bosnjes dhe Hercegovinës)

¹⁰ Ligji mbi Administratën Tatimore Jo-të Drejpërdrejtë (Article 2/b) Përcakton rolin e kësaj të fundit (ITA) (Sektori për Zbatimin e Rregulloreve tatimore dhe Doganore, Departamenti i Hetimit) në kuadrin e procedurës penale, dhe se rregullat e KPP për policinë vlejnë edhe për ITA-n.

¹¹ Një nga kompetencat e SIPA- është parandalimi, zbulimi dhe hetimi i veprave penale që janë në juridiksionin e Gjyktës së Bosnje- Hercegovinës, shprehimisht : i krimit të organizuar, terrorizmit, krimeve të luftës, trafimit të genieve njerëzore, vepra të tjera penale kundër njerëzimit si dhe krime të rënda financiare.

mase rregulluese,dhe një vendimi i cili shprehet se i akuzuari e ka kryer veprën penale në gjendje paaftësie mendore,por kjo vepër është shoqëruar me pasoja të dëmshme.

2.2.5 Përfundime

Bosnja dhe Hercegovina ka filluar të zbatojë hetimin e drejtuar nga prokurori.

Shumica e privimeve nga pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme në Bosnje-Hercegovinë janë arritur në çështjet ku ka pasur marrëveshje për pranimin e fajit, të lidhura kryesisht me pastrimin e parave, dhe me vepër penale të pranuar evazionin fiskal. Problemi është se në këto marrëveshje shpesh "harrohet" konfiskimi i produkteve të krimit (qëllimi është ndëshkimi!) Në praktikë hetimi financair nuk është bërë ende pjesë integrale e hetimit penal.

Mungesa e mundësive të qarta ligjore për procedurën e veçantë lidhur me konfiskimin e shtrirë (Neni 110/3 KP) pengon zbatimin e dispozitës ekzistuese. Mungon edhe baza e veçantë ligjore për të dhënat bankare. As urdhri për monitorimin nuk është i mbështetur me legjislacionin përkatës. Diskutimet kanë treguar se nuk janë konfiskuar të gjitha produktet e krimit, por vetëm vlerat monetare të gjetura në llogari bankare. Prokuroria dhe gjykata po sheh mundësinë e përgatitjes së udhëzuesve, ku të trajtohet edhe çështja e konfiskimit të produkteve në marrëveshjet e pranimin të fajit.

SIPA nuk është plotësisht funksionale në kryerjen e detyrave të saj si agjensi e zbatimit të ligjit. Bashkëpunimi mes policive dhe agjensive të tjera të zbatimit të ligjit të njësive administrative vazhdon të jetë sfidë.

Mungesa e Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara u ngrit si problem që haset në praktikë.

Nuk ka baza të dhënash apo statistika mbi hetimet financaire,sequestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit.

Neni 110/3 parashikon mundësinë e aplikimit të konfiskimit të shtrirë. Gjakata mund të vendosë për konfiskimin e produkteve të krimit nëpërmjet një procedure të veçantë, në se ka shkaqe të bazuara për të menduar se pasuritë janë fituar nëpërmjet një vepre penale ose kur pronari apo zotëruesi nuk është në gjendje të provojë ligjshmërinë e prejardhjes së tyre.

Procedura e veçantë për konfiksimin (e shtrirë) e parashikuar nga Neni 110/3 nuk specifikohet. Për këtë arsye dispozita nuk përdoret në praktikë, megjithëse disa gjyqtarë u shprehën se e kanë përmbushur qëllimin e saj nëpërmjet aplikimit të vlerësimit të lirë të vlerës së produkteve. (Neni 394 KPP).

Vështrim i përgjithshëm

CC		Bosnja dhe Hercegovina
Konfiskimi	74, 110, 111	Neni 110: Baza e Konfiskimit të Përfitimeve Materiale
Produkte të Drejtpërdrejta/ të Tërthorta	111	Neni 111: Mënyrat e Konfiskimit të Përfitimeve Materiale
Konfiskimi në bazë të vlerës	111/1	
Persona të Tretë	111/1	
Persona Juridike	po	Shih 396/3 KPP
Konfiskimi i shtrirë	110/3	110/3: Gjykata mundet gjithashtu të vendosë për konfiskim të përfitimeve të parashikuara në paragrafin 1 të këtij Neni nëpërmjet një procedure të veçantë, kur ka shkaqe të bazuara për të besuar që përfitimi është rezultat i një vepre penale dhe kur pronari apo zotëruesi nuk është në gjendje të sjellë prova për ligjshmërinë e pasurisë së tij.
KPP		
Hetimi Financiar	392/2	Neni 392: Konfiskimi i pasurive të fituara nëpërmjet kryerjes së një vepre penale Përfitimet e pasurive nëpërmjet kryerjes së një vepre penale do të përcaktohet nëpërmjet një procedure penale <i>ex officio</i> . Prokurori është i detyruar të mbledhë të dhëna gjatë procedimit dhe të shqyrtojë rrethanat të cilat janë të rëndësishme për vlerësimin e pasurive të fituara nëpërmjet kryerjes së një vepre penale.
MPH	116, 117	
Akresi ndaj të dhënave bankare	72/1	
Konfiskimi i përkohshëm	65, 66, 72, 73, 395	Sekuestrimi i objekteve Neni 73: Sekuestrimi i Përkohshëm i Pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme dhe Ndalimi i Pronës... Në çfarëdoq momenti, Gjykata me kërkesë nga prokurori, mund të marrë masë të përkohshme për sekuestrimin e pasurive të paligjshme, në përputhje me Kodin Penal të Bosnjes dhe Hercegovinës, ndalimin e përdorimit të pronës ose mund të marrë masa të tjera të përkohshme për të parandaluar përdorimin, transferimin apo përvetësimin e këtyre pasurive...
Ngrirja e Llogarive bankare	72/4	Neni 72: Urdhër i cili i jepet një Banka apo një personi tjetër juridik
Procedura e Apelit		Neni 395: Masat e përkohshme të Sigurimit ...Në rastet kur është i mundshëm konfiskimi i pasurive të fituara nga kryerja e një vepre penale, Gjykata <i>ex officio</i> dhe sipas dispozitave të procedurave të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, bën përkufizimin e masave të përkohshme të sigurimit. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e Nenit 202 të këtij Kodi....
Administrimi	70	Neni 70: Ruajtja e Objekteve dhe Dokumentave të Sekuestruara ...depozitohen pranë Gjykatës...
Konfiskimi	396	Neni 396: Përmbajtja e vendimit që urdhëron masën e Konfiskimit të Pasurisë së Fituar

Vlerësimi i lirë i vlerës nga gjyqtari	394	
Legjislacion i veçantë		Parashikohet procedurë e veçantë për konfiskimin e shtrirë (Neni 110/3 KP). Ende e papërcaktuar.
		Institucionet (e specializuara)
Policia kriminale		SIPA (Policia e shtetit), shërbimet policore të njësive administrative, doganat, administrata e taksave
Administrata tatimore	20	Kompetencat e një policie
Prokuroria		Neni 218: Prokurori mbikqyr punën e Zyrtarëve të Autorizuar
Gjykata		

2.3 Kroacia – profil i vendit

2.3.1 Legjislacioni aktual¹²

Konfiskimi i shtrirë rregullohet me anë të amendimeve të fundit që i janë bërë Kodit Penal në vitin 2006 (Neni 82/2). Ndryshimet konceptuale në Kodin e Procedurës Penale janë duke u përgatitur. Pritet që propozimi të jetë gati në fund të vitit 2007. Është vendosur heqja e hetimit gjyqësor. Baza e veçantë ligjore për masat e përkohshme të sigurimit për konfiskim sigurohet nëpërmjet Ligjit mbi Zyrën për Goditjen e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (USKOK). USKOK është një njësi e specializuar brenda Zyrës së Prokurorit të Shtetit.

Konfiskimi

Neni 80 i Kodit Penal përcakton masat e sigurimit për konfiskim (sequestrum) të objektit i cili ishte parashikuar të përdorej apo është përdorur për kryerjen e një veprë penale, ose është rezultat i kryerjes së një veprë penale, kur ekziston rreziku se objekti mund të përdoret sërish për kryerjen e një veprë penale, si dhe për shkak të sigurisë publike dhe arsye morale.

Neni 82 i Kodit Penal rregullon konfiskimin e detyruar të produkteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të krimit, pas marrjes së vendimit nga gjykata. Produktet e krimit mund të konfiskohen edhe kur ato i kanë kaluar një pale të tretë apo një personi juridik, nëse ato nuk janë marrë prej tyre në mirëbesim.

Ligji mbi Përgjegjësinë e Personave Juridike për Vepra Penale i vitit 2004 parashikon përgjegjësinë penale të kompanive dhe vendos sanksione për sjellje joligjore nga ana e tyre, për qëllime përfitimi të vetë atyre apo të palëve të treta. Dispozita e nenit 20 e ligjit në fjalë parashikon konfiskim të detyruar të produkteve të cilat janë fituar si rezultat i një veprë penale të kryer nga ana e personit juridik.

Konfiskimi i bazuar në vlerë rregullohet nëpërmjet Nenit 82/2 të KP dhe Nga Neni 20/4 i Ligjit mbi Përgjegjësinë Penale të Personave Juridike. Pretendimet e viktimave për dëmshpërblim rregullohen nga Neni 82/4 KP dhe 464/3 KPP.

Nenet nga 463 deri në 471 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) përcaktojnë procedurën e konfiskimit të produkteve të krimit.

Gjykata urdhëron konfiskimin e produkteve të krimit nëpërmjet një vendimi që e deklaron të akuzuarin fajtor për veprën penale (Neni 468/1 i KPP). Vendimi duhet të përcaktojë objektet dhe vlerat monetare për t'u konfiskuar. Gjykata mund të vendosë vetë për vlerën e pasurisë që do të konfiskohet, në rastet kur vlerësimi do të shkaktonte pengesa dhe vonesa të mëdha të procesit gjyqësor. (Neni 466 i KPP).

Para dhe gjatë procesit gjyqësor sigurohet mbrojtja e të drejtave të personave të tretë apo juridikë, tek të cilët janë transferuar produktet e Krimit. Ata duhet të merren në pyetje dhe kanë të drejtën të ofrojnë prova dhe të bëjnë pyetje gjatë seancave. (Neni 465 I KPP).

¹² Kodi Penal (FZ 110/97, 27/98, 50/00, 51/01, 105/04, 84/05, 71/06).

Kodi i Procedurës Penale (FZ 110/97, 58/99, 112/99, 58/02 dhe teksit i rishikuar 62/03).

Ligji mbi Zyrën për Goditjen e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (FZ 88/01, 12/02, 33/05, 48/05).

Ligji mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave (FZ 69/97, 106/97, 67/01, 114/01).

Ligji mbi Përgjegjësinë e Personave Juridike për Vepra Penale (FZ 151/03).

Ligji mbi Mbrojtjen e Dëshmitarit (FZ 163/03),

Ligji mbi Ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore (FZ 57/96, 29/99).

www.vsrh.hr/EasyWeb.asp?pcpid=366

Hetimi financiar

Hetimi financiar nuk përcaktohet me saktësi nga legjislacioni penal. Baza ligjore mund të gjendet në Nenin 464 KPP, i cili parashikon që përfitimet e pasurisë përcaktohen *ex officio* në kodin e procedurës penale. Gjykata dhe autoritetet e tjera që kryejnë procedimin penal janë të detyruara të mbledhin prova dhe të hetojnë rrethanat përkatëse për të përcaktuar produktet e krimit.

Baza ligjore që siguron aksesin ndaj të dhënave të nevojshme për hetimin financiar gjatë fazës së para-hetimit (policia) gjendet në Nenin 186 (177) të KPP (kompetenca të përgjithshme të policisë) dhe Neni 174/3 (kompetencat e prokurorisë).

Akresi ndaj të dhënave bankare rregullohet me anë të nenit 219 të KPP. Gjyqtari hetues mund t'i kërkojë bankave të japin informacion mbi llogaritë bankare të të akuzuarit, ose të çdo personi ndaj të cilit kanë nisur procedurat për konfiskimin e produkteve të krimit. Gjyqtari hetues mund të urdhërojë bankën të dorëzojë të dhëna në fazën para-hetimore (policisë) në se pasuritë lidhen me vepra penale të kryera nga një grup apo organizatë kriminale, veprat penale të abuzimit me drogën, dhe të gjitha veprat e tjera penale të cilat dënohen me më tepër se tre vjet burg. (Neni 219/3 KPP).

Masat e përkohshme

Gjyqtari hetues (gjatë fazës së hetimit) dhe gjykata (gjatë procesit) *ex officio* urdhërojnë masa provizore sigurimi në rastet kur është duke u shqyrtuar mundësia e konfiskimit të pasurive, në përputhje me procedurat e ekzekutimit. (Neni 467 KPP). Ligji mbi procedurën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore përcakton edhe masat e përkohshme të sigurisë, nëpërmjet Neneve 297-299 (ndalimi i përdorimit, sekuestrimi...).

Gjykata mund të urdhërojë ngrirjen e një transaksioni financiar, i cili dyshohet se përbën vepër penale ose se fsheh një vepër penale apo produktet që rrjedhin prej saj. Vlerat e ngrira monetare depozitohen në një llogari të veçantë, ku edhe ruhen deri në përfundim të procesit ose deri sa të përmbushen kushtet për kthimin e tyre (Nenet 219/5 dhe 6 KPP). Monitorimi i llogarive bankare nuk parashikohet nga KPP.

Gjykata mund të urdhërojë sekuestrimin e përkohshëm të objekteve, të cilat parashikohen për t'u sekuestruar sipas KP, ose që përbëjnë prova. (218 KPP). Bazuar në dispozitat e Nenit 218/8, policia, gjithashtu, mund t'i sekuestrojë këto objekte gjatë ushtrimit të kompetencave të saj të parashikuara në Nenin 186 (kompetenca të përgjithshme të policisë) dhe Nenin 196/1 KPP (masa urgjente hetimore). Dispozita interpretohet në mënyrë të tillë që nuk i lejon policisë të sekuestrojë produktet e krimit, në se ato nuk përbëjnë prova të veprës penale. Disa objekte përjashtohen nga sekuestrimi. (Neni 218/3 KPP).

Neni 463 vendos rregullat për konfiskimin (sekuestrimin) e objekteve në rastet kur procesi gjyqësor nuk përfundon me vendim dënimi, por për shkak të sigurisë publike dhe për të ruajtur nderin dhe dinjitetin e qytetarëve.

Kufizimet në aplikimin e masave të përkohshme gjatë fazës para-hetimore duhet të merren parasysh në Kodin e ri të PP. Në të njëjtën kohë, ky kod duhet trajtojë edhe problemin e mungesës së dispozitave për administrimin (dhe shitjen) e objekteve dhe pasurive të sekuestruara dhe konfiskurara. Krijimi i një agjencie të administrimit dhe manaxhimit do të ndihmonte për të ndjekur shembujt e suksesshëm të disa vendeve Europiane.

Ligji mbi USKOK

Ligji për Zyrën e Goditjes së Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (USKOK) përcakton mënyrën e organizimit dhe përgjegjësitë e USKOK, marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore,

juridiksionin e gjykatave, si dhe masat e përkohshme të sigurimit për konfiskimin e produkteve të krimit. USKOK është një shërbim i specializuar brenda prokurorisë, që ka si detyrë ndjekjen e krimeve të rënda dhe të produkteve të krimit.

Zbatimi i këtij ligji dhe përgjegjësia e USKOK kufizohet në listën e krimeve (të rënda) të përmendura në ligj (Neni 21). Procedurat e veçanta për askesin ndaj të dhënave bankare (Neni 42a) dhe masat e përkohshme për të siguruar konfiskimin në një fazë tjetër të produkteve të krimit parashikohen nga Nenet 44-56. Për masat e përkohshme të sigurimit do të zbatohen rregullat e procedurës së ekzekutimit. (Neni 44/1). Konfiskimi, si i tillë, nuk rregullohet me anë të ligjit mbi USKOK, pasi ai parashikohet në procedurën penale.

Me përmbushjen e disa kushteve, USKOK mund t'u kërkojë bankave që të dorëzojnë të dhëna mbi llogaritë bankare. (Neni 42a). Në se banka refuzon nxjerrjen e të dhënave, USOK mund t'i bëjë kërkesë gjyqtarit hetues për të lëshuar urdhrin përkatës. Gjykata mundet, gjithashtu, të urdhërojë edhe monitorimin e transaksioneve bankare. (Neni 42a/4).

Masat e përkohshme të sigurimit merren me urdhër të gjykatës, së cilës ia jep këtë kompetencë Neni 24 për veprat penale të përmendura në Nenin 21, bazuar në një kërkesë të argumentuar nga USKOK. Procedura është urgjente dhe mund të nisë para se të ketë filluar procedura penale. Vlera e pasurisë së fituar nga veprat penale të renditura në listë mund të përcaktohet në përputhje me rregullat e procedurës civile.

Gjykata urdhëron marrjen e masave të përkohshme në se ka shkaqe të bazuara për të besuar se krijimi i pasurisë rrjedh në mënyrë të drejtpërdrejtë po të tërthortë nga veprat penale të përmendura në listë, në se vlera e saj është më e madhe se 100 000 HRK, dhe ekziston rreziku se autori i veprës, gjatë procedimit penal do ta bëjë konfiskimin të vështirë ose të pamundur. (Neni 50/1). Masat e sigurimit parashikohen në ligjin e ekzekutimit. Ngrirja e llogarive bankare rregullohet nëpërmjet Nenit 50/5 (amenduar në 2005). Vendimi i gjykatës për masat e përkohshme të sigurimit duhet të rikonfirmohet brenda 21 ditësh. Gjatë kësaj periudhe gjykata thërret palët, dhe pronari ka mundësinë të provojë që nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në Nenin 50/1 (Neni 52/3). Barra e provës i mbetet pronarit vetëm në lidhje me masat e përkohshme të sigurimit. Masat e përkohshme mund të zgjaten 6 muaj deri në maksimalisht 1 vit. Në se brenda 1 viti nuk ka nisur ende procedimi penal, atëherë gjykata me propozim të pronarit të pasurisë së sekuestruar nxjerr urdhrin e anulimit të vendimit.

Është deklaruar se USKOK i ka zbatuar në praktikë dispozitat dhe ka vendosur standardin që çdo raport i bërë nga policia mbi një vepër penale duhet të përmbajë të dhëna mbi pasuritë që mund t'i konfiskohen të dyshuarit. (raport mbi hetimin financiar).

2.3.2 Shtrirja e konfiskimit

Konfiskimi i shtrirë u përfshi në Kodin Penal nëpërmjet amendimeve që iu bënë atij në vitin 2004¹³. Është deklaruar se kjo dispozitë nuk është shumë e qartë për prokurorët dhe se është e nevojshme të përfshihen rregulla të reja (në KPP dhe në ligjin mbi USKOK) në mënyrë që ajo të jetë e zbatueshme në praktikë.

¹³ U članku 82. iza stavka 1. dodaje se novi stavak 2. koji glasi:

„(2) Kao imovinska korist iz stavka 1. ovoga članka smatra se i ona korist koju je ostvarila grupa ljudi ili zločinačka organizacija koja je u vremenskoj povezanosti s počinjenim kaznenim djelom i za koju se osnovano može smatrati da potječe od tog djela, jer se njezino zakonito porijeklo ne može utvrditi.“ Dosadašnji stavci 2., 3. i 4. postaju stavci 3., 4. i 5.

Neni i ri 82/2 KP (përkthim jo-zyrtar): Si përfitim pasurie që përfshihet në paragrafin 1 të këtij ligji është edhe pasuria e vëna nga një grup personash apo organizatë kriminale, e cila përputhet në kohë me veprën penale të hetuar, pra ka shkaqe të basuara për të besuar që kjo pasuri është rezultat i krimit dhe origjina e saj e ligjshme nuk mund të provohet.

Interpretimi gjuhësor tregon se prokuroria duhet të provojë (besim i bazuar) lidhjen në kohë mes një veprë konkrete penale të kryer nga një grup njerëzish apo organizatë kriminale dhe pasurisë së krijuar, dhe njëkohësisht të provojë se nuk mund të vërtetohet prejardhja e ligjshme e pasurisë së fituar.

Barra e provës për prejardhjen e ligjshme të pasurisë nuk i kalon automatikisht të dyshuarit, gjë që do të thotë se edhe prokuroria duhet të përpiqet të zbulojë prejardhjen e pasurisë, pa përjashtuar të drejtën e të akuzuarit që të sjellë prova që dëshmojnë ligjshmërinë e prejardhjes së pasurisë së tij.

Zbatimi i dispozitës kufizohet tek vepra konkrete penale e hetuar, e cila është kryer nga një grup personash apo një organizatë kriminale. Përcaktimi i kësaj lidhje mund të jetë i vështirë në praktikë, pasi këto lloj organizatash nuk kufizohen në kryerjen e një lloji të vetëm veprë penale (në mënyrë të vazhdueshme) .

Nëse do të kishim një përkufizim të gjerë: “vepra penale”, atëherë edhe mundësitë do të ishin më të mëdha. Për më tepër, kufizimi tek një grup njerëzish apo organizatë kriminale mund të bëhet pengesë në praktikë, pasi mund të mos zbulohen të gjithë pjesëmarrësit në kryerjen e veprës penale, ose roli i tyre mund të mos provohet gjatë procedimit penal.

Gjykata duhet t’u japë përgjigje këtyre pyetjeve, si dhe çështjes së standardit të të dhënave (shkak i bazuar për të besuar) për lidhjen mes veprës penale dhe pasurive.

Problemi tjetër është nëse kjo dispozitë mund të zbatohet edhe për pasuritë e fituara para miratimit të ligjit.

2.3.3 Përgatitja i legjislacionit

Ndryshimet konceptuale në Kodin e Procedurës Penale janë duke u përgatitur nga një grup pune, i ngritur nga Ministria e Drejtësisë dhe priten të përfundojnë në fund të vitit 2007. Është parashikuar heqja e hetimit gjyqësor. Mund të përfshihen edhe dispozita që do të rregullojnë administrimin e objekteve dhe pasurive të krimit të sekuestruara apo konfiskuara.

2.3.4 Institucionet

Policia

Departamenti për hetimin financiar brenda strukturës së policisë kriminale (PK) ka rol kryesor në kryerjen e hetimit financiar dhe gjetjen e produkteve të krimit. Ky departament ka gjithashtu për detyrë të kryejë hetimet që lidhen me pastrimin e parave. Ai ofron asistencë në çështje të rëndësishme, ku hetimi financiar kryhet në bashkëpunim me njësi të tjera brenda PK. Departamenti njëkohësisht koordinon hetimet financiare dhe siguron mbështetje për njësitë rajonale të policisë kriminale.

Propozimi i bërë në vitin 2007 për të ngritur një njësi të specializuar brenda njësisë kriminale për të kryer vetëm hetimet financiare, nuk gjeti përkrahje. Debati për qasjen më të mirë të specializuar ndaj problemit nuk ka përfunduar.

Kompetencat e përgjithshme të policisë parashikohen nga Neni 186 i KPP, i cili nëpërmjet lejitimit të aksesit ndaj të dhënave bankare gjatë procedimit penal, njëkohësisht siguron edhe bazën ligjore për hetimin financiar.

Shërbimi i prokurorisë

Në sistemin me hetim gjyqësor, është prokurori që drejton hetimin paraprak (policor). Masat hetimore gjatë fazës para-hetimore merren me urdhër të gjyqtarit hetues, me propozim të prokurorisë ose policisë.

Sipas Nenit 42 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori ka për detyrë marrjen e të gjitha masave të nevojshme me qëllim zbulimin e veprave penale dhe autorëve të tyre, dhe autorizon ndërmarrjen e veprimeve dhe masave të veçanta hetimore, që shërbejnë për mbledhjen e të dhënave në dobi të institucionit që kryen procedimin penal.

Prokurori mund t'u kërkojë bankave, organizatave apo personave të tjerë juridikë të vënë në dispozicion të dhëna, përveç atyre që konsiderohen sekret dhe mbrohen si të tilla (Neni 174 KPP).

Zyra për Goditjen e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (USKOK)

USKOK është një njësi e specializuar brenda Zyrës së Prokurorit të Shtetit, e krijuar në bazë të Ligjit mbi USKOK në vitin 2001. USKOK ka si detyrë hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale (të rënda) të përmendura në listë, si dhe gjetjen dhe sekuestrimin e produkteve të krimit. Prokuroria dhe policia nuk mban të dhëna sistematike apo statistika mbi hetimet e kryera financiare apo mbi masat e përkohshme që janë marrë. Megjithatë është vënë në dukje se në shumë raste është urdhëruar marrja e masave të përkohshme. USKOK solli të dhëna mbi një vendim të formës së prerë të vitit 2006, ku ishin konfiskuar produktet e krimit, dhe disa raste të tjera ku, me propozim të tyre, ishte vendosur për marrjen e masave e përkohshme.

2.3.5 Përfundime

Adaptimi i një qasje të veçantë për hetimin financiar brenda policisë kriminale është një çështje në diskutim e sipër, pasi propozimi për krijimin e një strukture më vete nuk u pranua në vitin 2007.

USKOK ka mundësi më të gjera për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, gjë që i sigurohet nga Ligji mbi USKOK, ku përfshihen edhe rregullat e posaçme për masat e përkohshme të sigurimit që lejojnë konfiskimin në një fazë të mëvonshme të produkteve të drejtpërdrejta apo të tërthorta që rrjedhin nga veprat penale të përmendura në ligj.

Policia dhe shërbimi i prokurorisë nuk ruajnë të dhëna apo statistika mbi hetimin financiar dhe konfiskimin e përkohshëm. Administrimi i produkteve të krimit është përmendur si problem real në praktikë. Është në diskutim e sipër baza ligjore për krijimin e agjensisë për administrimin e objekteve dhe pasurive të sekuestruara.

Hetimi financiar nuk përcaktohet në mënyrë specifike nga KPP apo nga Ligji mbi Policinë. Monitorimi i llogarive bankare është i mundshëm vetëm për veprat penale të përfshira në objektin e Ligjit mbi USKOK.

Masat e përkohshme në fazën para-hetimore sipas KPP janë të mundshme vetëm në një numër të kufizuar rastesh. Ligji mbi USKOK ofron mundësi më të mëdha dhe parashikon procedurën civile për të vendosur mbi marrjen e masave të përkohshme të sigurimit.

Konfiskimi i shtrirë është përfshirë në ligj në vitin 2006 (Neni 82/2 KP) por nuk "është provuar" ende në praktikë. Pikëpyetjet që lindin nga formulimi i dispozitës së re, ngrenë dyshime për një interpretim shumë kufizues, gjë që do ta bënte të vështirë zbatimin e saj në praktikë.

Pyetja tjetër është nëse kjo dispozitë do të përdoret edhe për konfiskimin e pasurive të fituara para miratimit të këtij ligji.

2.3.6 Vështrim i përgjithshëm

KP		Kroacia
Konfiskimi	80, 82	Neni 80: Sekuestrimi i objekteve Neni 82: Konfiskimi i përfitimeve financiare të realizuara nëpërmjet një kryerjes së një veprë penale
Produktet e drejtpërdrejta/tërthorta	?	Nuk është specifikuar
Konfiskimi i bazuar në vlerë	82/2	Të paguajë shumën përkatëse të parave
Personat e Tretë	82/3	
Personat Juridikë	20	Neni 20 i Ligjit mbi Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë: Konfiskimi i pasurive të krijuara në mënyrë të paligjshme (2) Përfitimet e marra në mënyrë të paligjshme të parashikuara në paragrafin (1) të këtij seksioni nënkupton çdo rritje apo parandalim i zvogëlimit të pasurisë së pasurisë së personit juridik, që vjen si rezultat i kryerjes së një veprë penale. (...)
Konfiskimi i Shtrirë	82/2 i ri	Si përfitim pasurie (produkt krimi) në kuptim të paragrafit 1 të këtij ligji do të konsiderohen edhe përfitimet e krijuara nga grupi i personave apo organizata kriminale të cilat kanë lidhje në kohë me veprën penale, në rast se ka shkaqe të bazuara për të dyshuar se rrjedh nga kryerja e kësaj veprë penale, pasi nuk provohet prejardhja e ligjshme. (Përkthim jo-zyrtar)
KPP		
Hetimi financiar	464/2 174	(2) Gjykata dhe autoritetet e tjera të cilat bëjnë procedimin penal, gjatë këtij procesi kanë për detyrë të mbledhin të dhëna dhe të vlerësojnë rrethanat që lidhen me përcaktimin e përfitimeve financiare.
MPH	Po	
Faza para fillimit të procesit gjyqësor	?, 219/3	
Akresi ndaj të dhënave bankare	219/3	Neni (234 i ri) (3) Gjyqtari hetues mund të urdhërojë bankat që t'i dorëzojnë informacion mbi llogaritë bankare të personit të akuzuar, ose cilitdo personi tjetër ndaj të cilit kanë nisur procedurat e konfiskimit të përfitimeve financiare që janë fituar si rezultat i kryerjes së një veprë penale. Një kërkesë e tillë mund të bëhet edhe para fillimit të hetimit, ose para fillimit të procedurave për konfiskim të përfitimeve financiare, në rast se ka dyshime që në këto llogari janë depozituar para që kanë ardhur si rezultat i përfshirjes në një vepër penale të kryer nga një grup.... ose organizatë kriminale, ose nga vepra penale që lidhen me drogën..., vepra penale të dënueshme me më shumë se tre vjet burg.
Konfiskimi i përkohshëm	218 objekte 467 Produkt e	Neni 218 (233 i riu): Sekuestrimi i përkohshëm i Objekteve (1) Objekte, të cilat sipas KP duhet të sekuestrohen, ose të cilat mund të shërbejnë për vlerësimin e fakteve në proces... Neni 467 (486 i riu) Kur është duke u shqyrtuar mundësia e konfiskimit të përfitimeve financiare, gjykata, në përputhje me dispozitat që rregullojnë

	297-299 Ligji mbi ekzekutimin	ekzekutimin e vendimeve, mund të urdhërojë marrjen e masave të përkohshme të sigurimit. Në se kemi të bëjmë me një rast të tillë, atëherë do të aplikohen dispozitat e Nenit 136 (142-i riu) paragrafi dy i këtij ligji.
Para procesit gjyqësor	218/8	218 (8) Autoritetet e policisë mund të bëjnë sekuestrimin e objekteve... në zbatim të dispozitave të Nenit 186 dhe 196, paragrafi 1 të këtij ligji, ose kur janë duke ekzekutuar një vendim të gjykatës.
Ngrirja e llogarive bankare	219/5	219/5 Gjykata, nëpërmjet një vendimi, mund të urdhërojë një individ apo person juridikë që të pezullojnë përkohësisht kryerjen e një transaksioni financiar, në se ka dyshime se ky i fundit përbën vepër penale, shërben për të fshehur një vepër penale apo përfitimet që kanë rrjedhur prej saj.
Procedura e Apelit		
Administrimi	219/6	219/6 ...mjetet financiare ... do të depozitohen në një llogari të veçantë, ku do të ruhen deri në përfundim të procesit, apo deri sa të përmblidhen kushtet për rikthimin e tyre.
Konfiskimi	468 463 (objekte)	Neni 468 (487-i riu): (1) Gjykata mund të urdhërojë konfiskimin e përfitimeve financiare nëpërmjet një vendimi i cili e shpall personin fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet Neni 463 (482- i riu): (1) Objektet të cilat sipas Kodit Penal duhen sekuestruar, do të sekuestrohen edhe në rastet kur procesi nuk përfundon me dënim, kur kjo është në funksion të sigurisë publike dhe të mbrojtjes së moralit dhe dinjitetit të qytetarëve...
procedura	465 469-471	Neni 465 (484- i riu): (1)... personi tek i cili janë transferuar përfitimet financiare si dhe përfaqësuesi i personit juridik thirren për t'u pyetur para dhe gjatë procesit gjyqësor. Në ftesë duhet të shënohet se procesi do të vazhdojë edhe në rast se ata nuk paraqiten. ...
Vlerësimi i lirë i vlerës nga gjyqtari	466	Neni 466 (485- i riu): Përcaktimi i shumës së përfitimit financiar i lihet në dorë gjykatës në të gjitha rastet kur vlerësimi do të paraqiste vështirësi apo vonesa në proces.
Ekzekutimi		
Legjislacioni i veçantë		Ligji mbi Zyrën për Goditjen e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar
Links		www.vsrh.hr/EasyWeb.asp?pcpid=366
Institucione (të specializuara)		
Ministria e Brendshme		Policia kriminale
Prokuroria		Zyra për goditjen e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (USKOK)

		Ligji mbi Zyrën për Goditjen e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar
Hetimi financiar	21 44	Kufizohet në një listë krimesh (neni 21)
MPH	Po	
Faza para procesit	po	Neni 44/2: Procedura civile
Aksesi ndaj të	42a	

dhënave bankare		
Urdhri i monitorimit	42a/4	
Konfiskimi i Përkohshëm	44-56 50/1 52/3	Neni 50 (1) Gjykata, me propozim të Zyrës, urdhëron marrjen e masës së sekuestrimit të mjeteve, produkteve dhe pasurive që rrjedhin nga veprat penale të përmendura në Nenin 21 të këtij ligji, në rast se: 1. ka shkaqe të bazuara për të besuar se mjetet, produktet apo pasuritë kanë rrjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga një vepër penale e përmendur në Nenin 21 të këtij ligji, 2. Vlera e këtyre mjeteve, produkteve apo pasurive nuk e kalon shumën prej 100,000,00 Kuna; 3. ka shkaqe për të besuar se autori i veprave penale të përmendura në Nenin 21 të këtij ligji, para ose gjatë procedimit penal do të përpiqet të parandalojë apo të vështirësojë sekuestrimin e mjeteve, produkteve apo pasurive të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë rrjedhin nga kryerja e një vepre penale të parashikuar në Nenin 21 të këtij ligji. (2) Si masa sigurie, gjykata mund të specifikojë një ose më shumë masa të parashikuara në Ligjin mbi Sekuestrimin, veçanërisht ...
Para procesit		
Ngrirja e llogarive bankare	50/5 neë	
Procedura e Apelit	44/2 46,47 53-55	Neni 44 (1) ... procedura nëpërmjet të cilës Zyra dhe gjykatat, me masa të mëparshme apo të përkohshme sigurojnë mjetet, produktet, dhe pasuritë që rrjedhin nga veprat penale të përmendura në Nenin 21 të këtij ligji (2) Procedura që përmendet në paragrafin 1 nuk përbën procedim penal dhe përfshin zbatimin korrekt të dispozitës së Ligjit mbi Ekzekutimin e Vendimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kroacisë Nr. 57/96 dhe Nr 29/99), me përjashtim të rasteve kur në ligj është parashikuar ndryshe. (3) Konfiskimi i mjeteve, produkteve apo pasurive të përmendura në paragrafin 1, do të kryhet në përputhje me dispozitat për sekuestrimin e produkteve të përfshira në Kodin e Procedurës Penale. Neni 47: procedura e përsheptuar. 51/4: 21 ditë, 52/4 dhe 5: 6 muaj, një vit.
	52/3	Përmbysja e barrës së provës
Administrimi		
Vlerësimi i lirë i vlerës	49/2	

2.4 "Ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë" – Profili i vendit

2.4.1 Legjislacioni aktual¹⁴

Legjislacioni penal është amenduar në 2004 dhe 2005.

Konfiskimi i produkteve të krimit

Konfiskimi i produkteve të Krimit parashikohet nga Kodi Penal (KP, Nenet 97 deri 100). Konfiskimi i pasurive të drejtpërdrejta apo të tërthorta, ku përfshihen paratë, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çfarëdolloj pasurie tjetër, të drejta materiale dhe jo-materiale të autorit të veprës penale bëhet me vendim të gjykatës (Neni 98/1 KP). Konfiskimi i bazuar në vlerë rregullohet me anë të Nenit 98/1 të KP. Konfiskimi është i mundshëm edhe në rastet kur ka pengesa faktike dhe ligjore për kryerjen e procedimit penal kundër autorit të një vepre penale (Neni 97/3 KP). Në këto raste, me kërkesë të prokurorit, gjykata mund të nisë procedurë të veçantë për konfiskim, me qëllim që të shqyrtojë provat dhe të vendosë nëse këto objekte janë përdorur për kryerjen e një vepre penale apo nëse janë produkt i saj, si dhe nëse pasuritë apo përfitimet e tjera kanë ardhur si rezultat i kryerjes së një vepre penale (Neni 541 KPP).

KP siguron bazën ligjore për ndarjen e pasurive në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara. (Neni 97/4 KP).

Produktet e krimit mund t'i sekuestrohen edhe një personi të tretë, tek i cili janë transferuar pa kompensim të arsyeshëm. (neni 98/2 KP), dhe një personi juridik (Nenet 100, 96e dhe 28a KP).

Pretendimet e viktimave për kompensim të dëmeve në procedurën penale dhe në lidhje me konfiskimin e pasurive, parashikohen në nenet 99 KP dhe 533/3 KPP.

Baza ligjore për hetimin financiar si dhe për masat e përkohshme mbi objektet, mjetet dhe produktet që parashikohen të konfiskohen janë të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale (KPP), Nenet 219-227 dhe 532-543.

Konfiskimi i produkteve të krimit bëhet me vendim të gjykatës, i cili e shpall të akuzuarin fajtor (Neni 537).

Procedura që ndiqet për të vendosur masën e konfiskimit (dhënia e provave dhe deklarata) parashikohet në Nenin 534, ndërsa procedura për përcaktimin e vlerës së saktë të produkteve që do të konfiskohen përshkruhet në Nenin 535 (deklarata nga organe shtetërore, ekspertiza).

Konfiskimi ekzekutohet brenda 30 ditësh pas hyrjes në fuqi të vendimit (Neni 542). Në ligj gjithashtu parashikohet anulimi i të gjitha akteve të përfunduara pas kryerjes së veprës penale, me qëllim zvogëlimin e vlerës së pasurisë që është objekt konfiskimi. (Neni 542/5).

¹⁴ Kodi Penal (FZ 37/1996, FZ 19/2004).

Kodi i Procedurës Penale (FZ 17/1997, 44/2002, 74/2004), tekst i rishikuar (FZ 15/2005).

Ligji mbi Zyrën e Prokurorit të Shtetit (FZ 38/2004).

Ligji mbi Punët e Brendshme (FZ 19/1995, 55/1997, 38/2002 and 33/2003).

Ligji mbi Policinë Financiare (FZ 55/ 2002).

Kodi Doganor (FZ 21/1998, 86/1999, 25/2000, 31/2001, 4/2002, 55/2002 and 42/2003).

Ligji mbi përcaktimin dhe pagesën e të ardhurave publike (FZ 13/2001, 61/2002, 24/2003, 77/2003 and 19/2004).

Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe të të Ardhurave të Tjera që rrjedhin nga vepra të dënueshme (FZ 46/2004).

Ligji anti-korrupsion (FZ 49/2002, 46/2004).

Konfiskimi i objekteve (përfshirë produktet) është i mundshëm edhe në rastet kur procesi nuk përfundon me një vendim fajësie për të akuzuarin, në së kjo është në interes të sigurisë publike apo për arsye etike. Merret një vendim i veçantë nga organi i cili kryen procedurën, në momentin kur kjo e fundit përfundon, pra ndërpritet. (Neni 532).

Masat e përkohshme

Masat e përkohshme parashikohen në dy pjesë të KPP: Nenet 220 e në vazhdim kanë si objekt të tyrin sekuestrimin e përkohshëm të objekteve, të dhënave, mjeteve dhe produkteve të krimit (Neni 220/2) gjatë hetimit (formal) gjyqësor; nenet 532 e në vazhdim lidhen me masat e përkohshme të sigurimit të pronës e cila mundet që të konfiskohet në cilësinë e produktit të krimit gjatë fazës së gjykimit.

Masat e përkohshme të sigurimit mbi objektet apo pronat përkufizohen si ngrirje e përkohshme, konfiskim, ngrirje e fondeve, e llogarive dhe transaksioneve financiare, apo përfitimeve të nxjerra nga një vepër penale (Neni 220/1) dhe në rastin e produkteve të krimit si ngrirje e mjeteve, llogarive bankare dhe fondeve (neni 220/2).

Gjatë fazës së hetimit, masa e përkohshme e sigurimit mund të urdhërohet nga një gjyqtar apo këshill hetues. Masa është e vlefshme deri në përfundim të procedurës (Neni 220/3). Në rastet e ngrirjes së një llogarie bankare masa duhet të rimerret në shqyrtim një herë në dy muaj. (Neni 220/4).

KPP përcakton rregullat për apelimin (Neni 223/2), kthimin e objekteve (Neni 227) dhe administrimin e tyre (nenet 220/5-7). Administrimi i produkteve ndaj të cilave është marrë masa e konfiskimit të përkohshëm është përgjegjësi e gjykatës.

Rregullat e përgjithshme të administrimit (hipotekat e pasurive të paluajtshme, depozitimi i parave në llogari të posaçme bankare, mundësia e shitjes së objekteve të sekuestruara) nuk mjaftojnë për të siguruar një administrim të mirë dhe ruajtjen e vlerës së tyre. Mungesa e një shërbimi të specializuar (agjensie) dhe e rregullave të veçanta për administrimin e pronave të sekuestruara dhe konfiskuara në praktikë krijon shumë probleme, duke shkaktuar kështu rënien e vlerës së produkteve të sekuestruara.

Neni 536 parashikon që gjykata *ex officio* urdhëron marrjen e masave të përkohshme të sigurimit, për të garantuar konfiskimin e mëvonshëm të pasurive apo përfitimeve.

Masat e përkohshme nuk mund të merren gjatë fazës së hetimit policor, por vetëm pasi të ketë filluar zyrtarisht hetimi gjyqësor. Ky rregullim ligjor mund të shkaktojë ulje të efektshmërisë së masave në praktikë, sidomos në rastet e hetimeve të krimeve të rënda.

Hetimi financiar

Nuk përcaktohet në mënyrë të posaçme nga KPP. Baza ligjore mund të gjendet në Nenin 533/2 i cili parashikon gjatë procedimit penal detyrimin për të përcaktuar vlerën e pasurisë së fituar nga kryerja e një vepre penale.

Gjykata dhe organet e tjera që kryejnë ndjekjen penale janë të detyruar të mbledhin të dhëna dhe të bëjnë vlerësimin e rrethanave, që janë të rëndësishme në përcaktimin e pasurive të krimit. (Neni 533/2).

Faza para-hetimore (faza e hetimit policor) nuk mbulohet nga ligji. Për aksesin ndaj të dhënave financiare gjatë hetimit financiar (pronësia mbi pasuritë, deklaratat tatimore, etj , si bazë ligjore merren Kompetencat e Përgjithshme të Policisë(Neni 144). Bazat e të dhënave, regjistrat e tokave, regjistrat e personave juridikë janë të vjetëruar dhe përbëjnë pengesë në kryerjen e hetimeve financiare eficiente.

Nuk ka dispozitë të veçantë për aksesin ndaj të dhënave bankare. Në disa raste përdoret Neni 144 KPP, por për këtë nevojitet një vendim gjykate. Aksesin ndaj të dhënave bankare, sidomos të llogarive në banka të huaja nxitet nëpërmjet Drejtorisë për Parandalimin e Pastrimit të Parave, pranë Minsitrisë së Financave. Kjo ndodh edhe në rastet kur nuk ka dyshime për veprën penale të pastrimit të parave!

Në legjislacionin maqedonas mungon një dispozitë e qartë, e cila të shërbejë si bazë ligjore për hetimin financiar, ku të përfshihet procedurën në fazën para-hetimore, si dhe baza ligjore për të siguruar aksesin ndaj të dhënave bankare.

Amendimet në Kodin e Procedurës Penale në vitin 2004 kanë mundësuar zbatimin e masave të posaçme hetimore, (Neni 146), por përdorimi në praktikë i tyre vazhdon të jetë i kufizuar.

2.4.2 Konfiskimi i shtrirë

Konfiskimi i shtrirë nuk rregullohet nga legjislacioni penal. Qeveria planifikon ta përfshijë konfiskimin e shtrirë në amendimet e ardhshme ligjore.

Vendosja e një takse të lartë (deri në 75%) mbi të ardhurat apo pasuritë e padeklaruara që zbulohen, mbulon produktet e krimit nga ana e procedurës administrative, ku barra e provës për të vërtetuar prejardhjen e të ardhurave i mbetet personit të inspektuar. Të njëjtat rregulla mund të përdoren edhe për produktet e krimit, në rastet kur procedimi penal është i pamundur. Rregullat vlejné për zyrtarët publikë, sipas Ligjit Anti-korrupsion (Nenet 33, 34, 35 dhe 36). Zbatimi në praktikë i kësaj mundësie është shumë i kufizuar.

Një veçanti e legjislacionit maqedonas është fakti se ai mbulon detyrimin për të vërtetuar prejardhjen e pasurisë e cila nuk është në përputhje me mundësitë ekonomike (Neni 359-a)¹⁵. Qëllimi i dispozitës është gjetja e produkteve të krimit dhe lidhet me masat për parandalimin e korrupsionit të zyrtarëve publikë (Nenet 33,34 dhe 37 të Ligjit mbi Parandalimin e Korrupsionit).

Zyrtari publik konsumon vepër penale në se:

- Ai /ajo në deklarin e pasurisë jep të dhëna të rreme
- Pasuria e tij/ e saj tejkalon dukshëm të ardhurat e ligjshme dhe të deklaruara dhe ai/ajo fsheh burimin e vërtetë të tyre

Dënimi i parashikuar është gjobë dhe burgim nga 6 muaj deri në 5 vjet. Përveç kësaj, bëhet konfiskimi i pasurisë së padekluar (përfshirë edhe konfiskimin e bazuar në vlerë).

Dispozita e detyron zyrtarin publik që të shpjegojë mospërputhjen mes të ardhurave faktike dhe atyre të deklaruara dhe të zbulojë burimin e vërtetë të pasurisë (duke e kërcënuar me ndëshkim). Nga ky këndvështrim, vihet në dyshim përputhshmëria e saj me standardet e të drejtave të njeriut (e drejta për të mos u vetë-akuzuar). Bazuar nga të dhënat që kemi marrë, kjo dispozitë nuk është zbatuar ende në praktikë.

Zbatimi i regjimit të konfiskimit (pa konfiskimin e shtrirë) do të jetë veçanërisht i vështirë, pasi rreth 50% e pagesave në Maqedoni janë transaksione me para në dorë.

¹⁵ Neni 359-a i KP CC (Fshehja e origjinës së pasurisë së pajustificuar)

(1) Zyrtari publik apo personi drejtues në një institucion apo organizatë publike, i cili në kundërshtim me detyrimin ligjor të deklarimit të situatës materiale, jep të dhëna të rreme mbi të ardhurat e tij/të saj, ose pasuria e të cilit në mënyrë të dukshme i tejkalon të ardhurat e taksueshme dhe fsheh burimin e tyre dënohet me 6 muaj deri 5 vjet nurg dhe gjobë.

(2) Pasuria e cila dukshëm tejkalon të ardhurat që fitohen dhe deklarohen pranë organeve tatimore, dhe burimi i së cilës fshihet nga autori i veprës penale i nënshtrohet konfiskimit; kur konfiskim nuk është i mundshëm atëherë kryhet konfiskimi i një pasurie tjetër me të njëjtën vlerë. Pasuria i nënshtrohet konfiskimit edhe në se i ka kaluar personave të tretë pa kompensim të arsyeshëm.

2.4.3 Përgatitja e legjislacionit

Në qershor 2007, Ministria e Drejtësisë përgatiti projekt-ligjin për Administrimin e Objekteve dhe Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, i cili u diskutua në seminarin e organizuar nga CARPO.

Ndryshimet në KPP në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve janë në procedurë parlamentare (qershor 2007). Këto do të pasohen në fund të vitit 2007 me pjesën e dytë të ndryshimeve konceptuale të KPP, që lidhen me heqjen e hetimit gjyqësor (dhe ndoshta masa për konfiskimin e shtrirë).

Një vendim i qeverisë (në zbatim të strategjisë për ndryshime në legjislacionin penal) bën të mundur konfiskimin nëpërmjet procedurës civile, por interpretohet nga Ministria e Drejtësisë si kërkesë për të realizuar konfiskimin e shtrirë me instrumenta të procedurës civile. Për sa kohë ndryshimet në KPP bëhen me një shumicë votash prej 2/3 në parlament, Ministria e Drejtësisë ka vendosur t'i përfshijë ndryshimet ligjore mbi konfiskimin e shtrirë në një ligj të veçantë. (në projekt-ligjin mbi Administrimin e Pasurive të Konfiskuara ose në atë mbi Agjensinë për Luftën kundër Krimit të Organizuar. Disa dispozita që kanë të bëjnë me konfiskimin e shtrirë u sugjerua të përfshiheshin në KP dhe në atë të PP, pasi në të dyja këto ligje trajtohen çështjet e mësipërme. Ndërkohë është në përgatitje e sipër një projekt-ligj mbi Policinë Financiare, i cili po bëhet me ndihmën e ekspertëve të *Guardia di Finanza* italiane.

Rekomandime nga seminari i CARPO për ndryshime në legjislacion me qëllim përfshirjen e konfiskimit të shtrirë

Amendime të KP

- 98 ose 97 – konfiskimi i shtrirë,
- 98/4: lidhja me agjensinë- përdorimi i pasurisë së konfiskuar (buxheti),
- 359a KP – Fshehja e prejardhjes së pasurisë së pajustificuar nga ana e zyrtarëve publikë (respektimi i standardeve të të drejtave të njeriut?)

Amendime në KPP

- 533: HF dhe masat e përkohshme duhet të mund të përdoren edhe gjatë procedurës para-hetimore,
- përfshirja e një dispozite për aksesin ndaj të dhënave bankare
- 223 dhe 536 (procedura e apelit gjatë fazës së masave të përkohshme për të vërtetuar prejardhjen e ligjshme të pasurive) (edhe gjatë procesit gjyqësor),
- dispozita që lidhen me administrimin e pasurive të sekuestruara sipas projekt-ligjit mbi Administrimin: 219/6, 220 (shtohet ndalimi i disponimit të lirë), 227, 542 (ekzekutimi i konfiskimit).

2.4.4 Institucionet

Policia

Departamenti për Krimin e Organizuar (Sektori i Krimit Financiar) është krijuar në vitin 2005 brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nuk është pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë.

Në vitin 2002, në varësi të Ministrisë së Financave është ngritur Policia Financiare. Kjo strukturë ka kaluar disa riorganizime dhe ndryshime të personelit, dhe është ende në procesin e konfigurimit të plotë të vetvetes, me qëllim përmbushjen e detyrave të parashikuara. Ndërkohë po përgatiten ndryshime edhe në Ligjin mbi Policinë Financiare.

Roli i Policisë Financiare dhe Administratës Tatimore në procedimin penal parashikohet nga Neni 145 i KPP. Policia Financiare është përgjegjëse për zbulimin dhe hetimin e shmangies së taksave, pastrimit të parave dhe produkteve të tjera që rrjedhin nga një akt i dënueshëm, kontrabantës, tregtisë së paligjshme dhe krimeve të tjera që përfshijnë shuma të mëdha detyrimesh tatimore, doganore apo përfitime të tjera.

Ka mbivendosje mes kompetencave të Policisë Financiare dhe Sektorit të Hetimit Financiar, pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Krimin e Organizuar, që kryesisht lidhen me hetimin financiar, gjë që krijon sfida të reja për një bashkëpunim sa më të mirë mes institucioneve.

Ligji mbi Policinë Financiare përfshin edhe metodat për kryerjen e vlerësimit të të ardhurave, si psh: metoda e vlerës neto, metoda e shpenzimeve, metoda e depozitave bankare, metoda e marzheve të përqindjeve, dhe metoda e përqindjeve të veçanta.

Departamenti i të Ardhurave Publike brenda Minsitrisë së Financave siguron të dhëna mbi deklaratimet e të ardhurave, të cilat përbëjnë një burim të rëndësishëm informacioni për hetimin financiar. Krahas hetimit financiar ato mund të luajnë një rol të rëndësishëm për shkak të mundësisë që krijojnë për vendosje të taksave të larta mbi pasuritë/të ardhurat e padeklaruara, në rastet kur konfiskimi i produkteve të krimit nuk është i mundshëm në kuadrin e procedimit penal.

Shërbimi i prokurorisë

Në sistemet ku ekziston hetimi gjyqësor, prokurori drejton hetimin policor (paraprak) Masat hetimore gjatë fazës të hetimit paraprak bëhen me urdhër të gjykatësit hetues, me kërkesë të prokurorisë ose policisë.

Në vitin 2004, pranë Zyrës së Prokurorit të Shtetit u ngrit departamenti për ndjekjen e autorëve të veprave në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Detyra e tij është të nisë procedimin penal për krime që janë *ex officio* të procedueshme, dhe që janë kryer nga një grup i organizuar me të paktën tre persona, që veprojnë së bashku për një kohë të caktuar, me qëllim sigurimin e përfitimeve financiare të drejtpërdrejta apo të tërthorta, ose çdo lloj tjetër përfitimi material, që kryejnë një a më shumë vepra penale, për të cilat ligji parashikon dënim me burgim të paktën 4 vjet. (Neni 29 i Ligjit mbi Zyrën e Prokurorit të Shtetit).

2.4.5 Përfundime

Duhet dhënë mbështetje e mëtejshme në mënyrë që institucionet e përfshira të zbatojnë legjislacionin ekzistues mbi hetimin financiar, masat e përkohshme të sigurimit dhe konfiskimin e produkteve të krimit. Policia Financiare nuk është ende plotësisht operacionale. Mbivendosja e kompetencave me sektorin e krimit financiar nuk e ndihmon bashkëpunimin jo-shumë të mirë mes institucioneve. Prokuroria dhe policia nuk ruajnë statistika apo të dhëna për hetimet financiare dhe konfiskimet e përkohshme. Administrimi i objekteve dhe pasurive përbën një problem të madh praktik. Ministria e Financave ka përgatitur një projektligj Për Administrimin e Objekteve dhe Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, i cili parashikon ngritjen pranë Ministrisë së Drejtësisë së një agjencie të specializuar për administrimin e tyre..

Hetimi financiar nuk është përkufizuar në mënyrë të qartë në KPP dhe nuk ka asnjë dispozitë për aksesin ndaj të dhënave bankare. Në raste të rralla, kur kryhet hetimi financiar, përdoren dispozitat që kanë të bëjnë me kompetencat e përgjithshme të policisë. Monitorimi i llogarive bankare nuk rregullohet nga KPP. Disa regjistra janë të vjetëruar: (regjistri i tokave, i personave juridikë, etj) dhe duke i shtuar kësaj faktin se 50% e ekonomisë bazohet kesh, atëherë pengesat reale për arritjen e rezultateve janë të mëdha. Në disa raste përdoret FIU (Drejtoria për Parandalimin e Pastrimit të Parave) për të marrë të dhëna bankare, edhe kur nuk ka dyshime për

veprën penale të pastrimit të parave. Ka vetëm mundësi të kufizuara ligjore për të përdorur MPH. Aplikimi i tyre në praktikë është ende shumë i kufizuar.

Masat e përkohshme mund të merren vetëm pas fillimit të hetimit gjyqësor; hetimi paraprak (policor) nuk mbulohet me ligj, gjë që përbën një pengesë reale për efektshmërinë e masave të marra.

Konfiskimi i produkteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, si dhe konfiskimi i bazuar në vlerë rregullohen me ligj. Është i mundshëm konfiskimi nga persona të tjerë dhe nga persona juridikë, si dhe në rastet kur procedimit penal pushohet.

Konfiskimi i shtrirë nuk rregullohet nga legjislacioni penal. Qeveria është angazhuar për të ndryshuar legjislacionin me qëllim sigurimin e bazës ligjore për shtrirjen e konfiskimit.

Vepra penale e "fshehjes së prejardhjes së pasurisë së pajustificuar" (Neni 359a KP) është veçanti e legjislacionit maqedonas. Përputhshmëria e saj me standardet e të drejtave të njeriut (të drejtën për të mos u vetë-akuzuar) është e dyshimtë, por bazuar në të dhënat e deritanishme, kjo dispozitë nuk është përdorur ende në praktikë. Mundësia e vendosjes së taksave të larta, deri në 75% mbi të ardhurat dhe pasuritë e padeklaruara të zyrtarëve publikë bën të mundur arritjen e qëllimit për luftën kundër korrupsionit.

2.4.6 Vështrim i përgjithshëm

CP		"Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë"
Konfiskimi	97	97/1 Askush nuk mund të mbajë përfitimet e pasurisë, të drejtpërdrejta apo të tërthorta, që rrjedhin nga një vepër penale (...)
Produkte të Drejtpërdrejta / të tërthorta	97/1	Neni 98: Mënyra e konfiskimit (1) Përfitimi material i krijuar nëpërmjet një veprimtarie kriminale, përfshi vlerat monetare, prona të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe objekte të tjera, pasuri apo aksione, të drejta materiale dhe jo-materiale i nënshtrohet konfiskimit. Në se konfiskimi i tyre nuk është i mundshëm, atëherë objekt konfiskimi do të bëhen objekte të tjera në pronësi të autorit të krimit, që korrespondojnë në vlerë me pasurinë e fituar nga vepra penale. (...)
Konfiskimi i bazuar në vlerë	98/1	
Personat e tretë	98/2 + 537/3 CPC	98/2: ...nga palë të treta, tek të cilat kjo pronë është transferuar pa kompensim të mjaftueshëm, kur ata kishin dijeni ose duhet të kishin dijeni se kjo pasuri ishte produkt i një aktiviteti kriminal.
Persona Juridike	100 28a, 96e +537/3 CPC	100: Në se një person juridik fiton pasuri nga kryerja e një vepre penale, atëherë kjo pasuri do të konfiskohet. 28a: Kushtet për përgjegjësinë penale të personit juridik 96e: Konfiskimi i pronës, përfitimeve materiale dhe konfiskimi i objekteve nga persona juridike
Konfiskimi i Shtrirë	Nr	Taksimi deri në 75% i të ardhurave/pasurive të padeklaruara të personave publike Neni 359a: Fshehja e origjinës së pasurisë së pajustificuar
KPP		
Hetimi financiar	533/2	Neni 533 (1) Pasuritë dhe përfitimet e tjera të nxjerra nga kryerja e një vepre penale përkufizohen në kodin e procedurës penale <i>ex officio</i> . (2) Gjykata dhe organe të tjera që kryejnë procedimin penal janë të detyruar të mbledhin të dhëna dhe të shqyrtojnë rrethanat përkatëse për të përcaktuar pasurinë apo pasuritë.... ..
MPH	146	
Faza para gjykimit	Nr	533/1
Akresi ndaj të dhënave bankare	Nr	Nuk ka dispozitë të veçantë – kompetencat e përgjithshme të policisë (Neni 144)
Konfiskimi i përkohshëm	220/2 - 223 536	Neni 220 (1) Gjyqtari hetues apo këshilli mund të vendosin marrjen e masave të përkohshme të sigurimit mbi objektet dhe mjetet që kanë lidhje me një vepër penale (...) Sigurimi i përkohshëm i objekteve dhe pronave do të kuptohet si ngrirje e përkohshme, konfiskim, mbajtje e fondeve, llogarive bankare, transaksioneve bankare apo fitimeve të marra nga kryerja e një vepre penale. (2) (...) gjykata mund të vendosë ngrirjen e mjeteve, llogarive dhe fondeve për të cilat ekzistojnë shkaqe të bazuara për të besuar se kanë ardhur si rezultat i një vepre penale (...) Neni 536 (1) Në rastet kur përmbushen kushtet për konfiskimin e pasurive dhe përfitimeve të tjera, gjykata <i>ex officio</i> urdhëron marrjen e masave të përkohshme të sigurisë, të parashikuara në Nenin 219 të këtij ligji. (...)
Para procesit	Nr	Shih 223/1; vetëm pasi të ketë nisur hetimi (gjyqësor)
Ngrirja e	220/2,	

Ilogarive bankare	4,7,8	
Procedura e Apelit	223 536/3, 4 227+532	Neni 223 (1) Masat për sigurimin e përkohshëm me qëllim konfiskimin e objekteve dhe pasurive, merren me vendim të gjykatës, gjyqtarit hetues gjatë hetimit dhe pas nisjes së procedimit penal, si dhe të këshillit (...) Neni 227 (1) Objektet të cilat gjatë hetimit janë konfiskuar përkohësisht do t'i kthehen pronarit në rast pushimi të procedimit, dhe kur nuk ka arsye të tjera për konfiskim (neni 532). (...)
Administrimi	220	
Konfiskimi	532-543 537 532	Neni 537 (1) Gjykata mund të shprehet për konfiskimin e përfitimeve/pasurisë nëpërmjet vendimit në të cilin i akuzuari shpallet fajtor, i jepet një masë edukuese, etj. (...) Neni 532 (1) Objektet të cilat sipas KP lejohet të konfiskohen, mund të përfshihen në skemë edhe kur i akuzuari nuk dënohet, por ky konfiskim është në interes të sigurisë publike dhe etikës. (...)
Procedura	534 541 + 97/3 CC	Neni 534 (1) ... personi tek i cili është transferuar prona si dhe përfaqësuesi i personit juridik do të thirren për t'u dëgjuar në seancën paraprake dhe gjatë gjykimit (...) Neni 541 (1) Në rastet kur ka pengesa faktike dhe ligjore për kryerjen e procedimit penal kundrejt një personi të caktuar, gjykata mund të vendosë për konfiskimin e pronës dhe pasurive të tjera, si dhe sekuestrimin e objekteve, me propozim të Prokurorit.... (2) ...gjykata do të shqyrtojë provat për të përcaktuar nëse kemi të bëjmë me një përfitim të nxjerrë nga kryerja e një vepre penale, apo me një objekt të përdorur apo të prodhuar nëpërmjet kryerjes së një vepre penale, dhe që duhet konfiskuar. (...)
Përcaktimi i vlerës	Nr 535	535/1: Nëse gjykata nëpërmjet provave nuk mund të përcaktojë vlerën e pasurisë së përfituar që duhet konfiskuar, atëherë ajo kërkon ekspertizë (...)
Ekzekutimi	542	542/1 duhet të kryhet 30 ditë pasi vendimi ka hyrë në fuqi. (...)
Legjislacioni i veçantë	Jo	
Links		www.pravo.org.mk
Institucione (të specializuara)		
Ministria e Brendshme	144 CPC 157+219	Policia kriminale MB, Drejtoria e Krimit të Organizuar (DKO) – Sektori i Krimit Financiar (FCS)
Administrata doganore	145/1 CPC	
Policia financiare	145/2 CPC	
Prokuroria		Seksioni për zbulimin e autorëve të veprave penale në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit
Gjykata		

2.5 Kosova – Profil i zonës së projektit

2.5.1 Legjislacioni aktual¹⁶

Konflikti në Kosovë solli shumë sfida ekonomike: varesia ekonomike tek të ardhurat nga Diaspora, privatizimi, vendosja e ekonomisë së tregut dhe e sektorit privat, investimet në rritje në infrastrukturë, strehimi, si dhe ndërtimi i institucioneve, transferimi i kompetencave nga UNMIK-u tel autoritetet lokale, etj. – të gjitha këto përbëjnë një sfidë për luftën kundër krimit ekonomik e të organizuar dhe kundër korrupsionit. Organizatat e sistemet shtetërore janë ende në zhvillim e sipër. Ndërkohë vazhdon transferimi i kompetencave dhe përgjegjësi nga Forca Policore e UNMIK-ut¹⁷ tek Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK). Gjykatësit e prokurorët ndërkombëtarë po punojnë sëbashku me personat lokalë.

Konfiskimi i të ardhurave/produkteve të krimi rregullohet nga Kodi Penal i Përkohshëm/provizor (në vijim KP) në Nenet 82-85, dhe nga Kodi i Procedurës Penale i Përkohshëm (në vijim KPP) në Nenet 490-500, ndërsa konfiskimi i objekteve në Nenet 60 i KP-s dhe 247-252 i KPP-s. Ligji për Ndalimin e Pastrimit të Parave përmban dispozita në lidhje me sigurimin dhe konfiskimin/provizor të produkteve të krimit në seksionet 11 dhe 12, të cilat mund të jene të zbatueshme jo vetëm në rastet e pastrimit të parave.

Konfiskimi

Përfitimet materiale (para, objekte me vlerë apo përfitime të tjera materiale) të siguruar përmes kryerjes së një veprë penale duhen konfiskuar në bazë të gjykimit që përcakton kryerjen e veprës penale (Neni 82 I KP-s). Konfiskimi në bazë të vlerës (Value-based confiscation) rregullohet nga Neni 83/1 I KPP-s¹⁸.

Konfiskimi i përfitime materiale mund të bëhet edhe ndaj një personi të tretë tek i cili është bërë transferimi i përfitimit pa kompensim/pagesë, ose me një kompensim që nuk i korespondon vlerës reale, në rast se personi në fjalë e dinte ose mund të ketë patur dijeni që përfitimi material që siguruar përmes kryerjes së një veprë penale. Në rastin kur përfitimi material i është transferuar personave të afërt, ai mund të konfiskohet, përveç se në rastin kur ata mund të provojnë se kanë bërë pagesë/kompensim për vlerën e tij të plotë. (Neni 83/2 i KP-s). Produktet e krimit (përfitime materiale) mund të konfiskohen edhe prej një personi juridik (Neni 85 i KP-s). Në bazë të Nenit 491 të KPP-s, gjykata thërret personin e tretë ose përfaqësuesin e personit juridik për ta pyetur dhe gjatë seancave gjyqësore ata mund të paraqesin prova apo t'i bëjnë pyetje të akuzuarit, dëshimtarëve apo ekspertëve në cilësinë e dëshmitarit.

¹⁶ Kodi Penal i Përkohshëm i Kosovës (UNMIK/reg/2003/25, 2004/19).

Kodi i Procedurës Penale i Përkohshëm i Kosovës (UNMIK/reg/2003/26).

Kodi i Doganave Customs Code (Rregullore e UNMIK-ut 2004/1 Për Kodin e Doganave të Kosovës)

Ligji për parandalimin pastrimit të parave dhe shkelejeve të tjera penale në lidhje me këtë (Rregullore e UNMIK-ut 2004/2, 2005/42, 2006/9, 2006/49: zgjatje e papërcaktuar, 2006/53).

Ligji mbi administratën dhe procedurat tatimore (2004/48).

Faqe interneti: www.ks-gov.net, www.kosovopolice.com, www.unmikonline.org/, www.ks-gov.net/GazetaZyrtare/, www.unmikonline.com, www.kuvendikosoves.org, www.euinkosovo.org.

¹⁷ UNMIK-u është prezencë civile ndërkombëtare e vendosur në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999), që përfshin Shtyllën e Policisë dhe Drejtësisë, Shtyllën e Administratës Civile Interim (Kombet e Bashkuara), Shtyllën e Ndërtimit të Institucioneve (OSBE), dhe Shtyllën e Zhvillimit dhe Rindërtimit Ekonomik (BE).

¹⁸ Autori i veprës penale do të jetë i detyruar të paguajë një sasi parash që i korespondon përfitimit material të siguruar. Gjykata mund të lejojë që pagesa të bëhet në këste për një periudhë kohe që jo më të gjatë se dy vjet. Konfiskimi i materialeve të përfituara

Konfiskimi (sekuestrimi) i objekteve të përdorura apo të destinuara për përdorim në kryerjen e një shkelje penale, apo objektet që rrjedhin nga kryerja e një shkelje penale, rregullohet nga Neni 60 i KP-s. Këto objekte mund të konfiskohen në rast se janë pronë e autorit të krimit apo, nëse një gjë e tillë është në interes të sigurisë së përgjithshme.

Sipas Nenit 489 të KPP-s, këto objekte do të konfiskohen edhe kur i akuzuari nuk është shpallur fajtor në një proces gjyqësor të veçantë, nëqoftëse ekziston rreziku që objektet të mund të përdoren për një shkelje penale, ose në rast se është në interes të sigurisë publike apo konsideratash morale.

Në përputhje me Nenin 494 të KPP-s, konfiskimi i produkteve të krimit mund të urdhërohet në një gjykim ku i akuzuari është shpallur fajtor, apo ku është urdhëruar paralajmërim gjyqësor, si dhe në një vendim për marrje masash për trajtim rehabilitues të detyrueshëm të keqbërësve me varësi ndaj alkolit apo drogave. Gjykata duhet të specifikojë objektin apo shumën e parave që duhet konfiskuar (pagesa mund të bëhet me këste). Gjykata mund të përcaktojë vleftën e saktë të përfitimit material përmes një vlerësimi falas (Neni 492 i KPP-s).

Konfiskimi i objekteve që rrjedhin nga një shkelje penale¹⁹ e specifikuar (shpërblime, dhurata apo përfitime të dhëna apo të pranuara në mënyrë të paligjshme) në kushte të caktuara²⁰, mund të bëhet përmes një vendimi të veçantë të gjykatës edhe pa dënimin (gjykimin) e të akuzuarit (Neni 498 i KPP-s).

Konfiskimi i produkteve të tërthorta të krimit nuk është rregulluar në mënyrë specifike, por kjo mund të bëhet nëpërmjet interpretimit të Nenit 83/1 i KP-s (ose çdo përfitim tjetër material).

Hetimi financiar

Gjykata dhe agjensitë e tjera që ndërmarrin procedurat hetuese, duhet të mbledhin prova *ex officio* dhe të hetojnë mbi rrethanat, me qëllim që të përcaktojnë përfitimin material të siguruar përmes kryerjes së shkeljes penale (Neni 490 i KPP-s). Në bazë të Nenit 499/3, këto detyrime janë të zbatueshme edhe në procedurat para-gjyqësore.

Akresi në të dhënat bankare konsiderohet si masë hetimore speciale (MHS) dhe rregullohet nga Nenet 256/1 xiii, 256/11 dhe 257/1, 2, duke respektuar kushtet për përdorimin e masave hetimore speciale (MHS). Me propozim të një prokurori, gjykatësi para-gjyqësor lëshon një urdhër për bankën apo institucione të tjera financiare për zbulimin e të dhënave financiare të të dyshuarit (Neni 257/1) apo të personave të tjerë (Neni 257/2), kur ka dyshimë të bazuara se personi në fjalë ka kryer shkelje penale ose se personi merr pjesë në transaksionet financiare të të dyshuarit. Disa prokurorë ishin të mendimit se standarti i kërkuar për dyshim të bazuar është shumë kufizues. Nuk ka rregullim ligjor për monitorimin e llogarive bankare.

Masat hetimore speciale (MHS) rregullohen nga Nenet 256-267, por në praktikë përdorimi i tyre është i kufizuar.

Masat e përkohshme të sigurisë (sekuestrimit)

Në bazë të Nenit 493 të KPP-s, gjykata (gjykatësi hetues ose kryetari i seances²¹) mund të urdhërojnë *ex officio*, ose me propozim të prokurorit, sekuestrimin e pasurisë që mund të

¹⁹ Marrja e mallrave të vjedhura, Dhënia dhe pranimi i pajustifikuar i dhuratave, Pranimi i rrushfetit, Dhënia e rryshfetit dhe shitblerja e influencave (Nenet 272, 250, 251, 343, 344 and 345 CC).

²⁰ Nëse janë përcaktuar elementet e një shkelje penale dhe është përcaktuar, gjithashtu, që objekte të caktuara rrjedhin nga shkelja penale ose që është dhënë apo pranuar një shpërblim, dhuratë apo përfitim.

²¹ Neni 116 i KPP-s.

konfiskohet, ose masa të tjera sigurie në përputhje me dispozitat e procedurave të ekzekutimit (prohibition of disposal...).

Ngrirja e transaksioneve financiare nuk rregullohet nga ligji në mënyrë specifike; si rezultat përdoren dispozita të përgjithshme për masat e përkohshme të sigurisë (Nenet 493, 116, 490 dhe 499 të KPP-s). Në bazë të Neneve të sipërpërmendur, gjykatësi para-gjyqësor lëshon një urdhër ngrirje me propozim të prokurorit publik.

Administrimi

Gjykata është përgjegjëse për administrimin e objekteve dhe produkteve të tjera të krimit, të sekuestruara apo për ndryshe të siguruara. Gjykata duhet të procedojë me shpejtësi dhe të operojë në mënyrë ekonomike, me racionalitet dhe si një menaxhere e mirë (Neni 497/1). Procedura e administrimit, e cila parashikohet nga Neni 497/2, nuk është aprovuar ende. Zyrtarët Kosovarë janë të mendimit që dispozitat e përgjithëshme për administrim janë të pamjaftueshme. Problemet që dalin me objektet e magazinuara jo mirë e që u bie vlera kanë nevojë për legjislacionin e duhur.

Objektet që duhen konfiskuar në bazë të KP-s (Neni 60), ose që mund të përbëjnë prova apo të jenë produkte të krimit, mund të sekuestrohen (përkohësisht) nga policia. Këto objekte vihen nën ruajtjen dhe kontrollin e prokurorit publik (Neni 247 i KPP-s). Shitja e objekteve të sekuestruara (Neni 60 i KP-s dhe 247 i KPP-s) parashikohet vetëm për objektet e gjetura tek i akuzuari, që i përkasin një personi të panjohur, në rast se objekti nuk është i ruajtshëm apo në rast se shpenzimet për administrimin e tij janë të konsiderueshme. Procedurat e shitjes duhet t'i përcillen bankës për ruajtje (Neni 252 i KPP-s).

Legjislacioni special

Ligji për Ndalimin e Pastrimit të Parave dhe Shkeljeve Penale të lidhura me të parashikon konfiskimin dhe masat e përkohëshme të sigurisë, të cilat nuk kanë të bëjnë vetëm me rastet e pastrimit të parave, por janë të zbatueshme edhe për produktet e krimit. Lidhja midis KPP-s dhe këtij ligji nuk duket të jetë shumë e qartë për zyrtarët kosovarë, dhe në praktikë nuk përdoret për sigurimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit që kanë të bëjnë me çështje të pastrimit të parave.

Dispozitat e seksioneve 11 dhe 12 janë më të detajuara si dispozita relevante të KPP-s dhe sigurojnë një mundësi më të madhe për një parandalim të efektshëm të përfitimeve pasurore.

Sipas seksionit 10.3, standarti i provës se prona është një produkt krimi, është i lehtësuar. Përfaqësimet (sipas investigimesh secrete) mund të mbështesin vetëm në mënyrë të tërthortë mendimin se pasuria është produkt i krimit (seksioni 10.3). Nëse personi pretendon të ketë pronësinë e pronës, të njoftuar për konfiskim, personi duhet të japë të dhënat dhe rrethanat në të cilat është siguruar (në mënyrë të ligjshme) pronësia apo statusi i përfituesit në lidhje me pronën (seksioni 11.4c).

Dispozita e seksionit 11.1b mbështet interpretimin që ligji është i zbatueshëm jo vetëm në rastet e pastrimit të parave, por edhe në "të gjithë rrethanat e tjera", kur prokurori mund të paraqesë një kërkesë për konfiskimin e pasurisë që rezulton nga produkte të krimit, ose që është përdorur apo është synuar të përdoret për kryerjen apo lehtësimin e pastrimit të parave apo të shkeljes penale nga e cila ka rezultuar produkti i krimit. Konfiskimi në bazë të vleftës rregullohet në seksionin 11.8.

Prokurori mund të propozojë një masë e përkohshme për sigurimin e pasurisë edhe nëse nuk janë ndërmarrë procedura penale. Në raste të tilla, gjykatësi hetues i Gjykatës ku ndodhet pasuria, ka

juridiksionin të vendosë për marrjen e masës (seksioni 12.2). Kushtet për masat e e përkohshme dhe llojet e masave përcaktohen në seksionet 12.1 dhe 12.4²² (12.4b: ngrirja dhe transaksionet financiare).

Administrimi i pasurisë së siguruar rregullohet në seksionin 12.9. Gjykata mund të vendosë edhe ta shesë pasurinë nëse ekziston rreziku i prishjes, humbjes, apo zhvleftësimit, ose në rast se kostot e mirëmbajtjes janë të konsiderueshme, ose nëse pronari pranon ta shesë.

Situata e paqartë në lidhje me zbatimin e ligjit është ende e pasqaruar. Vlefshmëria e tij është shtyrë pa afat nga rregullorja 2006/49 e UNMIK-ut.

2.5.2 Konfiskimi i shtrirë

Në Kosovë nuk ka rregullim ligjor për konfiskimin e shtrirë. SHPK-ja i paraqiti Ministrisë së Drejtësisë një propozim për futjen e bazës ligjore përkatëse, bazuar në Strategjinë Rajonale mbi instrumentet për luftën e krimit të organizuar (2005)

Sipas Ligjit për Ndalimin e Pastrimit të Parave dhe Shkeljeve të tjera Penale në lidhje me të, standarti i provës që pasuria përbën produkt të krimit, është lehtësuar (seksioni 10/3). Përfaqësimet (sipas investigimesh secrete) mund të mbështesin vetëm në mënyrë të tërthortë mendimin se pasuria është produkt i krimit (seksioni 10.3). Nëse personi pretendon të ketë pronësinë e pronës të njoftuar për konfiskim, ai duhet të japë të dhënat dhe rrethanat në të cilat është siguruar (në mënyrë të ligjshme) pronësia apo statusi i përfituesit në lidhje me pronën (seksioni 11.4c).

2.5.3 Përgatitja e legjislacionit

Grupi i punës për ndryshimet në KPP dhe KP është ngritur nga Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut. Projekt-amandamentet nuk janë ende të gatshme.

2.5.4 Institucionet

Ministria e Drejtësisë u ngrit në vitin 2006. "Transferimi i mëvonshëm i kompetencave" Ministrisë së Punëve të Brendshme hyri në fuqi nga Rregullorja e UNMIK-ut No. 2006/26, dt. 27 Prill 2006 (dokumenti bashkangjitur XVI (ii)). Ka filluar gjithashtu edhe transferimi i kompetencave nga UNMIK-u tek Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK): "duke monitoruar shërbimin policor të Kosovës, siç është autorizuar nga SRSG, në veprim përmes komisionerit të policisë dhe pa ndërhyrje në veprimet e Shërbimit Policor të Kosovës dhe në implementimin e hetimeve penale".

Brenda Drejtorisë për Krimin e Organizuar në Shërbimin Policor të Kosovës, Njësia e Hetimit Financiar është përgjegjëse për kryerjen e hetimeve financiare. Është thënë se njësia nuk ka personelin e mjaftueshëm. Me përcjelljen e kompetencave të UNMIK-t tek Shërbimi Policor i Kosovës pritet të bëhet dhe riorganizimi i duhur.

²² Gjykata mund të urdhërojë si më poshtë:

- që asnjë person nuk mund të shesë, transferojë, pengojë, shkatërrojë apo përndryshe të merret me pasurinë;
- që asnjë bankë apo institucion financiar mund të bëjë transferim të pasurisë;
- që, në rastin e pasurisë së paluajtshme, autoritet kompetente do të refuzojnë të verifikojnë një kontratë shitje apo të regjistrojnë transferimin e pasurisë;
- që, në rastin e bizneseve, gjykata cakton një person të besuar (trustee) për të kontrolluar pasurinë ;
- që punonjës të autorizuar të doganave apo policisë bëjnë sekuestrimin e pasurisë.

Shërbimi i Doganave është përgjegjës për hetimin e shkeljeve administrative dhe penale në bazë të Kodit të Doganave. Në bazë të disa seksioneve të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, oficerët e doganës konsiderohen si "oficerë policie" dhe "oficerë të policisë gjyqësore". Ende nuk janë percaktuar standartet e bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të informacionit me Shërbimin Policor të Kosovës.

Autoriteti i Taksave nuk ka kompetenca policore. Në përputhje me Nenin 59 të Kodit të Taksave, Autoriteti i Taksave mund të japë informacion në lidhje me një tatimpagues agjensive të zbatimit të ligjit, për përdorim në një proces hetimor, mbi shkelje financiare dhe tatimore pa patur një urdhër nga gjykata. Në rastin e shkeljeve të tjera penale, duhet marrë aprovimi i gjykatës.

Qendra e Informacionit Financiar (FIC) u ngrit në vitin 2004 në kuadrin e Shtyllës së Policisë dhe Drejtësisë sipas Rregullores së UNMIK-ut 2004/2 mbi parandalimin e pastrimit të parave. Qendra e Informacionit Financiar është një njesi e centralizuar, përgjegjëse për grumbullimin e informacionit në lidhje me pastrimin e parave ose financimin e veprimtarive terroriste, dhe për shpërndarjen e këtij informacioni agjensive të zbatimit të ligjit.

Prokurori

Roli i Prokurorit gjatë procedurave penale paraprake dhe gjatë fazës hetimore rregullohet nga Ligji për Zyrën e Prokurorit Publik (LZPB) dhe KPP-ja. Prokurori është përgjegjës për hetimin e shkeljeve penale dhe supervizimin e punës së policisë gjyqësore (Neni 46/1 i LZPB-s). Prokurori mund të ndërmarrë masat e nevojshme, brenda kompetencave të tij, për detektimin e shkeljeve penale zbulimin e autorëve të krimit dhe ka të drejtën të ndërmarrë veprime hetimore ndërkohë që drejton apo supervizon hetimet në procedurat penale paraprake (Neni 47).

Hetimi penal (para-gjyqësor) fillohet dhe drejtohet nga prokurori, kur ka dyshim të arsyeshëm që personi ka kryer një vepër penale (Neni 220 i KPP-s). Gjatë procedurave penale, ai mund të ndërmarrë masat e nevojshme vetë, ose përmes policisë gjyqësore (Neni 51).

Prokuroria Speciale (katër prokurorë lokalë dhe pesë prokurorë ndërkombëtarë) u ngrit në vitin 2006. Roli i saj është të luftojë krimin e rëndë, të organizuar dhe ekonomik: në mënyrë të veçantë, abuzimet me procedurat e privatizimit, prokurimit dhe donacionet, si dhe abuzimet nga buxhetorët (në bazë të raporteve të auditit).

2.5.5 Përfundime

Situata e pasluftës ka efektet e saj në ekonomi dhe mban poshtë standartin e nivelit të jetesës; veç kësaj, çështja e pazgjidhur e statusit të Kosovës ndikon te kapacitetet e institucioneve dhe sistemeve shtetërore, gjë që e bën edhe më të vështirë luftën kundër krimit dhe targetimin e përfitimeve nga krimi. Lidhja dhe "bashkëpunimi" mes policëve, prokurorëve, gjykatësve ndërkombëtarë dhe autoriteteve vendase po ndryshon dhe në varësi të transferimit të përgjegjësisë. Institucionet lokale (Njësia e Hetimit Financiare e Shërbimit Policor të Kosovës, Prokuroria Speciale) vazhdojnë të kenë nevojë për mbështetje dhe trainim në fushëm e hetimit financiar

Regjimi aktual i konfiskimit ka disa të meta. Konfiskimi i të ardhurave të tërthorta nuk ka rregullim specifik ligjor, por mund²³ të aplikohet nëpërmejt interpretimit të Nenit 83/1 të KP-s. Aksesi në të dhënat bankare konsiderohet si Metodë Hetimore Speciale dhe zbatimi i saj kufizohet në kushtet e aplikueshme për MHS (masat e hetimit special) (për këtë kërkohet dyshim i bazuar). Ngrirja e transaksioneve financiare nuk rregullohet në mënyrë specifike, por zbatohet në praktikë në bazë të

²³ Në mungesë të jurisprudencës, ky është mendimi im.

rregullave të përgjithshme në lidhje me sekuestrimin dhe masat e përkohshme të sigurisë për konfiskimin e të ardhurave nga krimi. Administrimi i objekteve të sekuestruara dhe të siguruara përkohësisht dhe i produkteve të krimit është problematike në kushtet e mungesës së dispozitave konkrete (dhe institucioneve) për administrim, gjë që, përveç të tjerash, do të lejonte shitjen gjatë procedurës.

Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave Penale në Lidhje me të parashikon gjithashtu dhe masa dhe konfiskim të përkohshëm të produkteve të krimit, që nuk janë të lidhura me veprën penale të pastrimit të parave. Megjithatë, zbatimi i tij në praktikë është i kufizuar dhe nuk është zgjidhur lidhja e tij me dispozitat e përgjithshme të KPP-s, kështu që dispozitat e tij më të avancuara nuk përdoren plotësisht në praktikë.

Konfiskimi i shtrirë nuk rregullohet nga legjislacioni penal. Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave parashikon mundësi të kufizuara dhe disa elementë të standartit të lehtësuar të provës.

Vështrim i përgjithshëm

		Kosova
Konfiskimi	82 CC	Përfitimi material i siguruar apo i marrë përmes një aktiviteti kriminal do të konfiskohet me vendim gjykatë që përcakton kryerjen e veprës penale.
Person i tretë, familje	83/2	
Person ligjor	85	
Value conf	83/1 499/2 CPC	...të paguash një sasi parash që i korespondojnë përfimit material të siguruar.
Konfiskimi (sekuestrimi) i objekteve	60	Objektet e përdorura apo të destinuar për përdorim në kryerjen e veprës penale, ose objekte që rrjedhin nga kryerja e një veprës penale, mund të konfiskohen në rast se janë pronë e shkelësit.
Konfiskimi i shtrirë	jo, po	Ligji për Ndalimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të tjera Penale të Lidhura me të (seksioni 10.3): Standarti i provës se prona përbën një produkt krimi, është i lehtësuar. Paraqitjet/Përfaqësimet (të bëra sipas investigimesh secrete) mund të mbështesin vetëm në mënyrë të tërthortë mendimin se pasuria është produkt krimi (seksioni 10.3). Nëse personi pretendon të ketë pronësinë e pronës të njoftuar për konfiskim, personi duhet të japë të dhënat dhe rrethanat në të cilat është siguruar (në mënyrë të ligjshme) pronësia apo statusi i përfituesit në lidhje me pronën (seksioni 11.4c).
KPP		
Hetimi Financiar	490	(1) Përfitimi material i siguruar përmes kryerjes së një veprës penale ose si rezultat i kësaj, do të përcaktohen në procedura penale <i>ex officio</i> . (2) Gjykata dhe agjensitë e tjera që kryejnë procedurat, janë të detyruara të grumbullojnë prova dhe të hetojnë mbi rrethanat që janë të rëndësishme për përcaktimin e përfitimit material.
Procedura para-gjyqësore	499/3	(3) Dispozitat e Nenit 490, paragrafi 1 i Codit aktual aplikojnë <i>mutatis mutandis</i> në procedurat para-gjyqësore: përveç organeve para të cilave kryhen procedurat penale, në mbledhjen e të dhënave dhe në hetimin e rrethanave me rëndësi për përcaktimin e të ardhurave nga krimi do të marrin pjesë edhe organe të tjera në përputhje me këtë ligj.
Aksesi në të dhënat bankare	256/1 xiii 256/11	Dhënia e të dhënave financiare: sigurimi i të dhënave nga një bankë apo një institucion tjetër financiar mbi depozitat, llogaritë apo transaksionet

(si MHS)	257/1,2	Urdhëri i gjykatës: dhënie e informacionit bankar e financiar të palëve të treta
MHS	256-267	
Masat e përkohëshme të sigurisë	493 116/2,3 247	Atje ku është autorizuar konfiskimi i përfitimit material të siguruar nëpërmjet kryerjes së një veprë penale, gjykata është e detyruar të urdhërojë konfiskimin e përkohshëm, ose "sigurimin" e këtij përfitimi. Gjkata mund ta bëjë këtë vendim <i>ex officio</i> , ose me kërkesë të prokurorit public. Masat e përkohëshme që sigurojnë një pretendim pasuror që rrjedh nga kryerja e një veprë penale, mund të urdhërohet në procedura penale në përputhje me dispozitat e zbatueshme në procedurat e ekzekutimit të vendimit bazuar në një kërkesë të lëshuar nga persona të autorizuar. Sekuestrimi provizor i objekteve
Urdhri i ngrirjes		Nuk është i rregulluar në mënyrë specifike.
Administrimi	497 252	Procedura për administrimin e objekteve dhe pasurive të konfiskuara duhet bëhet nga organi publik kompetent në fushën e çështjeve gjyqësore – nuk është aprovuar akoma. Administrimi dhe shitja e objekteve të sekuestruara.
Konfiskimi	494	(1) Konfiskimi i produkteve të krimit mund të urdhërohet në një gjykim ku i akuzuari është shpallur fajtor, apo ku është urdhëruar paralajmërim gjyqësor, si dhe në një vendim që urdhëron marrje masash për trajtim rehabilitues të detyrueshëm të keqbërësve me varësi ndaj alkolit apo drogave.
Procedura e konfiskimit	491	Thërret dhe egzaminon persona te tretë dhe person ligjor
Vlerësimi falas	492	Vlerësimi i vlefës nga Gjykata
Konfiskimi pa dhënien e dënimit	498/1	Gjkata konfiskon përfundimisht përfitimin material, nëse konkludohet se vepra penale (marrje mallrash të vjedhura, dhënie e pranim i pajustificuar i dhuratave, pranim rryshfeti, dhënie rryshfeti dhe shitblerje influencash) është kryer dhe se pasurit në pronësi të të akuzuarit rrjedhin nga vepra penale.
Faqe interneti		www.ks-qov.net , www.kosovopolice.com , www.unmikonline.org/ , www.ks-qov.net/GazetaZyrtare/ , www.unmikonline.com , www.kuvendikosoves.org www.euinkosovo.org
Ligji për Pastrimin e Parave	1.3.2004	Rregullorja e UNMIK-ut 2004/2, me titull "Mbi Ndalimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të tjera Penale në lidhje me të"
	11/1b	Dispozita të zbatueshme edhe për vepra të tjera penale (?). Prokurori publik mund të paraqesë një kërkesë për konfiskim pasurie që përbën produkt krimi, ose që është përdorur apo synuar të përdoret për kryerjen apo mundësimin e pastrimit të parave apo të veprës penal nga dhe kanë rrezultuar produktet e krimit.
Konfiskimi	11	Prokurori lejohet të paraqesë kërkesë për konfiskim pavarësisht nga fakti nëse është nisur procedura penale ndaj personit që ka lidhje me pronën. Mbasi një kërkesë e tillë është paraqitur në gjykatë, personat apo entitetet mund të paraqesin ankesë me pretendimin se janë pronar të ligjshëm të pronës në fjalë.
Value based	11/8	
Supozimi Barra e provës	10/3 11/4c	Standarti i provës se prona në fjalë përbën produkt krimi është lehtësuar. Paraqitjet (të bëra sipas investigimesh sekrete) mund të mbështesin vetëm në mënyrë të tërthortë mendimin se pasuria është produkt krimi (seksioni 10.3). Nëse personi pretendon të ketë pronësinë e pronës, të njoftuar për konfiskim, personi duhet të japë të dhënat dhe rrethanat në

Extended confiscation in South-Eastern Europe

		të cilat është siguruar (në mënyrë të ligjshme) pronësia apo statusi i përfituesit në lidhje me pronën (seksioni 11.4c).
Sigurimi provizor	12	Gjykata mund të marrë vendim që urdhëron marrjen e masave të përkohshme për sigurimin e pronës, kur ka dyshim të bazuar se prona është produkt i krimit dhe kur ka gjasa të forta që prona nuk do të jetë e disponueshme për konfiskim në përfundim të procedurave finale të konfiskimit, në rast se nuk merret masa e përkohshme për sigurimin e pronës.
Ngrirja	12/4b	
Faza para-gjyqësore	12/2	Edhe kur nuk ka procedura penale në proces e sipër
Procedura	12/6	30+30 ditë

2.6 Mali i Zi – Profil i vendit

2.6.1 Legjislacioni aktual²⁴

Legjislacioni është përgjithësisht në përputhje me standartet ndërkombëtare, por përdorimi i tij në praktikë mund të paraqesë disa vështirësi për imlementimin e tij me efektivitet. Mund të përmirësohet sistematizimi dhe koherenca e dispozitave (pas ndryshimeve të vitit 2006).

Mali i zi ka shënuar progres në fushën e konfiskimit të produkteve të krimit nëpërmjet amendimit të KPP-s në vitin 2006. Është shtuar një dispozitë speciale në lidhje me krimin e organizuar (Neni 523²⁵).

Amendamentet e vitit 2006 adresuan mungesat kryesore:

- aksesin në të dhënat bankare: përpara ndryshimeve të vitit 2006 aksesin në të dhënat bankare konsiderohej si MHS dhe kufizohej tek veprat penale, për të cilat parashikohej dënimi me 10 vjet burg, ose te krimi i organizuar (Neni 242a). Policia ndonjëherë e gjen mënyrën për të siguruar aksesin tek të dhënat bankare duke e cilësuar veprën penale si larje parash.
- Konfiskimi provizor (masat e sigurisë): përpara vitit 2006, konfiskimi provizor ishte i mundur në procedurat para-gjyqësore vetëm në rastet e krimit të organizuar (Neni i ri 541/4 dhe Neni 523).

Neni aktual 526/3 i KPP-s²⁶ merret me procedurën gjatë konfiskimit provizor dhe lejon çngrirje të pronës së sekuestruar, nëse provohet origjina ligjore e pronës, ose nëse ka arsye për të besuar se prona nuk rrjedh nga ndonjë vepër penale. Dispozita të ngjashme parashikohen në projekt-propozimin e ri për ndryshime të KPP-s në Nenin 94/3²⁷.

Dispozita nuk përdoret në praktikë, pasi konfiskimi i shtrirë nuk përcaktohet në kodin penal. Në rastin e aplikimit të konfiskimit në bazë të vleftës, konfiskohet prona e ligjshme (në vleftën e produktit të krimit) Provat e mbrojtjes në lidhje me origjinën legale të pronës, në këto raste, nuk duhet të jenë relevante me qëllim çngrirjen e pronës së sekuestruar.

2.6.2 Konfiskimi i shtrirë

²⁴ Kodi penal (OJ [70/2003](#), [13/2004](#), [47/2006](#)).

Kodi i Procedurës Penale (OJ [71/2003](#), [7/2004](#), [47/2006](#)).

²⁵ Neni 523 (1) Në qoftë se ka vend për dyshim apo dyshim të arsyeshëm se është kryer vepra penale e krimit të organizuar, Gjykata mund të urdhërojë masën e konfiskimit të përkohshëm të objekteve dhe përfitimeve pasurore pa marrë parasysh kushtet e parashikuara në dispozitat e Neneve 81 deri 87 dhe Artikujt 538 deri 545 të këtij Kodi.

(2) Nëse nuk parashikohet ndryshe nga dispozitat e këtij Kapitulli, në procedurat e konfiskimit të përkohshëm të objekteve e përfitimeve pasurore referuar në Nenin 1 të këtij Kodi, do të zbatohen me përputhshmëri dispozitat e Ligjit për Procedurat Ekzekutive, si dhe dispozitat relevante të këtij Kodi.

²⁶ 526/3 Paneli mund të revokojë (dhe të ndryshojë) masën e referuar në Paragrafin 1 të këtij Neni, në rast se provohet origjina legjitime e objekteve apo përfitimeve pasurore në bazë dokumentesh autentike dhe/ ose nëse ka arsye për të besuar se objektet dhe përfitimet pasurore nuk rrjedhin nga vepra penale të krimit të organizuar e që nuk janë siguruar duke fshehur origjinën dhe mënyrën për sigurim tyre.

²⁷ 94/3 Vijeće će mjeru iz stava 1 ovog člana ukinuti ako se vjerodostojnim ispravama dokaže zakonitost porijekla predmeta ili imovinske koristi ili ako se učini vjerovatnim da predmeti ili imovinska korist ne potiču iz krivičnog djela, niti da su pribavljeni prikrivanjem porijekla i osnova sticanja.

Nuk ka dispozita që lejojnë konfiskimin e shtrirë. Ndryshimet e fundit të KPP-s (2006) futën procedurat për çngrirjen e pasurisë së konfiskuar (sekuestruar) provizorisht me përmbyse të barrës së provës (Neni 526/3).

2.6.3 Përgatitja e legjislacionit

Mali i Zi u angazhua për të ndryshuar KP-n dhe KPP-n, gjë që siguron mundësinë për përmirësime, përfshirë edhe fushën e konfiskimit të produkteve të krimit. Plan-veprimi për implementimin e Programit për luftën kundër korrupsionit përfshin planin për ndryshime të KP-s në lidhje me konfiskimin e shtrirë. Krijimi i grupit të punës është parashikuar për fundin e vitit 2007.

Në vitin 2007 u ngrit grupi i punës për ndryshimet (konceptuale) të KPP-s. Anëtarët janë: Prof. Drago Radulović (kryetar), Radule Kojovic (gjykatës i gjykatës së lartë), Ranka Carapic (prokuror i lartë i shtetit/kryeprokuror), Sucko Bakovic (Prokuror Special i OC-s), Vlado Vukotic (punonjës i policisë), Orle Markovic (avokat), Vuksan Vuksanovic (MoJ).

Grupi i punës planifikon t'i paraqesë Këshillit të Europës projektin e parë të punës për KPP-n, në Korrik të vitit 2007. Qëllimi kryesor është të eliminojë hetimet e gjykatës, por gjithashtu parashikohen edhe disa ndryshime në fushën e konfiskimeve. Pritet që legjislacioni të futet në procedurën parlamentare në fund të vitit 2007.

Disa mendime për ndryshime të mundshme:

- Konfiskim i shtrirë: amendime të nenit 113 të KP-s.
- Amendime të KPP-s; Nenet 541 (konfiskimi provizor), 526/3 (çngrirja e pasurisë së sekuestruar), 542 (konfiskimi).
- Projekt-propozimi i ri: Nene relevante: 86, 90 (aksesi në të dhënat bankare dhe ngrirja e transaksioneve bankare), 91-98, 94 (masat e përkohshme) dhe 493 (investigimi financiar është gjithashtu i mundur edhe në fazën policore), 496 (sigurimi i pretendimit për konfiskim).
- Të shtohet një dispozitë që lejon gjykatësin hetues të vendosë për shitjen e pasurisë së konfiskuar provizorisht në rastin kur bëhet fjalë për kosto të larta magazinimi/ mirëmbajtje (në mungesë të ligjit special për agjensinë e administrimit dhe metodat e mirëmbajtjes).

Ministria e Financave planifikon të përgatisë, në fund të vitit 2007, Ligjin për Agjensinë e Administrimit të Objekteve dhe Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara.

2.6.4 Institucionet

Policia ka ende nevojë për mbështetje dhe motivim për kryerjen e hetimit financiar. Gjithashtu është përmendur edhe çështja e pagave të vogla dhe kërcënimeve nga grupe kriminale.

Prokuroria Speciale për krimin e organizuar merret edhe me çështjet e krimit të rëndë. Është planifikuar që të vendosen standarte konkrete për hetimin financiar dhe konfiskimin provizor pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve konceptuale në KPP. Sipas praktikës aktuale së shërbimit të Prokurorisë Speciale, bashkangjitur çdo raporti të policisë kriminale kërkohet një shtojcë me listën e pasurive të një të dyshuari.

Gjykatësit nuk ishin të interesuar të merrnin pjesë në seminarin trainuese të CARPO-s. Ka mungesë vetëdije dhe ekspertize në fushën e konfiskimit dhe sekuestrimit provizor në shtetin gjyqësor.

2.6.5 Përfundime

Institucionet kompetente kanë ende nevojë për mëshjetje dhe motivim për kryerjen e hetimit financiar dhe për zbatimin e masave siguruese të përkohshme/e përkohshme dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi.

Disa nga të dhënat nuk janë të përditësuara (regjistri i tokave, regjistri i personave ligjorë...)

Masat e përkohshme (sekuestrimit ose ndalimi i përvetësimit), në disa raste (të rralla), propozohen për të gjithë pasurinë e të dyshuarit. Edhe kur ka një mospërputhje midis pasurisë së deklaruar ligjërisht dhe asaj të poseduar faktikisht, nuk është përcaktuar qartësisht lidhja mes vleftës së produkteve të krimit dhe vleftës së pasurisë. Kjo praktikë ngre çështjen e zbatimit të parimit të proporcionalitetit, duke patur parasysh që konfiskimi i shtrirë nuk është i rregulluar me ligj, dhe kjo mund të çojë në pretendime pasurore të të dyshuarit mbas përfundimit të çështjes me shfajësim. Çështja është nëse kjo është pasojë e Nenit 523 të KPP-s. Praktika gjyqësore ende nuk është vendosur.

Nuk ekzistojnë baza të dhënash apo statistika sistematike mbi hetimin financiar, masat e përkohshme dhe rastet e konfiskimit. Megjithatë, në bazë të të dhënave të marra nga institucionet, rezulton se janë marrë masa e përkohshme në katër raste ndaj 25 të dyshuarve në vitin 2005 dhe në gjashtë raste ndaj 40 të dyshuarve në vitin 2006 (8 MIO €). Shumica e çështjeve kanë të bëjnë me veprën e pastrimit të parave me abuzimin e pushtetit dhe janë ende në fazën e hetimit. Në Malin e Zi nuk ka ende ndonjë vendim të formës së prerë për çështje të pastrimit të parave.

Vështirësitë /problemet kryesore:

- Mungesa e një agjensie të specializuar për trajtimin e pasurisë së sekuestruar/konfiskuar,
- Evidenca të paplota të pasurive të paluajtëshme (ndërtimet e paligjshme),
- Mungesa e mundësisë ligjore për konfiskim të shtrirë/ barrë prove e përmbytur,
- KPP-ja nuk zbatohet në praktikë (MHS, aksesit në të dhënat bankare vetëm për krimin e organizuar).

2.6.6 Vështrim i përgjithshëm

KP		Mali i Zi
Konfiskimi	112	(1) Askush nuk lejohet të ketë përfitime materiale të siguruara përmes një vepe penale. ...
Procedura direkte/indirekte	113	(1) Paratë, objektet me vlerë dhe çdo përfitim tjetër pasuror të siguruara përmes një vepe penale do t'i sekuestrohen shkelësit të ligjit; nëse sekuestrimi është i pamundur, keqbërësi është i detyruar të pagualë vleftën monetare për pasurinë e përfituar....
Konfiskimi me vleftë	113/1	
Personat e tretë	113/2,3	Pa ose kompensim dukshëm paplotë
Personi ligjor	113/3 ?	113/3 mund të interpretohet si i tillë (persona të tjerë), + 542/3 CPC, 539/2
Konfiskim i shtrirë	No	
KPP		
Hetimi financiar	538/2 247	Gjatë kryerjes së procedurave, gjykata ose autoritete të tjera para të cilëve kryhen procedurat, janë të detyruar të sigurojnë fakte dhe të hetojnë mbi rrethanat që kanë lidhje me përcaktimin e përfitimit material.
MHS	237	
Aksesi në të	242a/1	Ndryshimet e vitit 2006: dyshim për vepër penale

dhënat e bankës		
Konfiskimi provizor		
Ngrirja e llogarive bankare Sigurimi i pasurisë	242a/2 541 523 OC	Ndryshimet e vitit 2006: në rast dyshimi për qëllim përdorimi për vepër penale apo për fshehje të produkteve të krimit - vendim i gjykatësit hetues. Ndryshimet e vitit 2006 541/4: gjithshatë edhe në procedurë para-gjyqësore 523 (dispozitë e gjerë për krimin e organizuar)
Apelimi Procedurë për të provuar origjinën e ligjshme	525 e re 541a,b, v,g 526/3 527, 528	(526/3) Paneli mund të revokojë masat e referuara në Paragrafin 1 të këtij Neni, në rast se provohet origjina legjitime e një objekti apo pasurie të përfituar në bazë dokumentesh autentike e nëse ka arsye për të besuar se objektet dhe pasuria e përfituar nuk rrjedhin nga vepra penale e krimit të organizuar e se ato nuk janë përfituar duke fshehur origjinën dhe kushtet në të cilën janë siguruar.
Administrimi	529	Autoriteti shtetëror kompetent? (dispozitë e bardhë)
Konfiskimi	542	Gjykimi/vendimi
Procedura	539	
Vlerësim falas i vleftës	540	
Legjislacion special	NO	
Faqe interneti	NO	
		Instituzione (të specializuara)
Policia		
Prokurori		Shërbimi i Prokurorisë Speciale për luftën kundër krimit të organizuar
Gjykatësi		Gjykatësi hetues: hetimi gjyqësor

2.6.6.1.1

		KPP – Projekt-propozim (Qershor 2007)
Hetimi financiar	493	(përfshirë fazën para-gjyqësore)
MHS	yes	
Akresi në të dhënat bankare	90/1	Prokurori
Konfiskimi provizor	91, 94 496	(përfshirë fazën para-gjyqësore) (masat e sigurisë – koherenca me Nenin 91?)
Ngrirja e llogarive bankare	90/2, 4	
Apelimi/ Procedura për të provuar origjinën ligjore	90/6, 94 94/3	(3) Vijeće će mjeru iz stava 1 ovog člana ukinuti ako se vjerodostojnim ispravama <u>dokaže</u> zakonitost porijekla predmeta ili imovinske koristi ili ako se <u>učini vjerovatnim</u> da predmeti ili imovinska korist ne potiču iz krivičnog djela, niti da su pribavljeni prikrićem porijekla i osnova sticanja.
Administrimi	97	(blank norm)
Konfiskimi	494, 497	
Vlerësim falas i vleftës	495	

2.7 Serbia – Profil i vendit

2.7.1 Legjislacioni aktual²⁸

Kodi i ri i Procedurës Penale (në vijim KPP i ri) u aprovua në vitin 2006 (OJ 46/2006, 49/07). Fillimisht i parashikuar si *vacatio legis* (1 Qershor 2007), veprimi i tij u zgjat deri pas mbledhjes së parlamentit të ri, në 31 Dhjetor 2008 (shiko kapitullin 3 më poshtë). Kodi Penal (në vijim KP) u aprovua 2005.

Konfiskimi i produkteve të krimit

Konfiskimi i produkteve të krimit rregullohet nga Nenet 87 dhe 91 deri 93 të KP-s. Neni 87 i KP-s parashikon ndalimin e objekteve të destinuara për kryerjen e një krimi, apo të objekteve që rrjedhin nga krimi, në rast se ato janë pronë e autorit të krimit. Këto objekte mund të ndalohen edhe në rastet kur nuk janë pronë e autorit të krimit, nëse kjo gjë kërkohet në interes të sigurisë së përgjithshme apo për arsye morale.

Sipas Nenit 91 të KP-s, askush nuk mund të posedojë/mbajë përfitime pasurore të siguruar nga krimi. Përfitimi konfiskohet me vendim gjykate që konfirmon kryerjen e krimit. Paratë, objektet me vlerë e të gjithë përfitimet e tjera pasurore të siguruar përmes krimit i ndalohen autorit të krimit, dhe atje ku nuk është i mundur ndalimi i tyre, autori i krimit është i detyruar të paguajë vleftën monetare të barabartë me përfitimet pasurore të siguruar në këtë mënyrë (Neni 92/1 i KP-s). Përfitimet pasurore mund t'i sekuestrohen edhe një personi, tek i cili janë transferuar të drejtat e pronësisë mbi to, dhe kjo gjë është bërë pa pagesë ose me një pagesë që nuk i korrespondon vleftës reale të pronës (Neni 92/2 i KP-s). Pretendimi pasuror i viktimës në procedurë penale rregullohet nga Nenet 93 të KP-s, 201-212 dhe 513/3 të KPP-s. Konfiskimi i produkteve të krimit nga një person ligjor nuk rregullohet në mënyrë eksplicite, por është i mundshëm me anë të interpretimit të Nenit 92/2 të KP-s (transformimi i përfitimit të një personi) dhe Neni 514 të KPP-s (roli i përfaqësuesit të një personi ligjor gjatë procedurës së konfiskimit)

Baza ligjore për hetimin financiar, sekuestrimin provizor të objekteve, instrumentet e procedurat dhe procedura e konfiskimit të produkteve të krimit përcaktohet në Kodin e Procedurës Penale, Nenet 82-86, 234, 504a-504h (dispozita speciale në lidhje me krimin e organizuar) dhe 513-520.

Konfiskimi i të ardhurave nga krimi vendoset me vendim gjykate që konfirmon fajësinë e të akuzuarit (Neni 517 I KPP). Procedura për të vendosur në lidhje me konfiskimin (duke siguruar fakte dhe dëshmi) rregullohet nga Neni 514 i KPP-s dhe mundësia që gjykata të vlerësojë vleftën e saktë të përfitimeve me vlerësim falas rregullohet nga Neni 515 i KPP-s.

Masat e përkohshme

Masat e përkohshme rregullohen në dy pjesë të KPP-s. Nenet 82 dhe në vazhdim kanë të bëjnë me sekuestrimin provizor të objekteve, fakteve, intrumenteve dhe rezultateve (produkte) të krimit.

²⁸ Kodi I Procedurës Penale (OJ 70/2001, 68/2002, 58/2004, 85/2005, 115/2005, 85/2005 dhe 115/2005).

Kodi I Procedurës Penale (OJ RS 46/2006, 49/07), data e hyrjes në fuqi 1.1.2008.

Kodi Penal (OJ RS 85/05).

Ligji për procedurat përmbarese (OJ 125/04).

Ligji për organizimin dhe përgjegjësitë e organeve shtetërore në luftë kundër krimit të organizuar Law (42/02, 27/03, 39/03, 67/03, 29/04, 45/05, 61/05).

www.srbija.sr.gov.yu/ (Qeveria Serbe)

www.parlament.sr.gov.yu/content/cir/aktivnosti/skupstinske_arhiva.asp (National Assembly)

Neni 516 ka të bëjë me masat e përkohshme të sigurisë për pronën, e cila mund të konfiskohet si produkt krimi dhe Neni 234 rregullon ngrirjen e llogarive bankare.

Sekuestrimi provizor i objekteve të destinuara për kryerjen e një krimi apo i objekteve që rezultojnë nga krimi, ose i objekteve që mund të shërbejnë si fakte, mund të urdhërohet nga gjykata (Neni 82 I KPP-s). Këto objekte mund të sekuestrohen nga policia, në përmbushje të detyrave të saj në përputhje me Nenet 225 dhe 238 të KPP-s (Neni 82/4 I KPP-s).

Masat e përkohshme të sigurisë gjatë procedurës penale urdhërohen *ex officio* nga gjykata (gjykatësi hetues ose gjykatësi) në përputhje me rregullat e procedurës përmbartuese/ekzekutive²⁹ (Neni 516 i KPP-s). Masat e përkohshme nuk mund të urdhërohen në fazën e hetimeve nga policia, por vetëm pas fillimit të hetimeve formale nga gjykata. Kjo rregullore mund të pengojë efektshmërinë e masave në praktikë, sidomos në hetimin e krimeve të rënda.

Ngrirja e transaksioneve financiare mund të urdhërohet nga gjykatësi hetues me propozim të prokurorit, kur dyshohet se transaksioni përbën vepër penale ose ka për qëllim kryerjen e një veprë penale apo të fshehtë veprën penale apo produktet e krimit (Neni 234/2 I KPP-s).

Administrimi i objekteve apo pronës së sekuestruar dhe siguruar nuk rregullohet mjaftueshëm nga legjislacioni serb. Objektet e sekuestruara provizorisht i përcillen gjykatës, ose ruajtja e tyre duhet të sigurohet në një mënyrë tjetër të rregullt (Neni 82/1 i KPP-s). Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (në vijim LESP) parashikon transferimin e mjeteve të konfiskuara buxhetit të shtetit (Neni 327 i LESP-s). Neni 212 i LESP-s rregullon trajtimin e objekteve të konfiskuara. Gjykata mund të vendosë t'i shesë ato në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurat Përmbartuese/Ekzekutuese, t'ia dorëzojë organeve shtetërore kompetente, muzeut të krimeve, institucioneve shkencore apo të bamirësisë, t'i shkatërrojë apo trajtojë ato në përputhje me rregulloren speciale. Mjetet e siguruar nga shitja e objekteve të ndaluara janë të ardhura në buxhetin e Republikës së Serbisë.

Hetimi financiar nuk përcaktohet në mënyrë specifike nga Kodi i Procedurës Penale. Baza ligjore mund të gjendet në Nenin 513/1, i cili kërkon përcaktimin *ex officio*, në procedurë penale, të përfitimit pasuror të rrjedhur nga kryerja e një veprë penale. Gjykata dhe organe të tjera që kryejnë procedurën penale, janë të detyruar të mbledhin të dhëna/prova dhe të përcaktojnë rrethanat që janë të rëndësishme për përcaktimin e pasurive dhe produkteve të krimit (Neni 513/2 i KPP-s). Faza para-gjyqësore (hetimi nga policia) në këtë mënyrë, nuk mbulohet në mënyrë specifike nga ligji!

Gjykatësi hetues, me kërkesë të prokurorit, urdhëron bankën apo institucionin financiar për nxjerrjen e të dhënave në lidhje me llogarinë bankare të të dyshuarit (Neni 234/1). Aksesit kufizohet vetëm tek llogaria bankare e të dyshuarit dhe vetëm në rastet kur ka dyshim për një vepër penale të dënueshme me minimumi 4 vjet burgim. Kufizimet, për mendimin tim, janë shumë penguese për të bërë të mundur një hetim financiar të efektshëm. Nuk ka rregullim ligjor për monitorimin e llogarive bankare.

MHS-t rregullohen nga Nenet 232-234 dhe 504lj të KPP-s.

Dispozita të veçanta në lidhje me krimin e organizuar

Rregullat speciale në lidhje me krimin e organizuar rregullohen nga KPP-ja në Nenet 504a-504h. Në rast dyshimi të bazuar për krim të organizuar, gjykata mund të urdhërojë sekuestrimin provizor të objekteve dhe përfitimeve nga krimi, pavarësisht kushteve të përcaktuara në Nenet 82-88 dhe Nenet 513-520 të KPP-s. Po kështu zbatohet Ligji për Procedurat e Ekzekutimit (Neni 504r i KPP-s).

²⁹ Shiko Nenet 300 dhe 303 të Ligjit për Procedurën e Ekzekutimit.

Dispozitat lejojnë konfiskimin provizor edhe gjatë procedurës para-hetimore (të policisë). Dispozita nuk është tërësisht e qartë, pasi kushtet e vendosura nga KPP-ja për sekuestrimin e objekteve dhe për konfiskimin provizor të produkteve të krimit nuk janë të zbatueshme dhe nuk përcaktohen kushte të qarta për përdorimin e 504r të KPP-s. Procedura, propozimi dhe vendimi, apeli, seanca dëgjimore, koha dhe ekzekutimi i konfiskimit provizor rregullohet nga Nenet 504 s, t, ç, u, f dhe h.

Në përputhje me Nenin 504k të KPP-s, prokurori mund t'u kërkojë organeve shtetërore, bankës apo institucioneve financiare të japin të dhëna për një person të caktuar, të cilat mund të shërbejnë si fakte të një veprë penale apo të produkteve të krimit. Dispozita nuk kufizohet tek të dhënat mbi të dyshuarin dhe tek faza hetimore (si në Nenin 234/1 të KPP-s). Prokurori mund të kërkojë gjithashtu informacion edhe për transaksione të dyshimta në lidhje me pastrim parash.

Prokurori mund të urdhërojë ngrirjen e transaksioneve bankare (Neni 504k/2 I KPP-s).

Dispozita speciale në lidhje me krimin e organizuar u kaluan tek Kodi i ri i Procedurës Penale KPP (2006) si dispozita të përgjithshme³⁰.

Në përputhje me Ligjin për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Organeve Shtetërore në Luftë kundër Krimit të Organizuar³¹, u krijuan njësi të specializuara për krimin e organizuar në Polici, Shërbimin e Prokurorisë dhe në gjykata.

2.7.2 Konfiskimi i shtrirë

Konfiskimi i shtrirë nuk rregullohet nga legjislacioni penal. Qeveria e re shpalli futjen e konfiskimit së shtrirë gjatë fushatës para-elektorale. Është thënë që OSBE-ja pritet të sigurojë ekspertizën në përgatitjen e ndryshimeve ligjore në lidhje me konfiskimin e shtrirë.

Amendimet në Kodin Penal (KP) në vitin 2003 vendosën një tjetër penallti/ndëshkim të konfiskimit të përgjithshëm (Article 39a), i cili mund të zbatohet mbi një person të dënuar për kryerjen e një veprë penale të lidhur me krimin e organizuar, me të paktën 4 vite burgim. Gjykata munt t'i ndalojë një personi të gjithë pasuritë e tij, me përjashtim të atyre që ai lejohet të mbajë. Një konfiskim i tillë i përgjithshëm binte në kundërshtim me standartet e të drejtave të njeriut të përcaktuara në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Dispozitat ligjore shtesë të nevojshme për zbatimin e nenit nuk u aprovuan. Kjo dispozitë nuk ekziston më në Kodin e ri Penal (2005).

2.7.3 Përgatitja e legjislacionit

Projekt-ligj për Drejtorinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara/ Konfiskuara:

Propozimi është një hap përpara, por, për mendimin tim, nuk merret me disa çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me administrimin e pasurive dhe të kompetencave të Drejtorisë dhe për përdorimin e objekteve dhe pasurive të konfiskuara.

Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale (i zbatueshëm pas 13 Dhjetorit 2008)

Kodi i ri i Procedurës Penale nuk ka bërë shumë përmirësime në fushën e targetimit të produkteve të krimit. Dispozitat në lidhje me targetimin e produkteve të krimit të organizuar (Nenet 504a-h të KPP-s) janë të një natyre të përgjithëshme në ligjin e ri (Nenet 86-94 KPP-s së re). Në të njëjtën

³⁰ Shiko kapitullin 3.

³¹ Shiko kapitullin 4.

kohë, dispozitat e përgjithshme (234, 513-520 të KPP-s) janë ende pjesë e ligjit të ri (Nenet 491-497 të KPP-s së re). Mund të përmirësohet koherenca dhe sistematizimi i disa dispozitave.

Dispozita e diskutueshme 504r, që parashikon konfiskimin provizor të objekteve dhe përfitimeve pasurore, me gjithë kushtet e përgjithshme të vendosura nga KPP-ja, u ndryshua lehtësisht (Neni 87 I KPP-s së re). Ajo kufizohet në rastet kur kemi dyshim të bazuar/mbështetur se objekti apo përfitimi rrjedh nga një vepër penale e dënueshme me dhjetë a më shumë vite burgim (përpara se të kërkohej lidhja me krimin e organizuar). Shkalla e veprimit dhe kushtet për përdorimin e tij janë ende për t'u vendosur. Flitet për amendime të mundshme para hyrjes në fuqi të ligjit.

2.7.4 Institucionet

Policia

Brënda Ministrisë së Brendëshme, Departamenti për Luftën kundër Krimin të Organizuar (DLKO) është i specializuar edhe për kryerjen e hetimit financiar brënda kompetencave të tij për luftimin e krimin të organizuar.

Është ngritur një polici tatimore (financiare), por nuk është bërë ende plotësisht operacionale. Rregullimi i kompetencave të saj nuk është i mjaftueshëm, pasi në rastin e hetimit të veprave penale (evazioni fiskal, etj.) zbatohen vetëm një pjesë e kompetencave të policisë. Është deklaruar se roli i policisë së taksave në ndalimin e produkteve të krimin është shumë i kufizuar në praktikë.

Kompetencat e përgjithshme të policisë rregullohen nga Neni 225 i KPP-s.

Prokurori

Procedura penale fillon me hetimin (nga gjykata), ndërmarrë nga gjykatësi hetues me propozim të prokurorit. Prokurori drejton hetimin para-penal (policia). Në rastin e krimin të organizuar (dispozitat speciale në nenet 504a-), prokurori mund të urdhërojë ngrirjen e transaksioneve financiare (504k I KPP-s), si pjesë e procedurës para-hetimore. Prokurorët specialë janë gjithashtu të supozuar të targetojnë produktet e krimin.

Gjykatësi hetues urdhëron masat hetimore, aksesin në të dhënat bankare, ngrirjen e llogarive bankare dhe masat e sigurisë e përkohshme gjatë procedurës para-gjyqësore (faza para-penale dhe e hetimit).

Në përputhje me Ligjin e vitit 2002 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Organeve Shtetërore për Luftën kundër Krimin të Organizuar, u krijuan njësi të specializuara në polici, prokurori dhe gjykatë:

- Njësi speciale për luftën kundër krimin të organizuar (shërbimi i specializuar i prokurorisë) brenda Prokurorisë së rrethit të Beogradit
- Departamenti për luftën kundër krimin të organizuar (SBPOK) në Ministrinë e Brendëshme,
- Njësia speciale për procedimin e çështjeve penale të përcaktuara me ligj (Njësia Speciale e Gjykatës së Rrethit/ Distriktit dhe Njësia Speciale e Gjykatës së Apelit) Brenda gjykatës së rrethit dhe gjykatës së apelit në Beograd).

2.7.5 Përfundime

Në Serbi nuk ka rregullim ligjor për konfiskimin e shtrirë.

Vështirësitë kryesore të legjislacionit ekzistues janë të lidhura me aksesin e kufizuar në të dhënat bankare vetëm për të dyshuarit për një vepër penale të dënueshme me më shumë se 4 vite burgim (Neni 234 i KPP-s). Nuk ka rregullim ligjor për monitorimin e llogarive bankare. Hetimi financiar në

fazën para-hetimore nuk është i rregulluar në mënyrë specifike (interpretim i Neneve 513 dhe 225).

Masat e përkohshme nuk mund të urdhërohen gjatë fazës së hetimeve nga policia, por vetëm pasi të ketë filluar formalisht hetimi nga gjykata (Neni 516 i KPP-s), përveç rasteve të krimit të organizuar kur masat e përkohshme mund të merren edhe në fazën para-hetimore (nga policia) (Neni 504r i KPP-s).

Administrimi i objekteve dhe përfitimeve pasurore të sekuestruara dhe të siguruara nuk rregullohet mjaftueshëm nga legjislacioni serb.

Nuk ka rregullim eksplicit për konfiskimin e produkteve indirekte të krimit (Neni 92 i KP-s). Nuk ka rregullim ligjor për rastet kur procedura penale nuk mbaron me vendim (në raste kur ka kufizime kohore, kur ndodh vdekja e të akuzuarit gjatë procesit, etj.).

Konfiskimi i produkteve të krimit prej një personi ligjor nuk rregullohet në mënyrë eksplicite, por është i mundur me interpretim të Nenit 92/2 të KP-s (transformimi i përfitimit një personi tjetër) dhe Neni 514 të KPP-s (roli i përfaqësuesit të personit ligjor gjatë procedurës së konfiskimit). Nuk ka rregullim ligjor për përgjegjësinë penale të personave ligjorë.

Dispozitat speciale të KPP-s në lidhje me krimin e organizuar parashikojnë gjithashtu konfiskimin provizor gjatë procedurës para-hetimore (nga policia) (Neni 504r). Fusha e veprimit nuk është fare e qartë, pasi kushtet e përcaktuara nga Kodi i Procedurës Penale për sekuestrimin e objekteve dhe konfiskimin provizor të produkteve të krimit nuk janë të zbatueshme dhe nuk kemi përcaktim kushtesh të qarta. Dispozita e Nenit 504k të KPP-s në lidhje me aksesin në të dhënat bankare nuk kufizohet vetëm të dhënat për të dyshuarin dhe vetëm për fazën hetimore (si në nenin 234/1 të KPP-s).

KPP-ja e re ka sjellë shumë përmirësim në fushën e targetimit të produkteve të krimit. Dispozitat ekzistuese në lidhje me targetimin e krimit të organizuar (504a-h i KPP-s), të cilat u kaluan te Kodi i ri i Procedurës Penale nuk kufizohen më vetëm tek rastet e krimit të organizuar. Përderisa dispozitat ekzistuese të përgjithshme u bënë pjesë edhe e Kodit të ri të Procedurës Penale, mund të ish përmirësuar koherenca dhe sistematizimi i disa dispozitave.

Institucionet e specializuara për luftën kundër krimit të organizuar brenda policisë, prokurorisë dhe gjykatës, u ngritën në vitin 2003.

2.7.6 Përshkrim i përgjithshëm

KP		
Konfiskimi	91 CC 87 CC	Konfiskimi i produkteve të krimit Konfiskimi i objekteve
Produkte direkte/indirekte	92/1	
Konfiskimi në bazë të vleftës	92/1	
Personat e tretë	92/2, 92/3	
Personi ligjor	92/2	dhe 514 I KPP-s
Konfiskimi i shtrirë	NO	
KPP		
Hetimi	513	

financiar		
MHS	232-234 504lj (OC)	
Faza para-gjyqësore	no 513	Interpretim i 225 (kompetenca te policisë së përgjithshme)
Aksesi në të dhënat bankare	234 504 k (OC)	I kufizuar në të dhënat për të dyshuar për krim të dënueshëm me më shumë se 4 vjet burg Urdhër i prokurorit
Konfiskimi provizor	82 516 504r (OC)	objekte produkte të krimi pa kushte të parashikuara nga KPP
Faza para-gjyqësore	jo 516 po 504r (OC)	
Ngjirja e llogarive bankare	234/2 504k/2 (OC)	Gjykatësi hetues prokurori
Procedura Apeli	82-86 504 s, t, ç, u, f, h (OC)	objekte
Administrimi	no 504 h (OC)	Autoriteti përgjegjës (i cili nuk është përcaktuar apo vendosur) – project-propozim
Konfiskimi	517	
procedura	514 518, 519	Personi i tretë dhe personi ligjor Mjete ligjore
Vlerësim i vleftës	515	Vlerësim falas nga gjykata
Ekzekutimi		Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe Ligji për Procedurën Ekzekutive/Përmbartuese
Legjislacioni special	504a - h	Krimi i organizuar Ligji për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Organeve Shtetërore në Luftën kundër Krimin të Organizuar
Faqe interneti	Qeveria Parlamenti	www.srbija.sr.gov.yu/ www.parlament.sr.gov.yu/content/cir/aktivnosti/skupstinske_arhiva.asp
Institucione (të specializuara)		
Ministria e Brendëshme		Departamenti i luftës kundër krimin të organizuar (SBPOK) në Ministrinë e Brendëshme
Policia tatimore		Ministria e Financës
Prokuroria		Njësia Speciale për luftën kundër krimin të organizuar (shërbimi i prokurorisë speciale) në prokurorinë e rrethit në Beograd.
Gjykata		Njësia speciale për procedimin e çështjeve penale përcaktua me ligj (Njësia speciale e gjykatës së rrethit dhe njësia speciale e gjykatës së apelit) në gjykatën e rrethit dhe gjykatën e apelit në Beograd.

3 Standarte ndërkombëtare

Disa instrumente ligjore ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Europës dhe të Bashkimit Europian nxisin implementimin e konfiskimit të shtrirë, në përputhje me parimet e të drejtës së brendëshme.

Legjislacioni për konfiskimin e zgjeruar në Europë është shumë i ndryshëm. Është e qartë që zgjidhjet shkojnë sipas sistemit specifik ligjor (penal) të një vendi dhe ndikohen nga praktika gjyqësore, gjë që ka rezultuar në disa amendime gjatë implementimit në vite.

Dispozitat e konfiskimit të zgjeruar janë testuar gjithashtu nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ka zhvilluar një jurisprudencë të pasur dhe standarte të këtij legjislacioni në përputhje me standartet e të drejtave të njeriut³².

Në këtë punim do të paraqiten shkurtimisht legjislacioni hollandez, danez dhe ai irlandez. Arsyet për implementimin e konfiskimit të zgjeruar në këto vende janë të ndryshme, por normalisht të lidhura me vetëdijen (publike) për një luftë sa më të efektshme kundër krimit (vrasja e gazetarit në Irlandë, luftë bandash në Danimarkë, etj.)

Të gjithë vendet e sipër-përmendura kanë gjithashtu dhe një sistem të konfiskimit "standart". Konfiskimi i shtrirë zakonisht aplikohet për krime të caktuara të rënda (të dënueshme me burgim ose me gjobë mbi një limit të caktuar) ose në kushte të tjera.

3.1 Instrumente ligjore ndërkombëtare

Këshilli i Europës, Bashkimi Europian dhe Kombet e Bashkuara kanë aprovuar disa instrumente ligjore për nxitjen e konfiskimit të shtrirë me përmbyesje të barrës së provës për burimin e të ardhurave apo pasurisë së autorit të krimit. Megjithatë vetëm Konventa e fundit e Këshillit të Europës e vitit 2005 për Pastrimin e Parave, Kontrollin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe për Financimin e Terrorizmit (Varshavë), e cila ende nuk ka hyrë në fuqi, vendos detyrimin për shtetet (Neni 3/4), me rezervë të mundshme (Neni 53/4).

Konventa e vitit 2005 për Pastrimin e Parave, Kontrollin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e produkteve të Krimit dhe për Financimin e Terrorizmit (Varshavë), Neni 3, paragrafi 4:

Çdo shtet anëtar duhet të adoptojë masa legjislative dhe të tjera, sipas nevojës, në bazë të të cilave, në lidhje me një vepër ose vepra të rënda penale, në përputhje me ligjin, kërkohet që një shkelës i ligjit të demonstrojë origjinën e produkteve të supozuara apo të pasurive të tjera të supozuara për konfiskim, me kusht që një kërkesë e tillë të jetë në përputhje me parimet e të drejtës së brendëshme.

UN Vienna dhe Konventa UNTOC sugjerojnë që shtetet mund të marrin në konsideratë mundësinë që një autori krimi/kundravajtësi t'i kërkohet që të demonstrojë origjinën e ligjshme të produkteve të supozuara të krimit apo të pasurive të tjera të hapura për konfiskim, me kusht që një kërkesë e tillë t'i përmbahet parimeve të së drejtës së tyre të brendëshme dhe natyrës së procedurave gjyqësore e të tjera.

Konventa e vitit 1988 kundër Trafikimit të Paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave Psikotropike (Konventa e Vienës), Neni 5, paragrafi 4:

Secila Palë mund të marrë në konsideratë të sigurojë përmbyesjen e barra e provës në lidhje me origjinën e ligjshme të produkteve të supozuara apo të pasurive të tjera të predispozura për konfiskim, deri në

³² Shiko edhe kapitullin 5 të CARPO "Manual për hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit".

masën që një veprim i tillë t'i përmbahet parimeve të së drejtës së brendëshme dhe natyrës së procedurave gjyqësore dhe të tjera.

Konventa e viti 2000 kundër Krimit të Organizuar Transnacional (UNTOC Konventa e Palermos),

Neni 12, paragrafi 7:

Shtetet Palë mund të konsiderojnë mundësinë që një kundravajtësi t'i kërkohej të demonstrojë origjinën e ligjshme të produkteve të krimit të supozuara apo të pasurive të tjera të predispozura për konfiskim, deri në masën që një kërkesë e tillë t'i përmbahet parimeve të së drejtës së tyre të brendëshme dhe natyrës së procedurave gjyqësore dhe të tjera.

Plan Veprimi i Bashkimit Europian i vitit 2000: parandalimi dhe kontrollimi i krimit të organizuar: një strategji e Bashkimit Europian për fillimin e mijëvjeçarit të ri perfshinte në Rekomandim 19³³ çështjen e përmbysjes së barrës së provës.

Rekomandim 19:

Duhet bërë një egzaminim në lidhje me nevojën e mundshme për pasjen e një instrumenti i cili, duke marrë parasysh praktikën më të mira që funksionojnë në Shtetet anëtare dhe në respektim të plotë të parimeve ligjore fundamentale, të shohë mundësinë e lehtësimit, në përputhje me ligjin penal, civil e fiskal, të barrës së provës për origjinën e pasurive të disponuara nga një i dënuar për një vepër penale të lidhur me krimin e organizuar.

Vendim Kuadër i Këshillit (2005/212/JHA) për Konfiskimin e Produkteve, të Instrumenteve dhe Pasurive të Lidhura me Krimin, i datës 24 Shkurt 2005, përcakton detyrimin e Shteteve anëtare për adoptimin e masave të nevojshme për të mundësuar kompetencat e shtrira të konfiskimit. Masat duhet të aprovohen nga Shtetet anëtare (deri) në 15 Mars 2007.

Vendimi Kuadër përshkruan tre mundësi për konfiskimin (e shtrirë)

- të pasurisë (në tërësi apo pjesërisht),
- e cila i përket një personi të dënuar për shkelje/ vepër penale
- të kryer në kuadrin e një organizimi kriminal (vepra penale që kanë të bëjnë me trafikimin e drogave, falsifikimin e euros, pastrimin e parave, emigracionin e paligjshëm, trafikimin e qenieve njerëzore) apo të terrorizmit, etj.:
- kur një gjykatë, e bazuar në fakte specifike, është tërësisht e bindur që pasuria/prona rrjedh nga veprimtari kriminale ose nga veprimtari të ngjashme kriminale të personit të dënuar, gjatë një periudhe përpara denimit të veprës penale, e cila është gjykuar e arsyeshme nga gjykata në rrethanat e çështjes në fjalë,
- ku është vendosur se vlera e pasurisë është e shpërpjestuar në raport me të ardhurat e ligjshme të personit të dënuar dhe një gjykatë, bazuar në fakte specifike, është tërësisht e bindur që pasuria/prona në fjalë rrjedh nga veprimtaria kriminale e personit të dënuar.

Ky konfiskim mund të shtrihet gjithashtu edhe tek:

- pasuria e vënë nga familjarët më të afërt të personit në fjalë dhe;
- pasuria e transferuar tek një person ligjor, mbi të cilin personi në fjalë – vetë apo në bashkëpunim me familjarët e tij më të afërt – ka një ndikim kontrollues.

Paragrafi 4 i Nenit 3 i lë mundësinë Shteteve anëtare të përdorin procedura, ndryshe nga ato penale, t'i ndalojë autorit të krimit pasurinë në fjalë.

3.2 Vështrim krahasues

Disa vende europiane ³⁴ kanë futur disa forma të barrës së kthyer sëpërmbysur (ose me mirë një ndarje) të provës për origjinën e pasurive³⁵. Diskrecioni i vendimarrjes i mbetet gjykatës. Shtetit i duhet të paraqesë prova për të treguar se pasurit mund të jenë siguruar në mënyrë të paligjshme ose që i akuzuari nuk mund t'i ketë siguruar pasurit në mënyrë të ligjshme, duke patur parasysh të ardhurat legjitime. Kjo gjë mund të kufizohet për një periudhë kohe të caktuar përpara dënimit dhe /ose për tipe të caktuar krimi (të rëndë). Nuk është e domosdoshme që pasurit në fjalë të kenë lidhje direkte me krimin për të cilin është dënuar një person.

Shembujt e mëposhtëm të zgjidhjeve ligjore mund të përdoren si një model për vendet e interesuara në implementimin e konfiskimit të shtrirë në legjislacionin e tyre. Përveç tekstit të ligjit, i rëndësishëm është dhe interpretimi e përdorimi i tij në praktikë duke iu referuar jurisprudencës përkatëse, prandaj dhe po përmendim disa karakteristika kryesore.

Karakteristika kryesore (krahasuese) e sistemit gjerman është parimi "bruto" dhe përdorimi subsidiar i konfiskimit të shtrirë (Neni 73d). Jurispridenca hollandeze futi parimin "neto" (pasurim i mirëfilltë/puro: avantazhet ilegale) me heqjen e kostove të autorit të veprës për kryerjen e veprës penale. Hetimi financiar penal parashikohet si një procedurë speciale, paralele, por e shkëputur nga procedurat penale, e kryer nga prokurori (Zyra e Prokurorit Special BOOM). Danimarka krijoi legjislacionin e saj bazuar në modelin hollandez, por përdor modelin "bruto". Irlanda implementoi procedurë civile të vecantë për konfiskimin e produkteve të krimit dhe për këtë nuk kërkohet gjykim penal. Krijimi i njësive speciale (në polici, prokurori apo njësitë multidisiplinore) ndoqi rregulloren e konfiskimit të shtrirë për të siguruar zbatimin e tij në praktikë.

3.2.1 Holanda

Neni 36e i Kodit Penal

1. Me kërkesë të Shërbimit të Prokurorisë Publike, në rastin e një vendimi gjyqësor të vecantë, një person i dënuar për kryerjen e një veprë penale detyrohet t'i paguajë shtetit një shumë parash me qëllim ndalimin e favoreve/perfitimeve të siguruar në mënyrë të paligjshme.
2. Ky detyrim mund t'i vihet personit, referuar në nën-seksionin e parë, i cili ka përfituar favore nëpërmjet ose nga pasurit që rrezultojnë nga vepra penale, apo shkelje të ngjashme, ose shkelje që i nënshtrohen gjobitjes së kategorisë së pestë, për të cilat ka të dhëna të mjaftueshme për të besuar se janë kryer prej tij.
3. Me kërkesë të Shërbimit të Prokurorisë Publike, në rastin e një vendimi gjyqësor të vecantë, mund të urdhërohet pagesa e një shifre të caktuar për Shtetin, për ndalim përfitimesh/favoreve të paligjshme, ndaj një personi të dënuar për një krim të dënueshëm me gjobë të kategorisë së pestë, ndaj të cilit është nisur hetim financiar, nëse sipas këtij investigimi është e arsyeshme të mendohet se vepra të tjera penale, në një mënyrë a një tjetër, kanë bërë gjithashtu që personi i dënuar të sigurojë përfitime/favore të paligjshme.
4. Gjykatësi mund të vendosë që shuma për t'u paguar duhet të jetë më e ulët se vlefata e llogaritur e përfitimit/favorit. (Dispozita e vjetër: Gjykatësi vendos vleftën e llogaritur të favorit të paligjshëm. Favori përfshin kursimet mbi shpenzimet.)
5. (...)
6. Pretendimet e alokuara ligjërisht për palët e treta të dëmtuara nxirren pas përcaktimit të vleftës së favorit të përfituar në mënyrë të paligjshme.

³⁴ Shiko gjithashtu: "Vlerësim i ligjeve dhe sistemeve tek anëtarët FATF që merren me konfiskimin e aseteve dhe masat provizore", 21.7.1997, www.oecd.org/fatf/evaluati.htm

³⁵ Për më shumë detaje shiko: "Përmbysja e barrës së provës në konfiskimin e produkteve të krimit: Vëzhgim për praktikën më të Këshillit të Europës", Këshilli i Europës, 2000.

Paragrafi 2 e shtrinë konfiskimin e produkteve të veprave penale të proceduara, për të cilat është dënueshëm, tek produktet e veprave penale të ngjashme apo të listuara, kur ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme për kryerjen e këtyre shkeljeve nga ky person. Në një rast të tillë, nuk është e domosdoshme që të kemi procedurë penale për këto shkelje penale (padi apo gjyq), por për të vendosur për konfiskimin është e mjaftueshme lidhja mes "të dyshuarit" dhe shkeljes (të dhëna të mjaftueshme) që ka rezultuar në përfitime pasurore (favore).

Paragrafi 3 parashikon mundësinë për konfiskimin e përfitimeve të paligjshme të një personi, i cili është dënueshëm për një krim të klasifikuar (të dënueshëm me gjobë të kategorisë së pestë), nëse është e besueshme që vepra të tjera penale kanë cuar gjithashtu në favore të paligjshme për personin e dënueshëm. Në një rast të tillë hetimi penal financiar special (Neni 126 I KPP-s) duhet të tregojë mospërputhjen e të ardhurave të raportuara ligjërisht dhe pasurisë aktuale. Satndarti i provës për shtetin është që të bëjë të besueshëm prezumimin e origjinës së paligjshme të pasurisë (përfitimit). Sipas paragrafit 2, nuk është e domosdoshme të provohet apo tregohet lidhja e personit me shkeljet e tjera penale.

Nuk thuhet në mënyrë specifike që i akuzuari ka detyrimin të sigurojë prova që hedhin poshtë të dhënat (e mjaftueshme) (paragrafi 2) apo supozimin e besueshëm (paragrafi 3), por mbrojtja, në praktikë, siguron shumë argumente e prova që, të paktën, të mund të ulë vleftën e përlogaritur të përfitimeve të paligjshme që janë për konfiskim.

Nxitet gjetja e mirekuptimit midis të akuzuarit dhe prokurorisë në lidhje me përfitimin e nxjerrë nga një veprë penale (Neni 511c i KPP-s) dhe ndalimin (pagesën) e tij. Nxitet mirekuptimi dhe zëvendësimi i pasurive të sigururara (sekustruara) provizorisht të të akuzuarit me para apo garanci në mënyrë që të kufizohen kostot e administrimit.

3.2.2 Danimarka

Neni 76a i Kodit Penal

1. Konfiskimi total apo i pjesshëm i pasurisë në pronësi të një personi të shpallur fajtor për një akt të dënueshëm mund të ndodhë kur:

- 1) akti i kryer është i tillë që rezultojnë në një përfitim të konsiderueshëm, dhe
- 2) sipas ligjit, akti i kryer është i dënueshëm me gjashtë apo më shumë vjet burgim ose përbën shkelje të legjislacionit për drogat euforike.

2. Në kushtet e përmendura në nënseksionin (I) më sipër, konfiskimi total apo i pjesshëm i pasurisë së siguruar nga bashkëshorti/a apo personi me të cilin/cilën autori i veprës bashkëjeton, mund të ndodhë, përveç se në rastet kur:

- 1) pasuria është vënë në më shumë se pesë vjet përpara kryerjes së aktit të dënueshëm, në bazë të të cilit bëhet konfiskimi në përputhje me nënseksionin (I), ose kur
- 2) martesë apo bashkëjetesa nuk ishte efektive në kohën e sigurimit të pasurisë.

3. Në kushtet e përmendura në nënseksionin (I) më sipër, mund të ndodhë konfiskimi total apo i pjesshëm i pasurisë së transferuar të një personi ligjor ndaj të cilit shkelësi, më vete, apo sëbashku me personat e tij më të afërt ka një ndikim vendimtar. Kjo gjë është e aplikueshme edhe në rast se personi në fjalë ka marrë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të personit ligjor. Konfiskimi mund të mos ndodhë nëse prona i është transferuar personit ligjor më shumë se pesë vjet përpara kryerjes së aktit të dënueshëm mbi të cilin bazohet konfiskimi në përputhje me nënseksionin (I).

4. Konfiskimi sipas nënseksionit (I-III) mund të mos ndodhë në rast se shkelësi provon se prona është siguruar në mënyrë të ligjshme ose me mjete të ligjshme.

5. Në vend të konfiskimit të një prone të caktuar, sipas nënseksionit (I-III) më sipër, mund të konfiskohet një shumë që i korespondon vleftës së pronës, ose një pjesë e vleftës.

Konfiskimi (i shtrirë) i pronës së një personi të dënuar është i kufizuar për veprat penale të dënueshme me gjashtë apo më shumë vite burg dhe për përfitime të konsiderueshme. Konfiskimi është i mundur edhe ndaj bashkëshortes(it) apo personi me të cilin/cilen bashkëjeton i akuzuari apo nga një person ligjor, në rast se prona është përfituar apo transferuar brenda pesë vjetësh përpara kryerjes së veprës penale dhe i personi i dënuar ka ndikim vendimtar apo ka marrë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të personit ligjor.

Ligji siguron bazën për konfiskimin e plotë (apo të pjesshëm) të pronës së personit të dënuar, përvec rastit kur ai provon se prona është siguruar në mënyrë të ligjshme ose me mjete të ligjshme. Nuk është e nevojshme të bëhet ndonjë lidhje me vepra penale të tjera (të kryera përpara veprës së proceduar). Lidhja midis pronës (së siguruar brenda pesë vitesh përpara veprës penale të proceduar) dhe prezumimit se origjina e saj është e paligjshme duhet të jetë mjaftueshmërisht në mbështetje të argumenteve dhe provave të të akzuarit për të bërë të mundur origjinën e ligjshme të pronës (të një pjese të pronës).

3.2.3 Gjermania

Seksioni 73d i Kodit Penal (Konfiskimi i shtrirë)

1. Në qoftë se kryhet një akt i paligjshëm sipas një ligji që i referohet kësaj dispozite, atëherë gjykata do të urdhërojë edhe konfiskimin e objekteve të autorit të veprës, apo të nxitësit ose ndihmësit, në rast se rrethanat justifikojnë supozimin se këto objekte janë siguruar si rezultat i akteve të paligjshme, ose me qëllimin e kryerjes së tyre. Fjalja 1 do të jetë gjithashtu e zbatueshme në rast se autori i veprës, nxitësi apo ndihmësi nuk e posedojnë apo kanë ndonjë pretendim për objektin vetëm sepse ai e ka siguruar objektin si rezultat i një akti të paligjshëm apo me qëllim kryerjen e tij. Në këtë mënyrë zbatohet seksioni 73, nënseksioni (2).
2. Në qoftë se konfiskimi i një objekti të caktuar mbas aktit bëhet i pamundur në tërësi apo pjesërisht, atëherë do të zbatohen me analogji Seksionet 73a dhe 73b.
3. Në rast se, pas një urdhri për konfiskim në përputhje me nënseksionin (1) për shkak të një akti tjetër të paligjshëm që autori i veprës penale ose nxitësi apo bashkëpunëtori ka kryer para lëshimit të urdhërit, duhet të nxirret një tjetër urdhër për konfiskimin e objekteve të autorit të veprës penale të nxitësit apo të bashkëpunëtorit, atëherë gjykata, për ta bërë këtë gjë, duhet të marrë në konsideratë urdhërin e lëshuar më parë.
4. Kësisoj, do të zbatohet Seksioni 73c.

Që nga viti 1992, është zbatuar "parimi i pagesës bruto", sipas të cilit konfiskimi shtrihet mbi të gjithë produktet e (e rezultuara nga kryerja e) veprës penale, pa zbritjen e shpenzimeve të bëra.

Propozimi për amendimin e dispozitës nuk u pranua (konfiskimi i produkteve të lidhura me pretendimet pasurore të viktimës - Neni 73/1). Në praktikë, problemi kryesor është vërtetimi i origjinës së paligjshme të pronës, në qoftë se i akuzuari ka të ardhura të ligjshme.

3.2.4 Irlanda

Ligji për Produktet e Krimin (PCA) dhe Ligji për Zyrën e Pasurive Kriminale/ të paligjshme (CAB) u aprovua në vitin 1996, me qëllim që të luftohej me efektivitet krimi i organizuar duke patur si objektiv pasurinë e kriminelëve.

CAB është një agjensi shumë-disiplinore, në përbërje të së cilës ka punonjës policie, të doganave, taksave dhe të ndihmës sociale, të cilët mund të përdorin kompetencat e tyre fillestare/origjinale dhe aksesin në bazën e të dhënave si pjesë e përgjegjësisve të tyre brenda CAB-it. Detyra e CAB-it është të identifikojë e të sekuestrojnë, në tërësi apo pjesërisht, pasurit e personave që rrjedhin apo dyshohet se rrjedhin drejtpërdrejt apo tërthorazi nga aktivitete kriminale apo dhe përfitimet e pasurive të tilla.

Në bazë të Ligjit për të Ardhurat dhe Ndhimën Sociale, produktet e aktiviteteve penale apo të aktiviteteve të dyshuara penale i nënshtrohen taksave dhe mund të pretendohet apo konfiskohet edhe vlefata e përfitimeve të pajustificuara të personit të përfshirë në një aktivitet penal, nga ndihma sociale.

Ligji për Produktet e Krimit (i amenduar në vitin 2005) futi procedurën civile (dhe standartet civile të provës të një aktiviteti penal) për konfiskimin *in rem* të produkteve të aktivitetit penal. Nuk kërkohet dënim me procedurë penale. Gjykata e Lartë vendos për konfiskimin provizor dhe për konfiskimin.

Subjekti i masave e përkohshme (urdhër provizor për 21 ditë (seksioni 2) dhe urdhër interlokutor për 7 vjet (seksioni 3)) dhe i konfiskimit (urdhri i përvetësimit (seksioni 4)) është prona e specifikuar, në posedim apo kontrollin e një personi, me vlerë mbi €13.000, që përbën, drejtpërsëdrejti apo në mënyrë të tërthortë, produkt të krimit ose që është siguruar, në tërësi apo pjesërisht, bashkë me apo në lidhje me pasurinë që, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, përbën produkt krimi. Vlefata e pasurisë i kalon €13.000. Gjykata duhet të marrë në konsideratë rrezikun e padrejtësisë kur të marrë vendimin për urdhrin e përvetësimit. Besimi i Kryeinspektorit të zyrës së CAB-it se pasuritë përbëjnë, tërësisht apo pjesërisht, produkte të veprimtarisë penale mund të përdoret si provë (Neni 8).

Modeli i ligjit civil irlandez mund të përdoret si një shembull, por aplikimi i menjëhershëm i tij në sistemin ligjor continental do të ishte i vështirë. Megjithatë, CAB-i mund të shërbejë si një shembull i mirë i një agjensie shumë-disiplinore, duke patur si objektiv edhe taksimin e produkteve të aktiviteteve kriminale dhe të përfitimeve të pajustificuara të ndihmë sociale.

Ligji për produktet e krimit

Sksioni 4: Urdhri i përvetësimit

(1) Në zbatim të nënseksionit (2), ku një urdhër interlokutor ka qenë në fuqi për jo më pak se 7 vjet në lidhje me një pronë të caktuar, Gjykata, në zbatim të tij dhe në mbështetje të aplikantit, mund të lëshojë një urdhër ("urdhër përvetësimi") përmes të cilit urdhërohet që e gjithë prona, apo nëse është e drejtë, një pjesë e caktuar e saj, t'i transferohet, në përputhje me kushtet e përcaktuara nga Gjykata, Ministrit apo një personi tjetër që e cakton gjykata.

(2) Sipas nënseksioneve (6) dhe (8), Gjykata nxjerr një urdhër përvetësimi në lidhje me çdo lloj prone që përbën subjekt ankimi sipas nënseksionit (1), përveç se kur provohet në mënyrë të pranueshme për të se prona në fjalë nuk përbën, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, produkt të krimit dhe nuk është siguruar, tërësisht apo pjesërisht, me ose në lidhje me pronën që, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, përbën produkt krimi.

(3) Aplikanti duhet të njoftojë të paditurin (përveç kur Gjykata mendon se nuk është në mënyrë të arsyeshme e mundur të dihet vendndodhja e tij/saj), dhe personat e tjerë (nëse ka të tillë) ndaj të cilëve Gjykata bën ankimim mbështetur në këtë seksion.

(4) Një urdhër përvetësimi do të veprojë për për ta zhveshur të paditurin nga të drejtat e tij/saj (nëse ka të tilla) ndaj pronës të cilës i referohet dhe, me lëshimin e urdhrit, prona mbetet e transferuar tek Ministri apo personi tjetër te cilit referohet urdhri.

(5) Ministri mund të shesë apo përndryshe sistemojë çdo pronë të transferuar tek ai/ ajo në bazë të këtij seksioni, dhe çdo e ardhur nga ky sistemim, si dhe çdo para e transferuar tek ai/ajo në përputhje me këtë seksion do të paguhet apo dërgohet nga Ministri në përfitim të Thesarit.

(6) Në procedurat e kryera në përputhje me nënseksionin (1), përpara se të vendoset nëse duhet lëshuar një urdhër përvetësimi, Gjykata duhet të japë mundësinë e një seance para Gjykatës dhe të shpjegojë përse urdhri nuk duhet lëshuar ndonjë nga personat që paraqesin pretendime pronësie ndaj ndonjë prej pronave në fjalë.

(7) Gjykata, nëse e konsideron të drejtë një gjë të tillë dhe në interes të drejtësisë, me kërkesë të të paditurit ose, në rast se vendndodhja e të paditurit nuk mund të konfirmohet, me iniciativën e vet, mund ta shtyjë seancën dëgjimore për ankimimin sipas nënseksionit (1) për një periudhë që nuk i kalon 2 vite.

(8) Gjykata nuk lëshon një urdhër përvetësimi, në rast se gjykon se mund të ketë rrezik serioz për mosdhënie drejtësie.

Seksioni 8: Dispozita në lidhje me provat dhe procedurat sipas Ligjit

(1) Kur një anëtar apo një punonjës i autorizuar deklaron (a) në procedura sipas seksionit 2, nën betim ose, nëse Gjykata urdhëron, në dëshmi me gojë, ose (b) në procedura sipas seksionit 3, në dëshmi me gojë,

se ai apo ajo beson secilën apo të dyja si më poshtë, do me thënë:

(i) se i padituri posedon apo ka në kontroll një pronë të caktuar dhe se prona përbën, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, produkt të krimit,

(ii) se i padituri posedon apo ka në kontroll një pasuri të caktuar e se pasuria është siguruar, tërësisht apo pjesërisht, me apo në lidhje me pasurinë që, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, përbën produkt të krimit,

dhe se vleftha e pronës apo, siç mund të jetë rasti, vleftha totale e pronës referuar në të dy paragrafet (i) dhe (ii) është jo më pak se 13.000 €, atëherë, nëse Gjykata bindet se ka prova arsyë të mjaftueshme për bindjen e thënë më sipër, deklarata do të jetë provë për çështjen e referuar në paragrafin (i) ose në paragrafin (ii) ose në të dyja, siç mund të jetë e përshtatshme, dhe e vlefthës së pronës.

(2) Standarti i provës i kërkuar për të vendosur çdo çështje që del në bazë të këtij Ligji do të jetë i zbatueshëm në procedurat civile.

(...)